



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

NGA: Komiteti për Politikë dhe Financa.

PËR: Kuvendin e Komunës së Prishtinës

SUBJEKT: RAPORTI i punës së administratës, për vitin 2003

DATA: 10.05.2004.

I. ORGANIZIMI

Për vitin fiskal 2003, kryeshefi i Ekzekutivit, zëvendëskryeshefi dhe 13 drejtorate e kanë përbërë shërbimin civil administrativ të Komunës së Prishtinës. Posti i zëvendëskryeshefit të Ekzekutivit, i paraparë në pajtim me dispozitat e nenit 55 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të datës 16.03.2001, është plotësuar në muajin prill të vitit 2003.

II. GJENDJA

Kompetencat dhe përgjegjësitë e pushtetit lokal janë të rregulluara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, e cila komunave iu jep përgjegjësi për aktivitetet vijuese: zhvillimin ekonomik, planifikimin urban, lëshimin e lejeve të ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit dhe ambientit, udhëheqjen e pronës, arsimimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, kujdesin primar shëndetësor, shërbimet sociale dhe strehimin.

Përkunder vështirësive fillestare dhe mungesës së resurseve të kualifikuara njerëzore të bartura nga vitet e kaluara, Komuna ka arritur ndërkohë që të bëjë lëvizje pozitive drejt problemeve jetësore të qytetarëve dhe t'iu përgjigjet kërkesave të tyre.

Për kryerjen e punëve të administratës komunale nga lëmi i të drejtave dhe detyrave të komunës, organet e administratës kanë realizuar politikën e përcaktuar dhe zbatimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera. Organet e administratës kryerjen e punëve dhe detyrave e kanë bërë në bazë të programit të punës.

Janë formuar zyrat e vendit në kuadër të administratës së përgjithshme si një formë e ofrimit të shërbimeve nga ana e administratës për qytetarë (gjithsejt 10). Mungesa e dhënjes së të drejtës për vulosje të dokumenteve të lëshuara, si dhe moskompletimi i lokaleve për një shërbim të mirëfilltë, ka ndikuar në mospërbushjen e detyrave dhe punëve në mënyrë të kënaqshme.

Pjesa dërmuese e punëtorëve të larguar nga administrata komunale, pas luftës janë kthyer në vendet e tyre të punës, kurse një numër tjetër është angazhuar për herë të parë. Mosangazhimi në punë për dhjetë vjet dhe mospërcjellja e të arriturave bashkëkohore në punën e administratës, si dhe në aplikimin e rregullativës ligjore, e nënligjore për dhjetë vjetet e paraluftës, ka lënë pasoja të dukshme

tek aftësia e punëtorëve të administratës komunale për t'i realizuar funksionet e tyre. Në funksionimin e administratës janë eliminuar të metat e paraqitura deri në vitin raportues, të cilat kanë qenë si pasojë e ndryshimit të sistemit politikë dhe ekonomik, e krijimit të sistemit të ligjor, që paraqet një kompleksitet të ligjeve të aplikueshme para vitit 1990, e rregulloreve të UNMIK-ut dhe standardeve ndërkombetare, si dhe e futjes në aplikim të teknologjisë informative, të cilën shumica e të punësuarve në administratën komunale nuk e kishin të njohur. Problem në vehte ka paraqitur edhe mosfurnizimi i personelit civil- shefave të sektoreve, zyrave dhe stafit tjetër punues të Shërbimit Civil me kontrata të punës, problem ky i cili është zgjidhur në vitin raportues.

Pas vendosjes së Administratës së UNMIK-ut në Kosovë ka filluar edhe pajisja me mjete të teknologjisë informative të organeve të administratës në Komunë. Këto pajisje, kryesisht kompjuter vinin nga donacionet e ndryshme kurse në vitin raportues pas krijimit të buxhetit komunal pajisjet janë blerë edhe nga Komuna, kurset fillestare i kanë kryer shumica e të punësuarëve, është e kënaqshme edhe pajisja e tyre me kompjuter.

Përpos në disa raste kur janë emëruar drejtorët e ndërmarjeve komunale, shpallja e konkurseve publike për plotësimin e vendeve të lira të punës apo vazhdimin të dhëniës së pagave nga Këshilli i drejtorëve dhe kryeshefi i Ekzekutivit nuk ka ekzistuar një qeverisje e tyre në të gjitha sferat.

Deri në fund të vitit 2002 ka munguar sistemi i organizuar për pritje. Ka qenë e mundimshme që qytetarët të detyrohen të shkojnë nëpër zyra dhe drejtorate të ndryshme për të përfituar nga shërbimet e administratës komunale pa pasur një orientim të drejtë dhe të duhur lidhur me realizimin e kërkesave dhe shërbimeve që ofrohen nga drejtoratet. Në vitin raportues kanë filluar me punën zyrat pritëse, të projektuara nga shërbyesit civil të komunës dhe ndërkombëtarët, dhe financuar nga donacioni i HABITATIT, MSHP dhe KOMUNA.

Pengesë për të arritur një shkallë më të lartë të efikasitetit të punës së tyre ka paraqitur edhe:

- *informimi i vonshëm i zyrtarëve komunal me rregullativën ligjore,
- *bartja jo e plotë e kompetencave, nga institucionet e perkohshme të vetqeverisjes, administrata e UNMIK-ut.
- *mosnjohja e qytetarëve për kompetencat e organeve komunale,
- *transparenca-mungesa e një BYLTENI periodik ku do të paraqiteshin të arriturat e Komunës, WEB faqja e Komunës, etj.

III. REKOMANDIME

1. Shërbimi Civil duhet udhëhequr përmes:

-Parimeve të barazisë, të sinqeritetit, të ndërshmerisë dhe përgjegjësisë, të transparencës, të meritës, të jodiskriminimit, të përfshirjes me rastin e punëzënies,

- Caktimet në vendet e punës të behen përmes shpalljes së konkursit, kontratave të punës të cilat do të nënshkruheshin nga autoriteti caktues ose një nepunës, i autorizuar me shkrim nga autoriteti caktues,

-Themelimit të Këshillit (Bordit) disiplinor dhe atij të ankesave, të qëndrueshëm për t'i zhvilluar procedurat në rast të shkeljeve të rënda të detyrave të punës.

2. Këshilli i drejtorëve, së bashku me kryeshefin e Ekzekutivit, duke marrë pjesë, në takimet e komiteteve obligative, joobligative dhe në mbledhjet e Kuvendit, do të ndihmojë Kuvendin Komunal dhe komitetet e tij në sigurimin e të gjitha informatave dhe raporteve për procesin e marrjes së vendimeve dhe zbatimin e të gjitha vendimeve të Komunës.

3. Kujdes më i madh për punën e organeve të administratës që puna e saj të jetë e bazuar në dispozitat e aplikueshme që janë në fuqi, e që vlejnë për pushtetin lokal –Komunën.

4. Kryeshefi i Ekzekutivit, së bashku me Këshillin e drejtorëve do të vazhdojë të qeverisë me ndërmarrjet komunale, institucionet, të cilat nuk janë të futura nën ombrellën e AKM-së në të gjitha sferat. Të ndikojë që ndërmarrjet të paraqesin Kuvendit buxhetin e tyre dhe raportet ashtu siq është parapar me dispozitat aplikative

5. Të shtohet puna për përgatitjen dhe mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i ka apo i shfrytëzon Komuna dhe mbajtjen e një inventari të mjaftueshëm për tërë pasurinë e tundshme që ka Komuna,

6. Të punohet në:

- *ndryshimin e Statutit, rregullave të procedurës, rregulloreve që janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës,
- *numrin e drejtorateve, stafin punues për vitin vijues,
- *ndarjen e përgjegjësive ndërmjet drejtorateve, ku këto çështje nuk janë të rregulluara me Statut ose me rregullat e procedurës,
- *ndarjen ose kombinimin e përkohshme të punës dhe përgjegjësisë ndërmjet drejtorateve, sipas nevojës, në bazë të lëmit ose projektit.

VËREJTJE: Raporti vjetor i dërgohet për shqyrtim Kuvendit të Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 40, pika q) të Statutit të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001 dhe dispozitave të nenit 11.3 shkronja (d) të Rregullores së UNMIK-ut për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë nr. 2000/45.

Në vazhdim të Raportit është dhënë pasqyra e punës së organeve të administratës, dhe rekomandimet e dhëna për vitin vijues.

DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

1. SEKTORI I PUNËVE TË PËRGJITHSHME DHE JURIDIKE

a). Shërbimi për marrëdhënie pune

Ky shërbim a rregulluar dhe sistemuar dokumentacionin personal të të punësuarve në organet e administratës komunale të Kuvendit dhe janë përpiluar vendime dhe shkresa të ndryshme nga marrëdhënia e punës, si vijon:

- janë përpiluar vendime për pushim vjetor, për pushim pa pagesë, për pushim të lehonisë etj,
- janë lëshuar vërtetime lidhur me përvojën e punës,
- janë nxjerrë aktvendime për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punëtorëve, sipas rasteve të ndryshme,
- janë përpiluar kontratat e punës, në mbështetje të konkurseve të shpallura.

b) Shërbimi i byroteknikës

Janë fotokopjuar-shumëzuar gjithësej 509334 faqe material, për nevojat e Kuvendit, komiteteve, drejtorateve dhe avokatit publik.

Për kryerjen e këtyre punëve janë shfrytëzuar gjithësej 1018 risa letër.

2. SEKTORI PËR SHËRBIME PROFESIONALE TË KUVENDIT DHE TË EKZEKUTIVIT

Ky Sektor ka kryer këto punë:

- punët administrative në përgatitjen e materialeve (vendimet, rregulloret etj.) për mbledhje,
- është bërë përkthimi, lekturimi dhe shpërndarja e materialeve
- janë përpiluar ekstraktet nga mbledhjet e mbajtura,
- është bërë përgatitja e rregulloreve, vendimeve dhe akteve të tjera, të miratuara nga Kuvendi, Bordi i drejtorëve dhe organet tjera.

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithësej:

- 13 (trembëdhjetë) mbledhje të Kuvendit,
- 9 (nëntë) mbledhje të Bordit të drejtorëve
- 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar:

- 7 (shtatë) rregullore nga fusha të ndryshme
- Planin për mbrojtjen civile dhe gatishmëri emergjente,
- Dokumentin për vlerësimin e rrezikut për komunën e Prishtinës.
- Ka miratuar edhe 105 vendime të ndryshme.

3. SEKTORI TEKNIK

Ky Sektor ka kryer këto punë dhe shërbime:

- janë kryer disa punë lidhur me mirëmbajtjen e ndërtesës, siç janë: renovimi i shkallëve para hyrjes së Komunës, renovimi i pllatos,
- është bërë ndërrimi i dyerve, dritareve dhe roletave në objektet e Komunës etj.
- është ndërtuar aneksi për përkthim simultan në sallën e Kuvendit,
- janë kryer punët teknike, në objektin e komunës, për kyçje në internet.

-janë kryer disa punë teknike lidhur me telefoninë fikse, në funksion të zvogëlimit të shpenzimeve telefonike.

-është vendosur për mënyrën e furnizimit të byfësë, përmes Zyrës së prokurimit, për dallim nga praktika e deritashme, si dhe për caktimin e çmimeve sa më ekonomike.

-është punuar në mirëmbajtjen e higjienës në objektet e Komunës.

4. SEKTORI I BASHKËSIVE LOKALE

Ky Sektor ka kryer këto punë:

-janë mbajtur takime të rregullta mujore me kryetarët e BL-ve,

-kemi bërë vendosjen e grilave siguroese, me qëllim të sigurimit të zyrave të bashkësive lokale, atje ku ka qenë e nevojshme,

-është dhënë kontribut me rëndësi nga ky Sektor, përmes kryetarëve të BL-ve, lidhur me realizimin e projekteve të ndryshme infrastrukturale,

-janë organizuar tubime me qytetarë në bashkësitë lokale, në të dy zonat. Në këto takime u bisedua për çështje të ndryshme në lëmin e infrastrukturës dhe për çështje të tjera.

-është ndërtuar zyra e re e Bashkësisë lokale, në Keçekollë, në bazë të procedurës së tenderimit.

-janë lëshuar vërtetime për rregullimin e çështjeve të ndryshme, bazuar në kërkesat e palëve dhe janë kryer edhe punë të tjera nga bashkësitë lokale, e që janë me interes për qytetarët.

5. SEKTORI I REGJISTRIMIT CIVIL-OFIÇARIA

a) Shërbimi i Ofiçarisë

Ka kryer këto punë:

-regjistrime të reja në LAL (librin amzë të të lindurve)	10471
-regjistrimet e mëvonshme në LAL.....	19137
-regjistrimet e reja në LAM (librin amzë të të martuarve)... ..	1395
-regjistrimet e mëvonshme në LAM	1065
-regjistrimet e reja në LAV (librin amzë të të vdekurve).....	2613
-regjistrimet e mëvonshme në LAV.....	1605

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar:

-certifikata të lindjes	31674
-certifikata martesore.....	2405
-certifikata të vdekjes.....	2735
-certifikata të statusit martesor.....	2789
-certetime për persona të gjallë	322
-ceklarata për bashkësi familjare	851

Lindjet, martesat dhe vdekjet që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese jashtë Kosovës:

-regjistrime speciale në LAL (librin amzë të të lindurve)	843
-regjistrime speciale në LAM (librin amzë të të martuarve).....	81
-regjistrime speciale në LAV (librin amzë të të vdekurve).....	261
-certifikata të lindjes (të lëshuara).....	8433
-certifikata të martesës.....	781
-certifikata të vdekjes	261

Në Shërbimin e vërtetimeve dhe të përshkrimeve, janë përshkruar:

-deklarata me dy dëshmitarë.....	459
-deklarata mbi bashkësinë familjare.....	867
-vërtetime të fotokopjeve (përshkrimi).....	34.071
-vërtetime të nënshkrimit.....	04

Në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil gjatë periudhës raportuese janë kryer këto punë:

-të regjistruar, të konfirmuar-rishq.	4102
-fëmijë të regjistruar, të konfirmuar	3184
-korrigjime të letërnjoftimeve	2756
-letërnjoftime të humbura	1203
-dokumente udhëtimi të humbura, dëmt.....	90
-korrigjim të dok.të udhëtimit	
-aplikime për dokument të udhëtimit	9364
-aplikime për dokument të udhëtimit për fëmijë	3206
-dokumente të udhëtimit të lëshuara.....	15243
-letërnjoftime të lëshuara	11247
-korrigjime të letërnjof.dhe të pasap.	2425
-ndërrime të adresave	127

Vërejtje: Punët e kryera në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil, janë kompetencë e rezervuar për organet e UNMIK-ut, përkundër faktit që janë paraqitur brenda raportit të Drejtoratit të Administratës së Përgjithshme.

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI, SPORT DHE GJINI

SEKTORI PËR KULTURË DHE GJINI

Që nga fillimi i vitit 2003, është bërë evidentimi dhe rievidentimi i të gjitha institucioneve,objekteve kulturore dhe grupeve të ndryshme artistike, qofshin ato profesionale apo amatore. Është konstatuar se një pjesë e madhe e institucioneve të kulturës në komunë dhe rrethinë punojnë në kushte shumë të vështira ndërsa një pjesë tjetër nuk punon fare. Sa për ilustrim po përmendim vetëm disa;

-Teatri i fëmijëve, të rinjve dhe kukullave "DODONA" .Këtë vit me angazhimin maksimal të Qeverisë Komunale për teatrin "DODONA "janë siguruar 105.000 € nga suficiti i buxhetit për vitin 2003.

-Objekti në të cilin është e vendosur biblioteka "HIVZI SYLEJMANI",

-Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në regjionin e Prishtinës,

-Arkivi Regjional i Prishtinës,

Qendra e Pionierëve 2000-, këtë vit ka korrur suksese jashtëzakonisht të mira, duke krijuar programe cilësore dhe duke tubuar në aktivitete mbi 400 fëmijë të moshave të ndryshme. Me dinjitet përfaqësoi Kosovën në Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve në Silivri të Turqisë, në Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve në Durrës, ndërsa në shtator të vitit 2003, bashkë me Drejtoratin për Kulturë të Kuvendit Komunal, me sukses organizoi Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve "YLBერი I PRISHTINËS", që për herë të dytë u organizua në Prishtinë. Më 1 qershor organizoi Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe mori pjesë në të gjitha manifestimet që ka organizuar Drejtorati për Kulturë dhe Gjini gjatë vitit 2003.

Edhe kjo qendër kulturore për fëmijë gjatë vitit të kaluar u përball me probleme të mëdha pasi që objekti i saj është i uzurpuar nga UNMIK-u ndërsa Drejtoria e Pallatit të Rinisë kërkon qira për lokalet ku ushtron veprimtarinë e vet kjo çerdhe e kulturës për fëmijë.

Vlen për tu përmendur edhe Teatri i të Rinjve të Prishtinës i cili me sukses përfaqësoi Prishtinën në Festivalin e Teatrove të Kosovës në Ferizaj me Dramën e Teki Dervishit "SHENJAT E TMERRIT" si dhe në Festivalin Gjithëkombëtar të Komedisë në Preshevë me komedinë e Eduard Ogës "LOTARIA AMERIKANE".

Shoqëritë kulturo- artistike -"Bajaram Curri", "GERÇEK", "MALËSIA E GALLAPIT ", "ANSAMBLI I UNIVERSITETIT " kanë lokale të caktuara për punë dhe zhvillojnë aktivitet të kënaqëshme artistike. Në tetor të vitit 2003, themeluan edhe Shoqërinë e pestë Kulturo- Artistike "QAMILI I VOGËL", për të cilën është siguruar një lokal adekuat për punë. Të gjitha këto shoqëri kulturo -artistike Kuvendi Komunal, përkatësisht Drejtorati për Kulturë i mbështet moralisht dhe materialisht.

Drejtorati për Kulturë dhe Gjini i ka realizuar 5 ekspozita të mëdha, 5 festivale të rëndësishme të muzikës serioze, rokut dhe për fëmijë, ka realizuar program për të gjitha datat e rëndësishme historike dhe kulturore në Prishtinë si: Dita e fëmijëve, me 1 Qershor, Dita e Prishtinës, 2 Korriku, Maturiada, Dita e Flamurit, Dita e Bajramit të Madh, Shtylla e Paqes, 125 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Nata e Krishtlindjes, Nata e Vitit të Ri, etj.

SEKTORI PËR ÇËSHTJET GJINORE

Ky sektor gjatë vitit të kaluar ka realizuar disa projekte me rëndësi të veçant për çështjet gjinore. Ka bërë vizita dhe ka shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit, si dhe ka vënë kontakte të rregullta me këto OJQ: "QENDRA PËR TRAJNIME DHE STUDIME GJINORE" , "KWI" (INICIATIVA E GRAVE TE KOSOVES) ,"DERA E HAPUR", "AUREOLA" , "NORMA" , "LULEBORA" , "QENDRA PËR REHABILITIMIN E NËNËS DHE FËMIJËS", "ELDA" , "GRATË QË I DUAN LULET" , "QENDRA PËR MBROJTJEN E GRAVE DHE FËMIJËVE" , "KALABRIA" , " VIOLETA", "LULJA" , QENDRA KOSOVARE PËR REHABILITIMIN E VIKTIMAVE DHE TORTURËS , RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS etj. Ka marrë pjesë nëpër seminare të ndryshme si dhe në mbledhjet e Këshillit Lokal të Grave (KLG) të Prishtinës. Ka organizuar disa debate që për temë kishin:- Integrimin e femrës në shoqëri,-zhdukjen e analfabetizmit të femrat në viset rurale-(të minoritetit ashkalinj). Ka mbajtur dy trajnime për punën e femrave në poste udhëheqëse dhe për angazhimin e femrës në administratën e Kuvendit Komunal, si dhe njohuri mbi përkatësinë gjinore. Sido që të jetë,Drejtorati, edhe pse vetëm me dy punëtorë, ka realizuar 72 projekte të ndryshme.

Projektet e realizuara gjatë vitit 2003

1. Java e "DODONËS" më rastin e dhjetvjetorit të punës.....	5000 €
2. Aktivizimi i Bibliotekës së Keqekollë.....	510 €
3. Festivali Ndërkombëtar i Muzikës bashkëkohore.....	8500 €
4. Festivali Ballkanik i Fëmijëve në Silivri.....	5000 €
5. Koncerti humanitar i vëllëzërve Krasniqi (për fëmijë).....	600 €
6. Ekspozita e piktorit Ismet Jonuzi.....	800 €
7. Ekspozita për krimet e luftës në Gjakovë dhe rrethinë.....	500 €
8. Ceremonia e katërvjetorit të rënies së rapsodit Blerim Berisha.....	500 €
9. Shënimi i 35 vjetorit të Arkivit Komunal.....	1000 €
10. Festivali rokut "ROK PËR ROK".....	2500 €
11. Dita e Prishtinës-"PRISHTINA 2003".....	12.000 €
12. "Maturiada 2003".....	2000 €

13. Një qershori Dita Ndërkombëtare e fëmijëve.....	3000 €
14. Mbështetje Grupit të baletit për fëmijë.....	500 €
15. ShKA "QAMILI I VOGËL".....	1200 €
16. Ekspozita e Eshref Qahilit.....	500 €
17. 125 Vjetori i Lidhjes së Prizrenit.....	10.000 €
18. "Shenja e tmerrit", Teatri i të rinjve Prishtinë.....	2500 €
19. SHKA "MALËSIA E GALLAPIT".....	2500 €
20. "Kutija e ilaçeve" -TEATRI KOMBËTAR.....	5000 €
21. Shkolla fillore "Meto Bajraktari"- botimi i librit me skeqe për fëmijë.....	700 €
22. Vizita trupes sëTeatrit Alternativ "OAZA" nga Tirana	515 €
23. Ekspozita e forografive e Fahredin Spahiu.....	1000 €
24. Festivali Ballkanik i Teatrove në Pogradec "DODONA".....	1500 €
25. Monografia e Prishtinës.....	1000 €
26. Libri "KOPSHTI I DRENUSHËS", fëmija Etleva Durmishi.....	300 €
27. Departamenti Psikologjisë-Simpozium për etno psikolo-mbështetje.....	500 €
28. SHKA "BAJRAM CURRI"	2810 €
29. AVI "HUMUS"-promovim i CD-së.....	500 €
30. Biblioteka "HIVZI SALEJMANI" - Tituj të rinj.....	5000 €
31. Edhe gratë kanë të drejtë -OJQ "Kalabria".....	1400 €
32. Festivali i parë i fofografisë "FOTOMARATONA".....	2000 €
33. SHKA "GERÇEK".....	3000 €
34. Takimet regjionale të talentëve të rinj, të shkollave fillore dhe të mesme.....	600 €
35. Festivali i Teatrove Amatore të Kosovës organizim	
36. Hartimi i strategjisë së komunave të Kosovës për aktivitetet kulturore. - organizim	
37. Koncerti me rastin e Ditës së Pavarësisë së Amerikës	7600 €
38. A.V.I. "Ylli trokitës "	500 €
39. Koncert i COOLIO.....	1000 €
40. Shoqata rajonale e të shurdhërve	800 €
41. Shpenzimet e udhëtimit për D.J nga Anglia Terry Frensis.....	1000 €
42. OJQ- "Shefkat" nga Prishtina për org.e nje ore letrare	500 €
43. Festivali "9-11" për tragjedinë e Amerikes.....	2000 €
44. Projekti per Muajin Rinore 2003.....	2000 €
45. Shoqata e Artisteve Figurativ Ekspozita e Skulpturave.....	2000 €
46. Ekspozita e piktorës nga Turqia -Ajsengyl Ezer.....	1000 €
47. Promovimi i veprave te Mark Krasniqit	500 €
48. Festivali ndërkombëtar i fëmijëve	5300 €
49. Akademia e arteve "Endërra e nje nate vere".....	700 €
50. Botimi i librit të Donjeta Gashit	300 €
51. Grupi "Ligji i Rrugës"-Prishtinë.....	500 €
52. Adelina Berisha-violineste e re.....	700 €
53. Festivali i muzikës kamertale- Ars Kosova.....	2100 €
54. Festivali i fëmijëve "Durrresi 2003"	1400 €
55. Ekspozita -"Nostalgjia për Prishtinën"	1800 €
56. Mis Prishtina 2003	1000 €
57. Projekti filmik "Varri i qyqes".....	2000 €
58. Teatri i të rinjëve - Dodona "Gruaja në kornizë".....	1000 €
59. Teatri Kombëtar -Renovimi i sallës se baletit.....	2700 €
60. Studio e baletit "Mjellma".....	600 €
61. OJQ- "Dera e Hapur"	855 €
62. "Barka me Visar" -botim i veprës për fëmijë H. Ulqinaku	600 €

63. Njeriu me shkop të bardhë	1000 €
64. Gërmime arkeologjike në Keqekollë.....	3000 €
65. OJQ ELDA-lufta kundër analfabetizmit.....	1100 €
66. Festa e Bajramit të madh.....	4345 €
67. Shtylla e Paqes.....	1200 €
68. Manifestimi për Krishtlindje	6000 €
79. Manifestimi i Vitit të Ri 2004.....	8000 €
70. Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës (renovimi i shtëpisë së H.Sylejmani).....	4000 €
71. Renovimi i shtëpisë së kulturës në Bardhosh.....	25000 €
GJITHSEJ	179.625.00 €

SEKTORI PËR RINI DHE SPORT

Drejtorati për Rini dhe Sport në kuadër të programit të vetë të punës gjatë vitit 2003 ka realizuar pothuajse të gjitha projektet e parapara. Ndër to mund të veçojmë: ndihmën materiale për afro 30 klube dhe shoqata sportive, apo individë, të cilët merren me çështje të sportit. Qellimi i mbështetjes me mjete financiare ishte, që klubet tona, që janë mjaft të varfëra, të motivohen për punë dhe të arrijnë rezultate të mira në garat e ndryshme. Mendojmë se në këtë aspekt kemi pasur rezultate shumë të mira jo vetëm në ngritjen e cilësisë së sportit në përgjithësi, por, edhe në depërtimin e sportistëve tanë dhe klubeve tona në arenën ndërkombëtare. Në këtë drejtim kemi suksese të pa mohueshme. Sa për ilustrim po përmendim klubin e basketbollit "UNIVERSITETI" që bënë gara në ligën nderkombëtare "TROKAL", klubin e Ping pongut, që poashtu, veç ka dalë në arenën ndërkombëtare, klubi hendbollit "PRISHTINA"-femrat, që ka shënuar rezultate të dukshme, klubi i futbollit "PRISHTINA" që ishte kampion i Kosovës, etj. Ky drejtorat ka bërë realizimin dhe organizimin e shumë projekteve kreative, ndër to: Maturiadën 2003, Ditën e Prishtinës, Trajnimin për të rinjtë e qytetit për luftimin e dukurive devijuese, me theks të veçantë lufta kundër drogës dhe mbrojtja kundër AIDS-it, etj.

Në këtë drejtim kemi bashkëpunuar me shumë organizata rinore dhe individë në veçanti potencojmë projektin "Muaji Rinor", ku janë angazhuar afro 15 organizata rinore dhe individë të cilët kanë bërë që 30 gushti në Prishtinë të jetë një ditë e të rinjëve. Vlenë për tu theksuar se në kuadër të "Muajt Rinor", për herë të parë në Prishtinë, si pilot- program, u organizuan me sukses "LOJRAT PA KUFIJ".

Drejtorati për Sport, këtë vit dha edhe një provim të madh me rastin e organizimit të Turneut tradicional nderkombëtar të boksit "Adem Jashari" që u mbajt në kuadër të festave të nëntorit. Duhet veçuar edhe turneu i shahut "Memoriali Hyzri Talla", që e organizoi klubi i shahut "PRISHTINA" me mbështetjen materiale të Drejtoratit për Sport dhe Rini të KK të Prishtinës. Ky Drejtorat vitin e kaluar ka ndarë 40 bursa për studentët të cilët janë të angazhuar në klubet e ndryshme sportive dhe në mënyra të ndryshme e ndihmojnë Drejtoratin me punën e tyre kreative dhe organizuese. U organizuan shumë aktivitete me rastin e Ditës së Flamurit si ndeshjet në mes të reprezentacionit futbollistik të Kosovës dhe përfaqësuesve shqipëtar që luajnë futboll në Maqedoni, maratona "Vrapojmë së bashku", "Shtylla e paqes" ndeshje futbollit në mes të Prishtinës dhe njerëzve me uniforma. Përmbyllja e aktiviteteve sportive në komunën tonë kulmoi me shpalljen e sportistëve më të mirë të qytetit.

Gjatë vitit 2003, Drejtorati për Sport dhe Rini realizoi shumë projekte:

Projektet e realizuara për vitin 2003

Nr r.	Emri i Projektit	Shuma	Vërejtje
1	Bursat e studentëve 40 bursa	20000	
2	Maturiada 2003	2000	
3	Dita e fëmijëve "1 Qershori"	3000	
4	Dita e Prishtinës	11900	
5	KF "Minatori" Kizhnicë	2000	
6	Lidhja Komunale e hendbollit -femrat	1070	
7	Klubi i xhudos "IPON"	2000	
8	KF "Besëlidhja" nga Prishtina	2000	
9	Klubi i mundjes "Era" Prishtinë	2000	
10	KF "Rilindja" nga Prishtina	2000	
11	Iniciativa Studentore - Trajnimi në Suedi	3000	
12	Iniciativa Studentore e Rinisë-4 vjetori i bombardimeve të NATO-s	2450	
13	KSH "Prishtina" nga Prishtina	3500	
14	KSH "Kosova" nga Prishtina	1000	
15	KF "Flamurtari" nga Prishtina	2000	
16	KF "2 Korriku" nga Prishtina	2000	
17	KF "Shkëndia" nga Llukari	2000	
18	Muaji i Rinisë	5000	
19	Lojrat pa Kufij - Pishina e Gërmisë	3700	
20	Aktivitete verore në pishinën e Gërmisë	1654	
21	Klubi i boksit "Prishtina" nga Prishtina	1500	
22	Klubi i notit "Ylli" nga Prishtina	1500	
23	KF "Prishtina" nga Prishtina	3000	
24	Shoqata e peshkatarëve "Krapit"	1000	
25	Klubi i karatesë - 2 karateiste në Greqi	700	
26	Vullneti Rinor nga Prishtina	1250	
27	Shoqëria bjeshkatore "Prishtina"	2000	
28	Klubi i zhytjes "Prishtina"	5000	
29	Maratona e Atletikës Prishtinë	5000	
30	Afrim Toverlani-trajner i futbollit	2000	
31	KF "Kosova" nga Prishtina	3000	
32	KF "Ramiz Sadiku" Prishtinë	2000	
33	KH "Prishtina" Prishtinë-femrat	4000	
34	KH "Prishtina" Prishtinë- meshkujt	4000	
35	KF "Kosova" (të rinjve) Prishtinë	3550	
36	Federata e Çiklistëve	600	
37	Bashkësia lokale ne Prapashticë	5000	

38	Turneu i boksit "Adem Jashari" Prishtinë	6000
39	Turneu i shahut "Hyzri Talla" Prishtinë	5500
40	Shoqëria bjeshkatore "Prishtina"	870
41	Gani Kasumi-gazetar sportiv	530
42	OJQ "Handikos" Prishtinë	2200
43	Qendra Rinore - Prishtinë, data 5/11/2003	1600
44	KH "Prishtina" meshkujt	2000
45	Klubi i notit "Prishtina- Oaza" Prishtinë	1000
46	Shpallja e Sportistëve të Vitit	6290
	Gjithsej	153214€

DREJTORATI PËR FINANCA DHE PRONË

SEKTORI I BUXHETIT

Operimi kompjuterik

- Janë nxjerrë 56000 fatura të tatimit mbi pronë për vitin 2003.
- Është bërë regjistrimi i pronave-objekteve të reja.
- Është marrë raporti për pagesat e tatimit mbi pronë nga bankat komerciale.
- Janë regjistruar në kompjuter pagesat e tatimit mbi pronën të bëra nga tatimpaguesit
- Janë regjistruar të gjitha fletëpagesat e gjobave në komunikacion.
- Është bërë përmirësimi në kompjuter i zonave dhe i kategorive tatimore .
- Është bërë përmirësimi në kompjuter i adresave (rrugëve).
- Janë regjistruar në kompjuter aktvendimet sipas ankesave.
- Është bërë përmirësimi i gabimeve eventuale teknike në faturat e tatimit mbi pronën.
- Puna me palë.

Mbledhja e shënimeve

- Është bërë matja dhe regjistrimi i objekteve të paregjistruara gjatë vitit paraprak.
- Janë regjistruar objekte banesore, afariste, industriale dhe garazha.
- Është bërë kontrollimi i objekteve në terren, në bazë të ankesave të tatimpaguesve.
- Puna me palë.

Zyra e shpërndarjes

- Janë përgatitur dhe sistemuar për shpërndarje **54850** fatura taimore.
- Janë shpërndarë në teren **54850** fatura tatimore për tatimpaguesit.
- Janë shpërndarë **25670** letërkujtesa për tatimin në pronë.

Bordi i ankesave

- Është bërë pranimi i **2109** ankesave nga tatimpaguesit.
- Janë shqyrtuar **2109** ankesa dhe janë lëshuar aktvendimet ose janë dërguar komisionet në terren për shqyrtimin e atyre ankesave ku ka qenë i nevojshëm shikimi i gjendjes.
- Është bërë ruajtja dhe arkivimi i ankesave.
- Është bërë përcjellja e aktvendimeve për regjistrim në kompjuter.

Shërbimi i transakcionit të pronës

Gjatë vitit 2003 ky shërbim ka pranuar 3430 lëndë, ku të gjitha lëndët janë kryer në afatin e duhur. Prej tyre janë realizuar 3387 lëndë, ndërsa 43 lëndë ende nuk janë tërhequr nga palët dmth. aktvendimet janë të gatshme, dhe pritet që në afat sa më të shkurtër palët t'i tërheqin ato dhe të bëjnë pagesën.

Arka

Është bërë arkëtimi i taksave për transakcionin e pronave, taksave për shfrytëzimin e hapësirës publike (komunale) si dhe i taksave tjera komunale.

Nëpërmes arkës janë inkasuar.....395815 €.

SEKTORI I PRONËS

OFERTAT-QARKULLIMI I PALUAJETSHMËRISË

Nga 2346 kërkesa janë shqyrtuar 2329 sish.

Në procedurë e sipër kanë mbetur gjithsej 17, lëndë (oferta), për arsye se janë të pakompletuara me dokumentacionin e kërkuar.

UZURPIMET ARBITRARE TË TOKES NË PRONËSI SHOQËRORE

- Sipas kërkeses është bërë identifikimi i rruges në "Rimanisht", procedura është në kompletim të dokumentacionit.
- Sipas kërkesës së Zija Thaçit, është bërë identifikimi i uzurpimit të tokës shoqërore-rruga e "Vushtrisë", dhe është kryer konstatimi profesional.
- Sipas kërkesës së Bashkësisë lokale të Bardhoshit, është bërë verifikimi i uzurpimit të pronës shoqërore- komunale në fshatin Bardhosh. Është arritur marrëveshja që uzurpuesi arbitrar të terhiqet vullnetarisht nga ky uzurpim.
- Sipas kërkesës së ndërmarrjes "Morava e Binçes " është dalë në vend dhe është arritur marrëveshja me palën Fetah Grisholli, i cili e lejon vazhdimin e ndertimit - asfaltimit të rrugës në lagjen "Arbëria", të varrezat.
- Sali Zeneli, pas matjeve dhe verifikimit në terren, e jep pëlqimin që të ndërtohet rruga nëpër pjesën e pronës së tij, që e lidh lagjen e "Arbëris" në fshatin Shkabaj.
- Është nxjerrë aktvendimi lidhur me uzurpimin e rruges në ngastrën kadastrale nr.125/18, Zona katastrale Matiqan.
- Është kryer verifikimi dhe matja e uzurpimit arbitrar të kryer në Kodren e Diellit II, për ngastrat kadastrale nr.20, 24, 25, 36, 37, 40, 41, 44, Zona katastrale Prishtinë. Me këtë ndalet uzurpimi i mëtejshëm arbitrar, caktohet kufiri - mezhda në mes pronës private dhe pronës shoqërore. Lidhur me këtë është mbetur kompletimi i dokumentacionit për marrjen e vendimit përfundimtar sipas ligjit.
- Është kryer verifikimi i uzurpimit arbitrar në rrugën "Nënë Tereze" nr.40, ku është arritur marrëveshja që uzurpuesi arbitrar të lirojë objektin dhe të njejtin t'ia dorëzojë pronarëve vullnetarisht.
- Sipas kërkesës së Hysni Krasniqit nga fshati Llukar, është bërë verifikimi i rrugës së uzurpuar, dhe i është dhënë përgjigje me shkrim palës.
- Në bazë të kërkesës së Afrim Namonit, është bërë verifikimi i uzurpimit, palët tërhiqen vullnetarisht, dhe e lirojnë rrugën "Enver Hadri " në lagjen "K. e Trimave".
- Rexhep Krasniqi, ka bërë tërheqjen e lëndës.
- Është bërë identifikimi i uzurpimit arbitrar të tokës në pronësi shoqërore të rezervuari "Batllava," lënda është në procedurë e sipër.
- Është bërë identifikimi dhe verifikimi i uzurpatorëve të pronësisë shoqërore në vendin e ashtuquajtur "Fusha e Pajtimit", procedura është në vazhdim e sipër.

- Sipas kërkeses së Halit Beqiri, është bërë verifikimi i uzurpimit të pronës komunale nga uzurpatori Ilmi Emin Redenica, në KK.Sofali, procedura është në zhvillim e sipër.
- Sipas kërkesës së Lutfi Misimit, është bërë identifikimi i uzurpimit të rrugës të hekurudha, afër Spitalit të TBBC-së, për çka palët tërhiqen vullnetarisht nga ky uzurpim.
- Është kryer sipas detyres zyrtare verifikimi i lokacionit të pronësisë komunale për fushen e sporteve të vogla në Prishtinë.
- Sipas kërkesës së BL XVIII -lokale, është kryer identifikimi dhe matja në terren për 16 raste të uzurpimit të pronës shoqërore të cilën e shfrytëzon NP Ujësjellesi "Batllava".
- Sipas kërkeses së Drejtoratit për Urbanizëm, është kryer identifikimi dhe matja e 43 rasteve të uzurpimeve dhe shfrytëzimeve të pronës komunale, me të cilën është njoftuar organi i urbanizmit lidhur me gjendjen faktike në terren, për realizimin e projektit sipas planit urban.
- Sipas kërkesës së Komitetit të Pronës është kryer verifikimi dhe identifikimi i objekteve të ish "Voqarit"tani "Urata", dhe Kosovares.

EKSPPROPRIJIMI- DEEKSPROPRIJIMI

Në procedurën administrative lidhur me lëndët e eksproprijimit:

- është nxjerrë aktvendimi mbi eksproprijim në baze tëVendimit të Kuvendit të Komunës për shpalljen e interesit të përgjithshëm, dhe në bazë të dispozitave të Ligjit mbi eksproprijim (Gaz.Zyrt. e Kosoves Nr.21/78 dhe nr.46/86), për ndërtimin e largperqesit të dyfishtë LP 110 kv, prej TC "Kosova A" deri TS 110 /20/10 kv Prishtina 5 lagja "Kodra e Trimave".
 - është bërë informatë lidhur me ndërtimin e rruges nga Investitori - KFOR-it, me të cilin udhëzohen që të kompletohet dhe të përfillet procedura ligjore lidhur me eksproprijim dhe kompenzim të tokës së eksproprijuar nga ish pronaret. Kjo informatë i dergohet: administratorit komunal, kryetarit të Komunës-kryeshefit ekzekutiv, Drejtorisë për Shërbime Publike, Avokatures Publike, dhe KFOR-it.
- Lidhur me natyrën eksproprijimit, gjegjesisht deeksporpinjimit gjatë kësaj periudhe raportuese i kanë arritur gjithsejt 110 lëndë, prej të cilave 92 janë të kryera në procedurë të rregullt administrative, me akte gjegjëse që janë njoftuar palët.
- Në procedurë e sipër janë mbetur edhe 18 lëndë.

MATJE- PROPOZIM CAKTIMI TE LOKACIONEVE

Në këtë lami janë kryer keto punë:

- është verifikuar dhe kryer matja e pronësisë lidhur me lokacionin për ndërtimin, zgjerimin, shndërrimin në gjelbrim të deponisë së qytetit, sipas projektit të Unionit Evropian. Procedura e kompensimit është në vijim e sipër, sipas Ligjit për eksproprijim.
- është kryer caktimi i dipozicioni urbanistik për ndërtimin e Shtëpisë së shëndetit në fshatin Matiqan.
- është kryer verifikimi dhe propozimcaktimi i lokacionit të pronës shoqërore për vendosjen e parkigun të Taxi -traktorëve të qytetit të Prishtinës. Ky lokacion gjendet në lagjen Arbëria-Dragodan, pronë shoqërore, në emër të shfrytëzuesit, ndërmarja e matrijalit ndërtimor " Kosova" në Prishtinë.
- është kryer verifikimi dhe matja, si dhe propozimcaktimi i lokacionit për shoqatën e të verbëreve, për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, për klubin fudbollistik "Rilindja", në Prishtinë, për shkollën filllore në lagjen "Kodra e Trimave", për Shërbimin Policor të Kosovës, me qëllim të vendosjes së shtyllës së faqes për nder të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.
- është kryer Propozimvendimi për kthimin e pronës shoqërore në shfrytëzim Qendrës Universitare në Prishtinë, Propozimvendimi për dhënie të tokës komunale në shfrytëzim KF "2 Korriku" në Prishtinë, propozimvendimi për caktim të çmimit të tokës për kompenzim.

Për të gjitha këto lokacione është kryer propozimi dhe dokumentacioni teknik përcjellëse, dhe si i tillë është dërguar në kompetencë të mëtejme pranë organeve kompetente te Komunes së Prishtines, (Urbanizmit, Komitetit të Pronës etj.)

Shërbimi i transaksionit

Gjatë vitit 2003 ky shërbim ka pranuar 3430 lëndë, ku të gjitha lëndët janë kryer në afatin e duhur. Prej tyre janë realizuar 3387 lëndë, ndërsa 43 ende nuk janë tërënjekur nga palët.

DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Punët e të gjithë këtyre sektorëve në kuadër të Drejtoratit të Inspeksionit janë bazuar dhe koordinuar në bazë të planprogramit për vitin fiskal 2003, gjegjësisht për periudhën raportuese (janar - dhjetor 2003) si dhe të punëve të tjera, të paraqitura kohë pas kohe në bazë të urdhëresave nga organet kompetente komunale, kërkesave të qytetarëve, organizatave komunale shërbyese, të policisë e të tjera.

Në kuadër të Drejtoratit, për punë të Inspeksionit, për periudhën raportuese kanë qenë të angazhuar gjithësej 64 punëtorë.

Në vazhdim paraqitet pasqyra tabelare mbi kryerjen e punëve për periudhën raportuese në mënyrë globale.

Punët e kryera	Sektori i Inspeks. i Tregut	Sektori i Inspeksionit Sanitar-Vet.	Sektori i Inspek.Komunal Komunikacionit	Sektori i Inspek. Ndërtimit	Sektori Bujq. Mbroj.	Gjithsej
Kontrollime	8.797	2.986	10.670	2.576	809	25.838.
Procesverbale	4.569	785	4.145	1096	466	11.061.
Aktvendime	262	893	1.023	425	79	2.682
Fletëparqitje	160	344	1.705	172	29	2.410
a)Gjykatës për kundërvajtje	160	344	1.705	172	16	2.396
b).Gjykatës Ekonomike	/	/	/	/	13	13
Lëndë të vendosura	18	301	1.020.	172	/	1.511
Lëndë të refuzuara	04	11	281	/	/	296
Lëndë në proced.gjyqësore	138	22	204	/	/	364
Vlera e denim.nga gjyk.për kundër.	4.375 €	36.630 €	46.010 € 5.500 €-gjob mand	Denime të ekzekutuara me aktvendim intern në shumë prej 100.398 €.	/	192.913 .€
Pëlqime për kushte minimale teknike	Komisioni i përbashkët me sektorin e tregut			/	/	2.134
Lëndë të kryera nga komisioni	Komisioni i përbashkët			/	/	1.222.
Lëndë të kryera pa i marrë palët	Komisioni i përbashkët			/	/	535
Lëndë kotestuese pa adresa të sakta	Komisioni i përbashkët			/	/	345
Mjetet e inkasuara nga pëlqimet sanitare	Komisioni i përbashkët			/	/	176.839 .€
Mjetet të pa inkasuara nga pëlqimet sanitare	Komisioni i përbashkët			/	/	67.492. €
Gjithësejt mjete të para llogaritur						

Largim të zhardnierëve	/	/	130	/	/	130
Kontrollime teknike të automjeteve	/	/	249	/	/	249
Rekomandime sanitare	/	2.921.	/	/	/	2.921.
Mostra të ujit	/	101	/	/	/	101
Mallra të asgjësuar	/	513.544 €	/	/	18.344	531.888 €
Konfiskim mallrash	14.269,75 €	/	/	/	/	14.269,75 €

I. Sektori i inspeksionit të tregut

Gjatë periudhës raportuese, Sektori i inspeksionit të tregut është angazhuar në realizimin e punëve dhe detyrave të planifikuara, sipas planit vjetor të punës, dhe atë:

- mbikëqyrjen inspektuese të shoqërive tregtare-bizneseve, lidhur me regjistrimin e tyre, marrjen e pëlqimeve nga Inspeksioni për plotësimin e kushteve minimale teknike, sanitare, higjienike, kushteve të mbrojtjes në punë dhe të mbrojtjes së ambientit dhe posedimit e lejës së punës.

- ontrollimin e shitjes së palejuar nga shoqëritë tregtare dhe qytetarët, nëpër rrugë, sheshe publike dhe gjelbëruese, trotuar e gjetiu pa lejen e punës nga organi kompetent i Komunës

- ekspozimin e mallrave para shitoreve, pa leje të organit kompetent.

- resepektimin për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës nga lëmi i tregtisë, hotelierisë, zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Prishtinës.

- pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të qytetarve.

- kryerjen e detyrave sipas urdhërit të drejtorit të Drejtoratit nga kompetencat e këtij shërbimi-Sektori.

- ky sector, për periudhën raportuese ka kryer kontrollime inspektuese të veprimtarive të ndryshme ekonomike, si vijon:

Kontrollime	
Tregti	7008
Hotelier	760
Zejtari	547
Shërbime të tjera	482
Gjithësej	8.797

Procesverbale	5.569
----------------------	--------------

Aktvendime	
Me afat ligjor për regjistrim	262
Udhëzime me procesverbal për regjistrimin e biznesit	1135

Fletëparaqitje për kundërvajtje	
a) Të vendosura	18
b) Të refuzuara	04
c) Në procedurë	138
Gjithësej	160

Denime të arritura nga Gjykata për kundërvajtje, në vlerë prej	4.375.00. €
---	--------------------

Pëlqime për kushte minimale teknike	
a) Lëndë të kryera që i kanë pranuar palët	1222
b) Lëndë të kryera pa i marrë palët	535
c) Lëndë kontestuese, pa adresa të sakta	

	345
Ç) Lëndë në procedurë	13
Gjithësej	2.115

Mjete të përlogaritura nga pranimi i lokaleve afariste	
Të inkasuara nga pëlqimet	176.839 €
Të painkasuara nga pëlqimet	67.492 €
Gjithësej	244.331 €

Ankesa të qyetetarëve	
	15
Mall i konfiskuar në vlerë prej	
	14.269,75 €

Intervenime dhe vërejtje me gojë gjatë aksioneve për pengimin e shitjeve pa leje në rrugë, trotuar dhe ekspozimi i mallrave jashtë lokaleve shitëse.	2.392.
---	---------------

II. Sektori i Inspeksionit Sanitar dhe Veterinar

a) Inspeksioni Sanitar

Aktiviteti i këtij Sektori përfshin:

- kontrollimin e artikujve jetësor dhe mjeteve të përdorimit të përgjithshëm.
- kontrollimin e ujit të pijshëm.
- kontrollimin sipas kërkesave të palëve-detyrë e përhershme.
- kontrollimet higjieno-sanitare të objekteve publike (hoteleve, marketeve, shitoreve, restoranteve, bufeve etj, me destinim të njejtë).
- vizitat në objektet shkollore (kushtet higjieno sanitare).
- kontrollimi i objekteve publike që merren me prodhime dhe qarkullimin e artikujve jetësor, marrja e masave për verifikim të rregullsis së tyre.
- kontrollimi i qoshqeve (hamburger-qebatore, ëmbëltore, për kushtet higjieno-sanitare dhe marrja e masave për verifikim të prodhimeve të tyre.
- kontrollimin e farmacive dhe prodhimeve farmaceutike në territorin e komunës së Prishtinës.

b) Inspeksioni i Veterinarisë bën:

- përgaditjen e planprogramit për vaksinimin e bagtiëve dhe qenëve në territorin e komunës së Prishtinës.
- mbikëqyrjen permanente të mishoreve, NTP dhe DPT, restoranteve, hoteleve etj. ku tregtohen gjërat ushqimore me prejardhje shtazore .
- kontrollimin e qumështoreve dhe prodhimeve të tyre ne menyrë permanente.
- bën kontrollimin higjieno-veterinar të kafshëve, para, gjatë dhe pas therrjes në thertore, - bën shiqimin veterinar të mishit, vulosjen e tij me vulën e Inspeksionit Sanitar, në mishtore.

-kontrollon barnatoret veterinare.

-mbikëqyrë dhe inspekton gjërat ushimore me origjinë shtazore, gjatë prodhimit dhe qarkullimit.

Në bazë të kompetencave dhe obligimeve që ka ky sektor gjatë, periudhës raportuese, ka ndërmarrë këto aksione:

-aksionin në inspektimin e objekteve ushqimore dhe prodhimit të artikujve ushqimorë-inspektimi i objekteve publike (kompanive hoteliere, restoranteve, bufeve) hotel-"Grand", hotel " Iliria", hotel "Prishtina", hotel "Madrid", hotel "Princ", hotel "Baci", hotel "Viktorija", si dhe objektet të tjera që furnizojnë popullatën me artikuj ushqimor dhe me mjete të përdorimit të përgjithshëm, me destinime të njëjta si marketeve, supermarketeve, minimarketeve, shitoreve klasike dhe depove të mëdha që furnizojnë popullatën me artikuj ushqimor.

-aksioni në inspektimin e objekteve për furnizim me ujë të pijshëm dhe higjenik (fabrikat për prodhimin e ujit të pijes-ujësjellësi,"Batllava", ujësjellësi i fshatit Badovc dezinfektimin e tyre, klorizimin si dhe inspektimin e puseve në viset rurale-fshatrat të turnit të parë,të dytë dhe të tretë 2003, për rezultatet e të cilëve janë të dhënat në arkivin e Sektorit.

Fshatrat që janë inspektuar janë marrë mostrat e ujitë, janë: Mutivodë, Hajgobillë, Dabishevc, Prapashticë, Keqekollë, Llukar, Siqevë, Grashticë, Ballaban, Kurtaj etj.

-aksioni në inspektimin e objekteve shkollore dhe atyre parashkollor (foshnjoreve, qerdheve, jetimoreve e të njëgjajshme), SHMM"Dr.Ali Sokoli SHM"Ekonomike" GJP"Xhevdet Doda", SH.M."Gjin Gazulli", si dhe shkollat tjera fillore në qytet dhe në vendet rurale, (për të njëjtat janë përpiluar procesverbalet dhe aktvendimet për eliminimin e të metave higjieno-sanitare, ku disa prej tyre, në bazë të vendimit të inspeksionit sanitar, kanë fituar donacione financiare për rregullimin e gjendjes higjenike të tyre këto janë: SHM e Mjekësisë, SHM Ekonomike, Gjimnazi i Përgjithshëm dhe disa shkolla fillore, dhe objekte parashkollore, Qerdhet e fëmijve "Gëzimi Ynë", "Kindder Sos" dhe jetimorët etj.

-aksionin në inspektimin e objekteve higjieno-sanitare të objekteve të QKU-së (për të gjitha objektet janë përpiluar procesverbalet, dhe aktvendimet për eliminimin e të metave higjieno-sanitare dhe respektimin e rregullave higjenike dhe me këtë janë fituar donacionet nga Ministria e Shëndetësisë dhe organizatat humanitare shëndetësore.

-aksionin në inspektimin higjieno-sanitar objekteve shëndetësore në qytet dhe vendet rurale (shtëpive të shëndetit, ambulancave, punkteve shëndetësore etj, dhe objekteve të tjera ku kryhet vaksinimi dhe revaksinimi i fëmijëve-raportet kalendarike të vaksinimit).

-aksioni në inspektimin higjieno-sanitar të objekteve rekreative (pishinat, dhe objektet tjera sportive), pishina e "Gërmis", pishinës në fashtin Llukar", pishinës me karakter të mbyllët në kuadër të hotelit "Madrid", hotelit "Princi i Arbërit" etj.

-aksioni në inspektimin higjieno-sanitar në objektet e transportit dhe komunikacionit, dhe objekteve tjera lëvizëse e transportuse.)

-aksioni në inspektimin higjieno-sanitar të objekteve farmaceutike (prodhimin dhe qarkullimin e mendikamenteve dhe produkteve medicinale dhe materialit sanitar-depove të mëdha farmaceutike si:

-në NTF"Leka Med","Medisani","Rimed","Sinorg Pharmacy","GentiFarm", "Gentiana" si dhe barnatoret që furnizojnë qytetarët me medikamente me pakicë.

-aksioni në marrjen e mostrave të krypës (NaCl), në përcaktimin e dozës së jodit, (në përmes IKSHPK)-aksioni ka zgjatë 15 ditë.

-aksioni në inspektimin higjieno-sanitar të objekteve të burgjëve në komunën e Prishtinës, është vertetuar dhe inspektuar Burgu i Qarkut në Prishtinë, dhe është përpiluar informata mbi gjendjen higjieno-sanitare të sajë.

-aksioni në inspektimin higjieno-sanitar të objekteve dhe vendbanimeve të sudentëve, (konviktet, restorantit) ku janë përpiluar procesverbalet dhe aktvendimet për menzën e

studentëve, për renovimin e saj, ku ende janë duke u zhvilluar punimet në rregulliminj e saj- në bazë të aktvendimit të Inspektoriatit Sanitar.

-aksioni në eliminimin e ujërave të zeza në qytet dhe në pjesët rurale.

Kontrollime	2.986
Procesverbale	785
Aktvendime	393
Rekomandime sanitare	2.921
Mostra të ushqimit	310
Mostra të ujit në vendet rurale	101
Strisha nga sipërfaqja	424
Fletëparqitje	334
Mall i asgjësuar në vlerë totale	513.544.€
Kontrollime të bagëtive dhe shpezëve	830

Kur kësaj i shtohet edhe vlera e mallit të qitur jashtë përdorimit nga sektori i bujqësisë në vlerë prej 18.344 €, që totali në vlerën e përgjithshme të mallrave të qitur jashtë përdorimit është 513.888 €.

III. Sektori i inspeksionit komunal dhe i komunikacionit

Aktiviteti i punës së këtij Sektori është i bazuar kryesisht në këto veprimtari:

-kontrollimi i rrugëve dhe trotuarve për pastrim nga bora dhe nga hedhurinat e ndryshme, largimin e shitësve nga trotuarët dhe sipërfaqet tjera publike në bashkëpunim me inspektorët e Tregut, Shërbimin Policor të Kosovës dhe të UNMIK-un.

-mbikëqyrja dhe zbatimi i Vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës, mbi kontrollimin e trafikut urban e publik, largimin e autotransportuesve dhe kamionëve me material ndërtimor (me rërë) nga rrugët dhe sipërfaqet publike.

-kontrollimi i mirëmbajtjes së sipërfaqes publike, të gjelbëruar, si p.sh.parku i Gërmisë, parqet tjera të qytetit, kontrollimi i autoparkingjeve, si dhe bashkëpunimi me NPK "Hortikultura".

-kontrollimi i ndërmarrjeve publike siç janë "Higjieno Teknika", "Batllava" etj, mbi mënyrën e kryerjes së shërbimeve të tyre ndaj qytetarve.

-kontrollimi i objekteve publike siç janë stacionet, sheshet si dhe objektet e përkohëshme lëvizëse, panotë, reklamat, firmat ndriqese, mbishkrimet e objekteve afariste zejatre etj.

-ontrollimi i vendosjes së tavolinave e karrikave para objekteve hoteliere, eksponimi i mallrave para lokaleve tregtare, së bashku me Drejtoratin për Pronë.

-kontrollimi mbi zbatimin e Rregullores mbi kufizimin e përdorimit të ujit të pijshëm në mënyrë të pa destinuar, si dhe Rregullores për zhurmë.

-kontrollimi i ndërmarrjeve publike shërbyese si stacionin e autobusëve (për orarin e nisjes dhe arritjes së autobusëve në linjat urbane e ndërurbane).

-kontrollimi i rregullt i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për ujërat fekale dhe atmosferike.

-përgjigjja në kërkesat e palëve rreth paraqitjes së prishjeve të ndryshme të objekteve të infrastrukturës.

-kontrollimi i qoshqeve rreth marrjes së masave ndaj vendosjes së tyre pa leje nga organi kompetent komunal.

-aksionet e përbashkëta me inspektorët e tregut dhe inspektorët sanitar etj, në eliminimin e dukurive negative, të paraqitura në qytet e rrethinë.

Kontrollime	10.670
Procesverbale	4.145
Aktvendime	1.023

Fletëparaqitje për kundërvajtje në gjykat	
a) Fletëparaqitje të refuzuara nga gjykata	281
b) Fletëparaqitje të vendosura nga gjykata	1020
c) Fletëparaqitje në procedurë	404
<u>Gjithësej</u>	<u>1.705</u>

Denime nga Gjykata për kundërvajtje në vlerë prej	46.010.€
--	-----------------

Denime me qortim nga gjykata	89
Gjoha mandatore nga inspektorët	5.500 €

Kontrolla teknike të automjeteve	249
Largim qoshqesh pa leje	293
Largim reklamash pa leje	345
Largim i zhardiniereve	130
Aksionet e përbashkëta me sektorët tjerë për largimin e tregtarëve nga rruga dhe hapësira publike.	56

IV. Sektori i inspeksionit të ndërtimit

Në këtë periudhë, inspektorët e ndërtimit gjatë, kontrollimit të tereneve të tyre kanë vërejtur një mori ndërtimesh për të cilat kanë evidencuar dhe konstatuar :

Objekte	152
Themele	10
Mbindërtim i katit	04
Anekse , ndërtime	04
Shnd.ban.ose bod.lok afariste	18
Mure	08
Tarraca	01
Tenda	05
Plato	07
Garazhe	04
Terrene sportive	02
Ankera	01
Autolarje	06
Baraka	03
Depo	03
Fabrika	02
I përzier	02

Konstruksion druri	01
Lokal afarist	10
Mbindërtime	07
Mbuloja	06
Mihje themeli për bodrum	02
Mur mbrojtës të shkallëve	01
Ndërtesa kolektive	01
Mdërtim i katit	01
Ndryshim i ballkonit , kulmit ,fasadës	04
Objekt montues	01
Objekt përcjellës	01
Objekt shoqëror	01
Pllakëbetoni	01
Pompë benzine	01
Qendër sportive	01
Rrafshim i terrenit	01
Rrethoja	03
Shndërrime	11
Shkallë	05
Sht.ind.ban. dhe afarizëm.	02
Strehë	01
Tejkalim i lejes	01

Tarracë-tend	01
Thyerje e murëve	02
Uzurpime	03
Zgjerime (kulit, tarracë, lokalit)	15
Zyre	01

Masat e marra janë:

Aktvendime për rrenim janë ekzekutuar	312
Shtëpi banimi	10
Garazhe montuese dhe të ndërtuara	253
Shtesa-aneke (tarraca dhe shkallë)	22
Lokale afariste	04
Mure (rrethoja)	23
Auto larje	06
Mbuloja	03
Mbindërtime	06
Konstruksione prej druri	04
Plato-themele	21
Shtylla të betonit	27
Tenda	06

Pengesa të metalta, të vendosura në sipërfaqe publike pa leje nga organi kompetent, janë larguar nga këto rrugë:

1."Nazim Gafurri "
2." Agim Ramadani"
3."Ramë Govori"
4."Ulpiana"
5."Dardania"

Në bashkëpunim me Drejtoratin e Shërbimeve Publike dhe të Pronës janë marrë një varg aksionesh si në krijimin e kushteve për eliminimin e pengesave në rrugë të ndryshme, po ashtu edhe në lirim të pronave .

V. Sektori i Inspeksionit të Bujqësisë, Mbrojtjes së Ambientit

Ky Sektor gjatë periudhës raportuese ka kryer:

Kontrollime	809
Procesverbale	466
Aktvendime	78
Fletëparaqitje	29
Vlera e artikujve ushqimore që janë qitur jashtë qarkullimi	18.344 €

Sasia në kg	2.742
Sasia në lit.	6.268
Fletëparaqitje për kundërvajtje	16
Fletëparaqitje për delikte ekonomike	13
Largimi i automjeteve të avarisura	36

Paraqitja në mënyrë tabelare, e fletëparaqitjeve dhe vendosja e tyre nga gjykatat për kundërvajtje dhe ato ekonomike, nga të gjithë Sektorët e Drejtoratit të Inspeksionit .

<u>Fletëparaqitje</u>	<u>In.Treg</u>	<u>Insp.San</u> = <u>Veterinar</u>	<u>Insp.Kom.Ko</u> <u>munikacionit</u>	<u>Insp.Ndërtim</u>	<u>Ins.Bujq</u> <u>Mb.ambi</u>	<u>Gjithësejt</u>
Gjykatapër kundërvajtje	160	344	1.705	Denime të shqiptuara me akt.vendime interne-172	16	2.397
Gjykata Ekonomike	/	/	/	/	13	13
Lëndë të vendosura	18	301	1.020	172	/	1.511.
L.të refuzuara	04	11	281	/	/	296
Lëndë në procedurë	138	22	204	/	13	377
Vlera e denimeve nga gjykata për kundërvajtje	4.375 €	36.630 €	46.010 €	100.398 €	/	187.413 €

Në aktivitetin e përgjithshëm të Drejtoratit për pos veq punëve të parapara në planprogram, janë përfshirë edhe një varg aktiviteteve tjera me rëndësi për këtë Drejtoratë, si:

- takime shumë të shpeshta me Policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në në drejtim të bashkëpunimit të ndërsjell në liminimin e dukurive negative që rëndojnë qytetarët e qytetit të Prishtinës, si dhe marrja e më së 56 aksionësh të përbashkëta,
- ndryshimi dhe plotësimi i disa rregulloreve që ndërlidhen me aktivitetet e këtij Drejtorati.
- takime me të gjitha subjektet e shërbimeve publike për një bashkëpunim të ndërsjellë, në mënyrë që qytetarët të kenë shërbime sa më solide siq janë: "PTT", "Higjienoteknika", "Batllava", dhe ndërmarrje të tjera të ndryshme, publike dhe shërbyese.
- puna intensive në zbatimin e rregulloreve për largimin e mallrave të ekspozuara në trotuar dhe sipërfaqe publike dhe jashtë lokaleve shitëse, ku rezultati në krahasim në periudhat paraptake është mjaftë i mire diku 70-80 %.Kjo praktikë është eliminuar veçmas në rrugët dhe sheshet kryesore.
- puna mjaft e madhe në zbatimin e rregullores mbi orarin e punës (është arritur rezultat i duhur mbi 90% i zbatueshmërisë).
- organizimi i kujdestarisë, me mjaft sukses, në dy turne, e sidomos gjatë ditëve të vikendit dhe festave.
- organizimi i aksioneve, me SHPK-në, për kontrollimin e lokaleve të natës, gjatë periudhës pas orës 24.00.
- puna mjaft intensive në eliminimin e dukurisë së hargjimit të ujit të pijshëm, ku së bashku me SHPK-në i është kushtuar një rëndësi e veçantë.
- puna intensive i është kushtuar edhe luftimit të dukurisë së shkatërrimeve të nyjeve dhe gjitha formave të kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjetës, ku në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe SHPK-në kemi vepruar me mjaft sukses.

- angazhimi i të gjithë sektorëve dhe aksioneve të përbashkëta edhe me SHPK-në, janë dhe mbesin si një praktikë mjaft e mirë në eliminimin e shumë dukurive negative.
- angazhimin më permanent për eliminimin dhe largimin e qoshqeve pa leje në sipërfaqet publike, e në veçanti para objekteve shkollore, aksion ky që duhet të vazhdojë.
- angazhimi permanent për largimin e reklamave dhe mjeteve të tjera në trotuar dhe vende publike, ky aksion duhet të vazhdohet deri në eliminimin e këtyre dukurive, (gjeneratorët, zhandonjerët, parkingjet artificiale dhe pengesat e tjera).
- angazhimi në largimin me mjaft sukses të garazhave montuese në hapësirat publike, për çka aksioni duhet të vazhdojë deri në përfundim.
- angazhimi me mjaft sukses në eliminimin e dukurisë më të shëmtuar- mbindërtimet, ku kemi shkallën, pothuajse, "zero" gjatë gjithë vitit 2003 dhe do të vazhdohet edhe në të ardhmën në permanencë të veçantë.
- takimet me përfaqësuesit e bashkësive locale, në qytet dhe pjesën rurale të komunës.
- kemi pritur dhe i'u jemi përgjigjur palëve të ndryshme, të paraqitura për raste konkrete.
- kemi pasur një kordinim të duhur në mes të Drejtoratit, Borditë të Drejtorëve dhe stafit e udhëheqës të Komunës.
- për shënimet e evidencuara në këtë raport nga secili sektor veç e veç, dhe atë në mënyrë globale, ekzistojnë të dhënat e përpunuara në mënyrë analitike dhe të aprovuara nga kolegji i shefave të sektoreve të këtij Drejtorati.
- Lidhur me këtë, kohë më parë, nga të gjithë sektoret janë paraqitur kërkesa me shkrim për plotësimin e nevojave të domosdoshme për kushtet e punës.
- caktimi edhe i disa zyrave për të gjitha sektoret, dhe paisjen e tyre me inventar të duhur.
- sigurimi i uniformave të punës për punëtorë të Inspeksionit.
- paisje me aparate të radiolidhjeve si dhe aparateve të fotografimit (ku 70 % janë plotësuar).
- për Sektorin e Inspeksionit Sanitar-është siguruar aparati për matjen e temperaturës, lagështisë, kompresionit të ujit etj.
- paisja me automjete si nevojë me më prioritet, gjë që drejtpërsëdrejti do ta rrisë efikasitetin për punët në terren.
- plotësimi i vendeve të zbrazëta të punës me kuadër të ri.

DREJTORATI PËR KADASTËR DHE GJEODEZI

Gjatë periudhës raportuese ky organ është i angazhuar rreth kërkesave të personave juridikë siç janë: ndërmarrjet shoqërore dhe ato publike, sepse veç kanë filluar përgaditjet nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit për përgaditjen e dokumentacionit rreth privatizimit, ku ky Drejtorat e ka rolin kryesor rreth pronësisë, identifikimit dhe lëshuarjes së dokumentacionit mbi pronësi. Gjithashtu ky Drejtorat gjatë kësaj periudhe është kyçyr në mënyrë direkte dhe indirekte rreth rregullimit, inçizimit për përgaditjen e dokumentacionit për rregullimin e rrugëve në qytet dhe në pjesën rurale të qytetit, sepse të gjithë tenderet e shpalluara për rregullimin e infrastrukturës në qytetin e Prishtinës kërkojnë nga ky Drejtorat që tu lëshohet dokumentacioni mbi pronësi dhe situacionet vertikale dhe horizontale.

Ekspretët e Sektorit për Kadastër kanë kryer punë për palët fizike dhe juridike me matje në teren dhe kryerjen e punëve në përgaditjen e manualeve dhe llogaritjet e nevojshme për të bërë evidencimin në regjistrimin e ndërrimeve në formën e ngastrave, në regjistrat e fletëparaqitjeve.

Këto punë janë kryer nga ekspertët e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi dhe të Entit për Gjeodezi dhe Fotogrametri.

Në terren janë kryer punë të ndryshme sipas kërkesave të palëve fizike, si psh. Identifikimin e ngastrave kadastrale, rilevimet e objekteve, ndarjet e ngastrave në gjendje faktike dhe ndarje të kushtëzuara, ripërtrirjen e kufijve të ngastrave dhe të tjera.

Për palët juridike kanë qenë punë më voluminoze, të cilat janë kryer në terren.

Krahas këtyre punëve, të cilat u cekën më lart, ky Drejtorat ka një obligim ndaj qytetarëve të kësaj komune mbi kërkesat e paraqitura këtij Drejtorati nga personat fizik, edhe pse na mungon i tërë elaborati kadastral, si ai juridik ashtu edhe ai teknik (origjinal), ku gjatë kryerjes së punëve sipas kërkesave të parashturuara si nga personat fizik ashtu edhe nga ata juridikë, hasim në vështirësi për realizimin e kërkesave në mungesë të elaboratit, por falë angazhimit maksimal të stafit udhëheqës dhe punëtorëve, ky organ i ka kryer obligimet me kohë ndaj qytetarëve, ndëmarjeve dhe institucioneve të tjera.

Gjatë periudhës raportuese këtij organi dhe nga ky organ janë lëshuar dhe pranuar ky numër i lëndëve:

1.fletë poseduese.....	4325
2.kopje plani.....	3013
3.çertifikata të ndryshme.....	2150
4.ndërrimet dhe bartjet në operat.....	2214
5.lëndë të terenit.....	603
6.kërkesa të ndryshme.....	273

Kur është fjala te ndërrimet dhe bartjet në operatin kadastral në bazë të dokumentacionit juridik, aktgjykimeve, aktvendimeve si dhe kontrave mbi shitblerjen, një numër i konsiderueshëm prej 157 kërkesave nuk janë kryer për shkak se duhet bërë parcelimi, Që të kryen parcelimi duhet dalja në terren, sipas kërkesës së palëve fizikë, për tu kryer këto lëndë palët fizike janë informuar se janë të obliguar të bëjnë kërkesën Drejtoratit për dalje në teren dhe të paguajnë taksën e terenit.

Një numër i lëndëve 41, të cilat kanë të bëjnë me anulimin e kontratave mbi shitblerjen në mes të personit fizik dhe subjektit juridik, e që kanë të bëjnë me pronën shoqërore, nuk janë kryer sepse për këtë kërkohet pëlqimi i AKM-së (Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit) dhe UNMIK-ut. Mirëpo, gjer më tani nuk kemi marrë asnjë konfirmim me shkrim, edhe pse lëndët e cekura më lart, këtyre dy subjekteve u janë dorëzuar në fotokopje.

Gjatë periudhës raportuese, në procedurë administrative, në bartje dhe ndërrime janë kryer 2150 lëndë, ndërsa lëndët tjera janë kryer në tërësi.

Gjatë periudhës raportuese janë kryer edhe punë të tjera me palë për të cilat nuk ka evidencë sepse këshillimet dhe konsultat e ndryshme nuk evidencohen, e numri i tyre, në një ditë pune, është rreth 60 palë.

Sipas marrëveshjes së arritur në mes të strukturave udhëheqëse të Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe Entit për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike, që të kryehen të gjitha detyrat e parashturuara nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, Enti për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike në Prishtinë, në periudhën janar-shtator 2003, ka punuar për nëvoja të Kuvendit të Komunës si dhe kërkesave të Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi, Shërbimit Pronëso-ro-Juridik dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim të KKPrishtinë, është bërë:

-rilevimi i gjendjes faktike në teren-lokacionit të Presidencës në Zonën kadastrale Matigan, në sipërfaqe prej S=20.00.00 ha.

-për nevoja të Presidencës është rilevuar dhe punuar plani situacioni i terrenit në tri dimensione në sipërfaqe prej S=30.00.00 ha.

-për nevoja të Presidencës, janë punuar 20 harta të rrugëve me emërtime të reja,

-kthimi dhe rilevimi i gjendjes faktike të vijës kufitare, të rrugës Prishtinë-Makovc-Llukar, në gjatësi prej 10 km.

-rilevimi i gjendjes faktike në rrugën Prishtinë-Bardhosh, në gjatësi prej 5 km.

-rilevimi i situacionit të terenit për nevoja të çerdhes së fëmijëve "Gëzimi Ynë", në lagjen "Ulpiana" dhe qytetzën "Pejton", në Prishtinë,

-realizimi i kërkesave të qytetarëve, për ndarje fizike, kthim të kufijve të ngastrave kadastrale, ndrrime të kulturave e.t.j.gjithësej 85 lëndë, më mbi 209 ndarje,

-në Drejtoratin për Kadastër dhe Gjeodezi janë angazhuar dy ekspert,

-për nevoja të asamblesë Komunale janë dhënë mbi 200 harta të rrugëve të qytetit me emërtime të reja,

-për nevoja të Universitetit të Prishtinës, është punuar në ndarjen dhe identifikimin e trojeve në lagjen e Universitetit,

-për nevoja të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës-Fakultetit të Bujqësisë, është punuar situacioni i terenit në sipërfaqe prej S=8.02.00 ha,

-për ndërtimin e Istitutit të Historisë është punuar në caktimin e kufijëve të lokacionit si dhe është punuar situacioni i terenit me prezentimin e pozitës vertikale, në sipërfaqe prej S=0.30.00 ha, sipas vendimit të Asamblesë Komunale të Prishtinës,

-për nevoja të Drejtorisë për Shërbime Publike është punuar në përfundimin e varrezave të qytetit të Prishtinës dhe rilevimi i gjendjes faktike të objekteve egzistuese të ndërtuara, ku numri i tërësishëm i tyre ka qenë 33 ndërtesa banimi,

-rilevimi i gjendjes faktike dhe punimi i situacionit të terenit për ndërtimin e katedralës, në lokacionin e SH.M."Xhevedet Doda" në Prishtinë në sipërfaqe prej S=1.89.50 ha. Duke përfshirë edhe infrastrukturën për rreth shkollës,

-për nevoja të Drejtoratit për Urbanizëm sipas vendimit të Kuvendit të Komunës është punuar rilevimi i situacionit të terenit për ndërtimin e objektit shkollor "Xhevedet Doda" te kompleksi i KNI "R. Sadiku" prapa pallatit të shtypit, ku sipërfaqja e tërësishme është S=6.12.28 ha,

-rilevimi i situacionit të terenit në lagjen "Velania" në sipërfaqe prej S=0.72.00 ha sipas kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit të Prishtinës,

-për nevoja të AKM-së, në zonën industriale është caktuar sipërfaqja prej S=1.00.90 ha mandej është rilevuar gjendja faktike e ish shtëpisë së mallrave "Gërmia" në Prishtinë, në sipërfaqe prej S=0.67.21 ha dhe rilevimi i gjendjes faktike të pallatit të rinisë në sipërfaqe prej S=7.48.25 ha,

-Situacioni i terenit për nevoja të deponis së qytetit në lagjen "Kodra e trimave" në sipërfaqe prej S=8.00.00 ha,

-situacioni i terenit në fshatin Amerikan në zonën kadastrale Çagllavicë në sipërfaqe prej S=10.72.10 ha,

-situacioni për rregullimin e kanalizmit në lagjen "Kodra e Diellit" deri te KFOR-i Francez në gjatësi prej 950 m.

-situacioni i terenit sipas gjendjes faktike të fakultetit të Arkitekturës në sipërfaqe prej S=2.31.90 ha

-rilevimi i situacionit të terenit për tempullin e paqës "Nëna Terezë" në zonën kadastrale Hajvali, në sipërfaqe prej S=20.00.00 ha,

-caktimi i kufijëve dhe rilevimi i situacionit të terenit për nevoja të Zyrës Amerikane në lagjen "Arbëria" ish "Dragodani" sipërfaqja prej S=0.42.53 ha,

-për ndërtimin e spitalit privat rilevimi i gjendjes faktike në lagjen e spitalit në sipërfaqe prej S=3.33.44 ha,

-për nevoja të Kompanisë Hoteliere dhe Turistike "Kosova" është punuar në kthimin e kufijëve dhe rilevimi i gjendjes faktike në sipërfaqe prej S=3.13.30 ha,

- caktimi i vijës kufitare për ndërtimin e tregut të prishtinës në zonën industriale, në sipërfaqe prej $S=3.16.28$ ha,
- rilevimi dhe identifikimi i pjesëve kontestuese në rrugët "27 Nëntori" në lagjen e Kodra e trimave,
- rilevimi dhe identifikimi i pjesëve kontestuese në rrugët "Enver Hadri" në lagjen e Kodra e trimave,
- kthimi i kufirit të ngastrës, sipas kërkesës së Shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" në zonën kadastrale Llukar, në sipërfaqe prej $S=0.31.16$ ha,
- rilevimi i situacionit të terrenit për rregullimin e sheshit "Zahir Pajaziti",
- për nevojat e Shërbimit Policor të Kosovës kemi dhënë mbi 100 harta me emërtime të reja të rrugëve,
- sipas kërkesave të qytetarëve përmesë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi, Enti për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike ka zgjidhur mbi 150 lëndë me mbi 250 ndarje, qofshin ato të kushtëzuara sipas kontratave apo gjendjeve faktike.

Enti për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike, ka dhënë ndihmë të madhe në identifikimin e objekteve dhe pronave të tjera të palëve, në bazë të koordinatave shtetërore, si dhe identifikimin e pronave në vend të ngjarjes për nevoja të organizatave joqeveritare, për ndërtime të objekteve si në zonat kadastrale Graçanicë dhe Llapla Sellë.

Enti për Punë Gjeodezike dhe Fotogrametrike ka ofruar në ndihmë edhe 5 ekspertë të tjerë në kryerjen e punëve të pilot programit si dhe për nevoja të shërbimit pronësoro-juridik të KK Prishtinë, ku edhe më tej vazhdojnë të punojnë në këto programe.

Nga e tërë kjo shihet se për të gjitha punët e cekura, sipas çmimeve të tregut del se vlera e punëve të kryera i ka arsyetuar të ardhurat dhe shepenzimet për tri herë më shumë.

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Pas aprovimit të buxheti për vitin 2003, ne bëmë shpërndarjen e tij sipas parashikimeve dhe prioriteteve. Detyrë prioritare dhe e përhershme ishte furnizimi me barna dhe material tjetër të nevojshëm shëndetësor për mjekësinë primare. Në fillim kishte disa mangësi të vogla, e më vonë, gradualisht u stabilizua edhe ky furnizim. Mangësitë ishin shprehur sepse nga buxheti i përgjithshëm, i paraparë për këtë qëllim, 40% prej shumës së përgjithshme ishte ndalur në Ministrinë e Shëndetësisë, në emër të furnizimit me barna esenciale, e që kishte vonesa të mëdha dhe të pa arsyeshme për realizim. E tërë kjo bëhej për shkak të vonesave në procedurën e prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë. Mirëpo, më vonë edhe ky problem u tejkalua. Furnizimi me karburante, material administrativ, material higjienik si dhe materiale tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të punës në të gjitha institucionet shëndetësore komunale është bërë në kohë dhe në sasi të duhur. Me zgjedhjen e drejtorit të ri (2 maj 2003) u bë edhe plotësimi i vendeve të lira në drejtorat. Tani drejtorati ynë ka gjithësej 13 të punësuar, ka 4 sektorë: Sektori për mjekësi primare, Sektori për shëndetin publik, Sektori për mirëqenie sociale si dhe Sektori për strehim social.

Realizimi i Planit dhe projekteve të parapara ka filluar që në ditët e para të vitit 2003. Kështu, renovimi i QMF në Qendrën e Studentëve mbaroi gjatë muajit mars, në vlerë prej 24.000 €. Më pastaj, në bashkëpunim me CDF-në u përgatit Projekti për ndërtimin e QMF në Mat (Matiqan). Kuvendi Komunal participoi në këtë projekt 61.000 € kurse CDF-ja participoi me 81.000 €. Në tetor kanë filluar punimet dhe objekti është para përfundimit. Realizimi i ndërtimit të objektit për Entin e Ndihmës së Shpejtë Mjekësore ka filluar në qershor të

këtij viti dhe në muajin Dhjetor punët kanë përfunduar. Është formuar komisioni për pranim teknik të objektit, dhe së shpejti pritet raporti i tij. Realizimi i këtij Projekti, duke përfshirë këtu edhe pajisjen me inventar dhe aparaturë mjekësore, arrinë vlerën e përgjithshme në 800.000 €, mjete këto të ndara nga participimi i shërbimeve të mjekësisë primare në komunën tonë. Projekti tjetër i paraparë për renovimin e ndërtesës së Stomatologjisë, në vlerë prej 300.000 €, ka filluar të realizohet në muajin nëntor dhe punët vazhdojnë me dinamikë të paraparë.

Në muajin maj dhe qershor, drejtorati ynë ka vizituar të gjitha ambulancat, një nga një, në viset rurale dhe është njoftuar drejtpërsëdrejti për personelin shëndetësor dhe për gjendjen faktike të objekteve shëndetësore. Drejtorati ka plotësuar kërkesat e nevojshme dhe të mundëshme të këtyre objekteve shëndetësore.

Në Sektorin e **Shëndetit publik** kemi pasur të planifikuara për realizim 4 projekte:

Dezisektimi hapsinor i Prishtinës, Deratizimi i kanalizimit të Prishtinës, Dezinfektimi dhe Rehabilitimi i puseve të ujit të pijës në viset rurale të Prishtinës, si dhe projekti i ashtuquajtur "Vaksinimi Plotësues", që është kryer në afatin e paraparë (06.11- 16.11.2003) dhe është vlerësuar si vaksinimi më i sukseshëm në dekadat e fundit, në Komunën e Prishtinës (99 %).

Projekti i deratizimit, gjegjësisht eliminimi i brejtësve të kanalizimit të qytetit të Prishtinës është kryer në periudhën 29.10 - 13.11 2003. Realizimi i këtij projekti arrin shumën prej 34.615 €. Këtë projekt e ka kryer kompania e specializuar "**DDD Ekologjia**" e Ferizajt. Punën e kësaj kompanie, gjatë realizimit të këtij projekti, e ka përcjellë Komisioni mbikëqyrës i drejtoratit tonë, ekspertë të lëmive përkatëse, dhe kanë konstatuar se realizimi i këtij projekti është bërë me material të paraparë dhe në mënyrë shumë profesionale. Vlen të thekësohet se ky projekt është realizuar për herë të parë në Prishtinë dhe në Kosovë, e që rëndësia e tij është shumë e madhe për ruajtjen e shëndetit të qytetarve tanë.

Desinfektimi dhe rehabilitimi i puseve të ujit të pijës në viset rurale (35 puse) të komunës së Prishtinës është kryer në periudhën 12.11 - 19.12.2003. Vlera e realizimit të këtij projekti arrinë shumën në 25.300 €. Realizimin e këtij projekti e kanë përcjellur me përpikëri Komisioni vlerësues, me ekspertë të lëmitë përkatëse nga drejtorati ynë. Realizimi i këtij projekti është kryer nga kompania e specializuar "**Doctor Exterminator DDD**" Dr. Lulzim KATANOLLI me seli në Prishtinë. Gjithashtu Komisioni vlerësues ka konstatuar se realizimi i këtij projekti është kryer me një organizim shumë të mirë dhe me profesionalizëm të shkëlqyer.

Projekti për dezinfektimin hapësinor të Prishtinës nuk është realizuar. Për realizimin e këtij projekti, nga buxheti komunal, janë ndarë mjete në vlerë prej 100.000 €. Ky projekt nuk është realizuar për shkak të emrimit me vonesë të drejtorit të Drejtoratit, e që kjo vonesë, si pasojë ka pasur edhe shtyerjen e realizimit të këtij projekti. Procedura e prokurimit ka zgjatur mjaft shumë. Derisa është bërë përgatitja e projektit, shpallja e tenderit për ndarjen e këtij projekti, vlerësimet e tij si dhe ankesat e kompanive konkurruese ka kaluar një kohë më tepër se 3 muaj, thenë shkurt ka kaluar koha optimale për efektin e duhur të ndikimit të realizimit të këtij projekti. Pasi që drejtorati ynë e ka shqyrtuar këtë procedurë dhe ka konstatuar se afati optimal për realizimin e këtij projekti ka kaluar, dhe efekti i realizimit të këtij projekti është shumë i vogël, ka vendosë që ky projekt mos të realizohet këtë vit dhe i kanë propozuar Asamblesë Komonale që këtyre mjeteve, të ndara për këtë projekt, tu ndërrohet pozicioni dhe të shfrytëzohen për shpenzime në pajisje me inventar dhe aparaturë mjekësore në Entin për Ndhimë të Shpejtë Mjekësore. Vlera e përgjithshme për këto pajisje është 140.000 €.

Po ashtu, më vonë, në muajin tetor janë përgatitur projektet për renovimin e QMF III dhe QMF V. Tenderët janë shpallur me kohë dhe procedura për ndarjen e tyre është në

përfundim. Vlera e renovimit të QMF III është 100.000 € ndërsa vlera e renovimit të QMF V është 200.000 €. Mjetet për këto investime janë zotuar. Pritet të stabilizohen kushtet atomsferike dhe të fillojë realizimi i këtyre projekteve.

Sektori për mirëqenie sociale ka bërë punë të madhe dhe të palodhshme gjatë gjithë vitit 2003. Ndër aktivitetet kryesore që ka zhvilluar në këtë periudh kohore veçojmë:

- identifikimi i problemeve nga lëmisë sociale dhe përpjekja maksimale për zgjidhjen e tyre.

- verifikimi i gjendjes faktike me daljen e personelit në vendshiqim.

- pranimi i palëve, dhënia e udhëzimeve dhe instruksioneve për zgjidhjen e problemit.

- Pranimi, selekcionimi, klasifikimi dhe vendosja e kërkesave të prashtruara të këtij sektori,

- raporti javor i drejtorit të Drejtoratit lidhur me punën e këtij sektori,

- kryerja e punëve tekniko administrative në kuadër të sektorit.

- kontaktet dhe koordinimi veqmas me Sektorin e strehimit.

- kontaktat dhe koordinimi brenda komunës.

- kontaktet dhe koordinimi me Departamentin Qëndror nga ky lëmë.

- kontaktet me UNMIK-un, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, më Qendrën për Punë Sociale, dhe me kryetarët e BL.

Në muajin nëntor është përgatitur projekti i emërtuar si " Program Dimëror". Qëllimi i këtij programi ka qenë ndihma për dimër familjeve ekonomikisht më të rrezikuara dhe varfnjake. Në këtë program janë përfshirë 1030 familje, duke përfshirë këtu edhe familjet nga minoritetet. Ndhma u është dhënë në mënyrë lineare nga 80 € (2m³ dru) çdo familje. Ky projekt u realizua në fund të muaji dhjetor 2003, mjete këto të ndara nga buxheti i Kuvendit Komunal.

Sektori për strehimit social aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në rastet sociale për të cilat duhet bërë zgjidhjen e çështjes së strehimit, dhe në rindërtimin e shtëpive të djegura gjatë luftës. Gjatë këtij viti kemi strehuar 13 familje dhe një individ në strehimorën e konviktit të Shkollës normale, pra gjithësej 32 anëtar. Po ashtu kemi lëshuar 39 rekomandime drejtuar HABITATIT, me kërkesën e palëve për shteyrjen e afateve të ekzekutimit të vendimeve për të lëshuar banesat e huaja. Duke u bazuar në Programin e rindërtimit të shtëpive për vitin 2003 bashkësia ndërkombëtare ka financuar ndërtimin e 10 shtëpive të djegura dhe të shkatërruara nga lufta. Së bashku me Komitetin Komunal të Rindërtimit pas asistimit të shtëpive të djegura është bërë lista prioritare e ndërtimit. Gjatë këtij viti kemi pasur 189 kërkesa për ndërtim dhe 90 kërkesa për strehim social. Ne bashkëpunim me SHPK-në dhe Policinë e UNMIK- ut kemi shqyrtuar problemin e shkaktuar nga lypësit e rrugëve në qytetin tonë, ku pjesa dërmuese e tyre vinin nga Shqipëria. Janë organizuar 6 herë aksione për largimin e tyre dhe këta lyëpsa janë depërtuar në Shqipëri në pikën kufitare Vermicë.

Në sektorin e strehimit social janë bërë edhe shumë punë të tjera, në forma të ndryshme të ndihmave nevojtarve, për banim social, me qëllim që tu përmihsohen kushtet për banim të përkohshëm social.

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE, TRANSPORT DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

1. Uji dhe kanalizimi:

- Rruga 27 "Nëntori": ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në gjatësi prej 1.130 m dhe kanalizimi atmosferik 120 m.
- Rruga "Kosta Novaković"; ndërtimi i rrjetit atmosferik dhe fekal në gjatësi prej 400m.
- Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në rr."Ismil Dumoshi " dhe "Afrim Loxha" në gjatësi prej 330 m,
- Rruga "Rugova" ujësjellësi dhe kanalizimi fekal në gjatësi prej 320 m,
- Rruga "Enver Hadri", ujësjellësi dhe kanalizimi 385 m,
- Rruga "Xhevat Begolli" kanalizimi fekal 80 m,
- Rruga "Mustafë Veseli" kanalizimi atmosferik 100m,
- Rruga "Gjon Sereqi", kanalizimi atmosferik dhe ujësjellësi në gjatësi prej 648 m,
- Rruga "Mic Sokoli" ujësjellësi 310 m,
- Rruga "Gazmend Zajmi", kanalizimi fekal, atmosferik dhe ujësjellësi në gjatësi prej 200 m,
- Rruga "Rahim Beqiri", kanalizimi atmosferik 200 m,
- Lagja "Lakrishte", ndërtimi i kanalizimit fekal në gjatësi prej: rrjeti primar 140 m, rrjeti sekondar 340 m,
- Lagja "Mat" kanalizimi i kombinuar në gjatësi prej 400 m dhe
- Kanalizimi fekal në rrugën "Muharrem Fejza" në gjatësi prej 800m,
- Pastrimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik në 39 rrugë dhe
- Ndrimi i 126 grilave në qytet.

2. Shërbimi elektro-energjetik:

Gjatë vitit 2003, në këtë Shërbim kanë aritur 106 kërkesa nga lëmi i energjetikës dhe ai i PTK-së. Janë zgjidhur në forma të ndryshëm 104 soh, ndërsa 2 prej tyre gjinden në procedurë e sipër dhe kishin këtë përmbajtje:

vendime 24, oferta 9, lajmërimi 17, fatura 33, informata 14, padi 2, raporte 1, pëlqime 2, urgjenca 2, në procedurë 2 = gjithsej: 106

3. MIRËMBAJTJA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, për vitin 2003 kanë qenë mjetet e siguruar nga bugjeti i Komunës së Prishtinës në shumë prej **133.000,00 €**.

Në bazë të kontratës nr.01-13/03, të dt.08.08.2003 puna për mirëmbajtjen e ndriçimit publik ju besua NPE "MONTEN" nga Prishtina, e cila deri më 16.12.2003 e ka realizuar tërësisht programin e vitit 2003.

Gjatë vitit 2003, kjo ndërmarrje ka riaktivizuar dhe mirëmbajtur ndriçimin publik në këto rrugë:

"Nëna Terezë", "Dëshmorët e Kombit", "1 Tetori", "Fehmi Lladrovci", "Enver Maloku", "Eqrem Qabej", "Biblioteka Univerzitare Kombëtare e Kosovës", "Agim Ramadani", "Bill Clinton", "Ilir Konusheci", "UÇK-së", "Nazim Gafuri", "Migjeni", "Luan Haradinaj", "Lidhja e Pejës", "Hamdi Gashi" (te Presidenca), "Vllëzërit Fazliu", "Ismet Krasniqi", "Mic Sokoli", "Jakup Feri", "Kadri Zeka", "Qeta e Llapit", "Meto Bajraktari", "Dr. Shpetim Robaj", "Rrustem Statovci", "Isa Kastrati", "Gazmend Zajmi", "Kadri Zeka", "Xhavit Ahmeti" = **Gjithësejt 29 rrugë**.

4.SANIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK

Për sanimin e ndriçimit publik kanë qenë të siguruara mjetet në shumë prej **87.000,00 €**.
Në bazë të kontratës nr. 01-13/03 të dt. 27.11.2003 puna për sanimin e ndriçimit publik iu besua NPT "ELEKTROMONTIMI" nga Klina, e që është në realizim e sipër.
Deri më 31.12.2003 ndërmarrja në fjalë ka riaktivizuar ndriçimin publikë në rr. "Rrustem Statovci", "Isa Kastrati", "Bedri Shala", "Bajram Bahtiri" dhe "Zagrebit" gjithësejtë 5 rrugë. Momentalishtë është duke u përgatitur plani për sanimin e ndriçimit publik në rrugën e "Tiranës".

6.NDËRTIMI I RI I NDRIÇIMIT PUBLIK NË RR. "KOSTA NOVAKOVIQ"

Për ndërtimin e ri të ndriçimit publik në rr."Kosta Novakoviq" kanë qenë të siguruara mjetet në shumë prej **23.423,20 €**
Në bazë të kontratës nr.02-55/03 të dt. 05.09.2003 punët në ndërtimin e ri të ndriçimit publik në rr. "Kosta Novakoviq" ju besuan NSH "ENERGOMONTIMI" nga Prishtina dhe kanë zgjatur prej dt.09.09.2003 deri më dt.09.11.2003, që është realizuar tërësisht.

7.MIRËMBAJTJA E SEMAFORËVE

Për mirëmbajtjen e semaforëve kanë qenë të siguruara mjetet në shumë prej **79.350,00 €**.
Në bazë të kontratës nr. 01-2/03 të dt. 07.04.2003, punët në mirëmbajtjen e semaforëve ju besuan DPZ "JAME" nga Prishtina, e cila ishte në realizim e sipër dhe zgjatën deri më 28.02.2004.

9.RIKONSTRUIMI I RRJETIT 380/220V NË RR. "27 NËNTORI'

Për ndërtimin e rrjetit 380/220V, në rr."27 Nëntori" kanë qenë të siguruara mjetet në shumë **24.656,89 €**
Në bazë të kontratës nr. 02-69/03 të dt.08.09.2003 punët në ndërtimin e rrjetit 380/220V, në rr."27 Nëntori" i është besuar NPTSH "SNAAB"nga Prishtina, në shumë 10.813,19 € dhe Aneksë kontratës nr /03, të dt., në shumë prej 13.843,70 €, e që është realizuar në tërësi.

10.Ngrohja

Sa i përket ngrohjes, Drejtorati nuk ka shënime dhe informata të sakta rreth punës së ndërmarrjes në fjalë, përpos ndërtimit të gypave të termopërquesit nëntokësor në lagjen: -"Dardania", pjesërisht në rrugën "Nëna Terezë", "Robert Doll", "Eçrem Çabej" dhe në lagjen "Kodra e Diellit",
-Ndërtimi i nënstacionit të ngrohjes në lagjen "Kodra e Diellit"

11.Higjiena publike në qytet

Mirëmbajtja e pastërtisë dhe higjienës në qytet është realizuar përmes NP "Higjeno-Teknika" dhe Kompania "Zahiri", të cilat janë kontraktuese me Komunën,
Punimet janë realizuar sipas kontratës dhe Planit të hartuar të punës,
-niveli i pastërtisë së qytetit është ngritur dukshëm, sikurse edhe mirëmbajtja e rrugëve, gjatë stinës së dimërit.

12.Varrezat

-është bërë ndërtimi i rrugëve në varreza e reja të qytetit,
- mirëmbajtja e Kompleksit të varrezave ende nuk është në nivelin e duhur (përgjigjëse është Higjenoteknika).

II. SEKTORI I TRANSPORTIT DHE MBROJTJES SË AMBIENTIT:

-projektpropozimi për rregullimin e trafikut urban-hapjen e linjave të reja për fshatrat e komunës,

-rindërtimi i rrugëve të qytetit

-mirëmbajtja e semaforëve sipas kontratës vjetore,

-realizimi i konkursit për auto-taxit,

-vazhdimi i vendosjes së sinjalizimit horizontal dhe vertikal,

-mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit,

a). Rrugët

Mirëmbajtja, rindërtimi i infrastrukturës rrugore gjatë vitit 2003, është realizuar konform buxhetit të planifikuar (realizuar), si vijon:

Nr.	Emri i rrugëve	Dimensionet e rrugëve			Ekzekut.	Mjetet e planifik.(€)
		Gj.(m)	Gjë.(m)	Sip.(m ²)		
1.	27.Nëntori	910	6	5.460	ndërtim	374.934,97
2.	Kosta Novakoviç	480	6	480	-//-	202.024,76
3.	Norbert Jokel	275	6	1.650	-//-	-
4.	Bedri Shala	910	6	5.460	-//-	-
5.	Mustafa Kruja	120	6	720	-//-	-
6.	H. Kadri Prishtina	359	5.5	1.974,5	-//-	161.866,74
7.	Mirëmbajtja e rrugë.	1.000	6	6.000	-//-	79.361,50
8.	M. Fejza vazhdim	881	6	5.286	-//-	235.916,20
9.	Bajram Bahtiri/E.Lir	1.650	6	9.900	-//	76.940,75
10.	Eduard Lir+m.mbrojt.	290	6	1.740	-//-	85.163,82
11.	Ismajl Dumoshi	550	6	3.300	-//-	-
12.	Afrim Loxha	130	5	650	-//-	64.649,77
13.	Hasan Remniku	783	5.5	4.306	-//-	-
14.	Rugova	400	6	2.400	-//-	190.049,12
15.	Enver Hadri	550	6	3.300	-//-	70.971,38
16.	Ibrahim Krasniqi	235	4.5	1.282	-//-	21.245,00
17.	Xhemë Elezi	130	5	650	-//-	9.523,15
18.	Haki Pavataj	80	5	400	-//-	11.340,67
19.	Rr.lidh.H.Remniku	229	4.5	1033	-//-	11.558,78
20.	Rexhep Mala	600	6	3.600	-//-	-
21.	Ark. Karl Gega	200	6	1.200	-//-	-

22.	Edmond Hoxha	620	5	3.10	-/-	-
23.	Rrustem Statovci	600	6	3.600	-/-	95.231,27
24.	M.P.Deralla	92	4	368	-/-	-
25.	M.A.Vrioni	109	4.5	490.5	-/-	5.430,50
26.	rr.lidhse 27.Nëntori	70	5	350	-/-	7.697,81
27.	rr.lidhse 27.Nëntori	40	4.5	180		3.120,53
28.	Xhevat Begolli	80	4.5	360	-/-	21.969,75
29.	Mustafë Veseli	100	6	600	-/-	13.633,25
30.	Karadaku / N.Gashi	150	5.5	825	-/-	7.000,00
31.	Gjon Sereqi	648	6	3.888	-/-	128.020,00
32.	rr.lidhëse H.Remnik	230	4.5	1.035	-/-	11.558,78
33.	Emrush Miftari I	289	3.6	1040.4	-/-	16.822,00
34.	Emrush Miftari II	200	5	1.000	-/-	16.836,34
35.	Rr.lidh. me Vlorën	90	4	360	-/-	6.303,73
36.	Te Medresja (lindje)	100	4	400	-/-	9.082,70
37.	Xhevat Begolli (vazh)	108	4.5	486	-/-	13.086,88
38.	rr.lidh.H.Remnik	132	4	528	-/-	8.182,02
39.	rr.lidh.27.Nëntori	70	5	350	-/-	2.414,08
40.	Vlora	215	5	1.075	-/-	23.969,75
41.	rr. I rr.Rugova	37	5	185	-/-	2.000,13
42.	Dervish Shaqa	250	5	1.250	-/-	16.150,00
43.	R.Terpeza (27.Nënt)	100	4	400	-/-	9.034,00
44.	Mic Sokoli	310	6	1.860	-/-	24.345,50
45.	rr.lidh. Isa Kastrati	64	4	256	-/-	3.462,14
46.	Rruget e varrezave	1.682	6	10.092	-/--(në real)	268.839,76
47.	Xheladin Hana	450	6	2.700	sanim	23.453,10
48.	Rrahim Beqiri	400	6	2.400	-/-	23.805,00
49.	Ali Pashë Tepelena	200	6	1.200	-/-	7.286,40
50.	Isa Kastrati	400	6	2.400	-/-	24.857,25
51.	Gazmend Zajmi	900	6	5.400	-/-	24.995,25
52.	Drenica/Llapi	gropa			-/-	8.447,42
53.	St.Perif.Urban				zhavor	5.801,80
54.	Rexhep Krasniqi	1.200	5	6.000	zhavor	23.594,55
55.	Shefqet Shkupi	1.100	5	5.500	zhavor	21.884,50
56.	rr.te "Tjerrtorja"				zhavor	652,00

57.	Mbushja e.gropave				në realiz.	23.670,45
58.	Mirëmb.rr.rurale I.II.III.				-//-	24.969,00
59.	Park.(trak.motokul)				në realiz.	4.416,00
60.	Ura Sh,Shkupi				është real.	7.600,35
61.	Ura prr. Mati				në realizim	7.871,75
	Gjithsejt	21.689,0 0	5.3 5	117.680, 40		2.554690.3 5

Rekapitulim: Janë ekzekutuar 66 projekte, prej tyre 63 rrugë (ndërtim dhe asfaltim), 60 rrugë me asfalt, 3 me zhavor, 2 ura dhe 1 mirëmbajtje dimërore. Gjithsejt, janë shtruar 21.689 m' asfalt (15.505 m' rrugë me shtresë përfundimtare dhe 6.184 m' sanim i gropave me zhavor).

Transporti publik i udhëtarëve

Organizimi i trafikut

- Në ndërkohë është hartuar Rregullorja e re për trafik urban, e cila në parim është aprovuar nga Kuvendi Komunal dhe implementimi i saj do të realizohet gjatë vitit 2004.
- Transporti jashtlinjor (kryesisht auto taxi), gjithashtu është realizuar pa probleme të mëdha dhe konformë rregullorës ekzistuese.

Parkingjet

Nuk janë krijuar parkingje të reja por është bërë vetëm mirëmbajtja e tyre. Gjithësejt ekzistojnë rreth 1500 parkingje publike buzë rrugëve

Semaforët

- Rrjeti semaforik në qytet (15 kryqëzime) është mirëmbajtur nga kontraktuesi, i cili e ka fituar tenderin nga Komuna.

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal:

- Kryesisht është investuar në plotësimin e tyre dhe është punuar në 43 rrugë. Përparësi i është dhënë udhëkryqeve, rrugëve kryesore dhe atyre që gjinden në afërsi të shkollave etj.

Sinjalizimi horizontal

- vijë e nderprerë janë sinjalizuar 2684.5 m gjatësi,
- vijë e pandërprerë 1168 m gjatësi,
- vendkalime të këmbësoreve 4232 m gjatësi,
- shigjeta njëshe dhe dyshe në udhëkryqe janë punuar 110 copë,
- vijë zigzag në stacione të autobusëve 120 m gjatësi,
- katrorë 50x50, 41.5 m gjatësi,

Sinjalizimi vertikal:

-panela trekëndëshe janë vendosur.....	50 copë
-panela rrethore.....	78 copë
-panela katrore.....	74 copë
-tabela plotësuese.....	28 copë
-shtylla antiparking.....	87 copë

Shërbimi i mbrojtjes së ambientit:

Nga Buxheti i Komunës së Prishtinës janë siguruar mjete prej 200.000 € për kryerjen e këtyre punëve të këtij shërbimi.

Në bazë të kontratës nr. 01/12/2003 të datës 29/05/2003 është bërë marveshja me ndërmarrjen komunale "Hortikultura" do të ben mirëmbajtjen e gjelberimit të këtyre pjesë të qytetit të Prishtinës, në vlerë 81.331,77 €.

-Zona e parë përfshin sipërfaqet gjelbruese të "Parkut të Qytetit", "Tauk Bashqen" dhe rr. "Nazim Gafurri".

-Zona e dytë përfshin lagjen "Ulpiana".

-Zona e tretë përfshinë sipërfaqet gjelbruese në "Qendra e Qytetit" pastaj lagjen "Kodra e Diellit", "Përmendoret e Dëshmorëve", "Dardania", "Lakrishtë", sipërfaqet mbi urë në rrugën magjistrale Prishtinë - Mirtovicë dhe rr. "Bill Clinton", deri te kryqëzimi i semaforëve të Fakultetit Filozofik.

Në këtë shërbim kanë arritur 15 raporte të tiketave për laurën në Gërmi, poashtu edhe 22 kërkesa për gjelbrim 11 prej te cilave janë të realizua në bazë të pëlqimit të Drejtoratit për Urbanizëm dhe Ndërtimtari .

DREJTORATI PËR MBROJTJE CIVILE DHE EMERGJENCË

Raporti i punës së Drejtoratit për Mbrojtje Civile dhe Emergjencë për periudhën janar - dhjetor 2003, përfshinë aktivitetin e programuar dhe të planifikuar të njëjësive organizative, bashkëpunimin e ngushtë me drejtoratet e tjera komunale, Departamentin e Menaxhimit Emergjent në Ministrinë e Shërbimeve Publike, TMK -ën, ShPK-ën, UNMIK-un, KFOR-in, dhe Drejtoratin e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës në nivel të Kosovës dhe subjektet e tjera të Komunës.

Për punë të sukseshme të Drejtoratit si orientim programor dhe normativ kanë shërbyer:

-Draf rregullorja mbi shërbimin emergjent të Kosovës,

-fushëveprimi i Drejtoratit, planifikimi vjetor i punës së Drejtoratit të Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës dhe Brigadës së zjarrfikësve,

-realizimi i detyrave të planifikuara gjatë vitit,

-vizitat e ndryshme në bashkësitë lokale dhe nën ndërmarrje publike komunale, drejtorate të ndryshme të mbrojtjes civile dhe emergjencës nëpër komunat e Kosovës,

-Seminaret, trajnimet, bisedat, takimet dhe marrëveshjet e shumta me stafin lokal dhe atë ndërkombëtar.

Njëra nga prioritetet për realizim, gjatë vitit, kanë qenë edhe obligimet që kanë dalë nga mbledhja e Bordit të drejtorëve të Kuvendit Komunal.

Në periudhën raportuese njëvjeçare, një vend meritore e kanë zënë ushtrimet e organizuara nga Drejtorati i ynë, Departamenti i Menaxhimit Emergjent i Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe subjekteve të tjera relevante. Me këtë rast duhet patjetër të cekën këshillimet e ndryshme, seminarët, trajnimet e shumta në nivel komunal dhe atë qendror (psh. trajnimet

në kompjuter të bashkëpunëtorëve të Drejtoratit, trajnimet e zjarrfikësve të posa pranuar në punë në kohëzgjatje prej dy javësh e që është mbajtur në Vushtrri) etj.

Vlen të theksohet gjithësesi puna e palodhshme që është bërë në bashkësitë -lokale, ku janë formuar shtabet e mbrojtjes civile dhe emergjencës (BL me prioritet) pastaj ngritjes profesionale e erprorëve të Shtabit Komunal të mbrojtjes civile dhe emergjencës dhe njësisë së tij.

Rregullisht, praktikohet që çdo të hënë të mbahet Kolegjiumi i Drejtoratit, të cilin e udhëheqë vetë drejtori, e ku debatohet për detyrat e realizuara dhe ato që duhet të realizohen në javën në vijim.

Është planifikuar që në javën e katërt të janarit të organizohet një trajnim profesional me erprorët e Shtabit të Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës, komandantët dhe ryeshefët e Shtabeve të mbrojtjes civile dhe emergjencës të emëruar, nëpër ashkësi Lokale.

Sektori i emergjencës, në këtë periudhë kohore njëvjeçare zë një vend të rëndësishëm në Drejtoratin tanë me aktivitetet e tij. Këtë duhet nënvizuar, veçmas angazhimin e Brigadës së zjarrfikësve në intervenimet emergjente profesionale dhe mjaft të sukseshme, gjatë këtij viti në shuarjen e zjarreve, që këtë vitë ishin të shumta. Falë intervenimit të shpejtë dhe efikas të Brigadës së zjarrfikësve, dëmet materiale janë zvogluar shumë, e viktima në njerëz nuk ka pasur.

Qendra Komunale për Informim, Alarmim dhe Koordinim Emergjent zë një vend shumë meritor në realizimin e detyrave të parashtruara nga jashtë dhe të programuara nga vetë ajo. Janë një mori informatash për nevojën e intervenimit dhe sanimit të pasojave nga zjarri, vërshimet dhe dëbora në komunë dhe më gjerë.

Këtu po i cekim vetëm disa raste më karakteristike në të cilat kanë marrë pjesë edhe udhëheqësia më e lartë e Komunës, në krye të së cilës ishte Kryetari i Komitetit për Gadishmëri Emergjente, zotëri Ismet Beqiri, me rastin e shembjes së dheut në Mihjen sipërfaqësore në fshatin Mirash, më 05.01.2003 më ç'rast kanë marrë lëndime të rënda 4 punëtorë, dhe jënë bërë dëme materiale, përhapja e zjarrit në Gërmi dhe në fshatin Vranidoll-Barilevë, pastaj shpërthimi që ka ndodhur në diskotekën "Njujork" ku janë lënduar seriozisht 4 qytetarë, rëshqitja e dheut në lagjen "Arbëria", zjarri që ka shpërthyer në rrugën "Rexhep Luci" në Prishtinë, zjarri e kishte kapluar një banesë në katin e katërt ku për pasojë kishte vdekur një grua e moshuar ishte lënduar bashkëshorti i sajë dhe ishte lënduar një polic. Falë informimit profesional dhe me kohë i Qendrës Komunale për Informim, Alarmim dhe Koordinim, dëmet në raste emergjente janë zvogëluar dukshëm.

Aftësimeve profesionale dhe trajnimeve të personelit në Drejtoratin tonë iu është kushtuar një kujdes i veçantë gjatë këtij viti. Vlen të përmendet se në trajnimet e organizuara nga Departamenti i Menaxhimit Emergjent i Ministrisë së Shërbimeve Publike, udhëheqjes komunale dhe organizatave joqeveritare kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i bashkëpunëtorëve profesional të Drejtoratit siç janë:

- trajnimi në temën: Planifikimi i projekteve, i cili ka zgjatur tri ditë dhe është mbajtur në Prishtinë,
- planifikimi strategjik, tri ditë në Prishtinë,
- barazia gjinore, dy ditë në Prishtinë
- dialogu me palët, shtatë ditë në Prishtinë,
- mbrojtja e e siguria, shtatë ditë në Vushtrri,
- mbrojtja nga materijet e rrezikshme, shtatë ditë në Brezovicë.

Trajnimet e tilla kanë pasur sukses nga se personeli i trajnuar i'u ka qasur realizimit të detyrave në bazë të udhëzimeve të marrurra nga udhëheqësit e trajnimeve, që kanë qenë profesionalë në lëmjt e caktuar.

Është vlerësim i yni se raportimet dhe informimi me kohë, dhe në mënyrë adekuate mbi të gjitha të arriturat tek ne dhe në komunë kanë qenë mënyra dhe forma shumë adekuate të përcjelljes dhe informimit mbi ngjarjet aktuale te ne dhe më gjerë.

SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

Sektori i mbrojtjes civile ka punuar në venien e bazës organizative dhe operacionale të mbrojtjes civile dhe emergjencës nëpër bashkësi lokale, ndërmarrje publike komunale në territorin e komunës.

Qëllimi i veprimtarisë sonë ka qenë ngritja sa më në nivel të organizimit dhe veprimit në rastet emergjente në mbarë territorin e komunës, kemi konstatuar, në nivel të Drejtoratit, se këto objektiva dhe synimet tona të parashtruara në programet tona janë arritur në tërësi dhe është ngritur niveli i gatishmërisë profesionale të punëtorëve të Sektorit në arritjen e qëllimeve të parashtruara.

Një kujdes të veçantë këtë vitë qysh në fillim të vitit i kemi kushtuar një kujdes të vacantë punës në terren. Në nivel të Drejtoratit janë formuar tri grupe punuese në terren në bashkësitë lokale në qytet në ndihmë referentëve të bashkësive lokale dhe në plotësimin e kartelës familjare. Për dy muaj pune në terren kemi arritur t'i realizojmë detyrat e planifikuara afër 90%.

Për këtë punë në terren kemi përgatitur raport me shkrim dhe i kemi njoftuar organet përkatëse komunale.

Një punë tjetër me rëndësi e kemi kryer në bashkësitë lokale të qytetit dhe fshatrave, si dhe ndërmarrjeve publike dhe komunale, ku për qëllim kemi pasë verifikimin e mënyrës së organizimit të sigurimit të objekteve të tyre dhe të dokumentacionit. Bashkëpunëtorët tanë që ishin në terren përpos kontrollit, ju kanë dhënë edhe këshilla profesionale, dhe për këtë kemi përgatit raport me shkrim dhe i kemi njoftuar organet përkatëse komunale. Në proceset tona u kemi propozuar edhe masat e duhura për organizimin e sigurimit të objekteve të tyre dhe dokumentacionit.

Në realizimin e detyrave, të planifikuara për periudhën raportuese, një qasje të veçantë dhe mjaft kualitative i'a kemi kushtuar organizimit të punës në terren dhe vizitave të bëra në bazë të planeve të punës konkrete mujore dhe vjetore.

Për realizimin e këtyre objektivave kemi hartuar Kornizën orientuese të prioritetit mbi organizimin e mbrojtjes civile dhe emergjencës nëpër bashkësitë lokale dhe ndërmarrje publike komunale.

Me rastin e vizitave dhe bisedave, të organizuara nëpër këto subjekte janë marrë shënime konkrete ku janë evidencuar kuadrot për përfshirjen e tyre nëpër shtabe dhe njësi të mbrojtjes civile dhe emergjencës, janë hartuar listat konkrete me njerëz dhe kemi startuar me konstituimin e Shtabeve.

Gjatë vitit 2003 i kemi formuar shtabet e mbrojtjes civile dhe emergjencës në këto bashkësi lokale:

1.BL të qytetit:

- Bashkësinë e parë lokale,
- Bashkësinë e dytë lokale,
- Bashkësinë e tretë lokale,
- Bashkësinë e kartërt lokale,
- Bashkësinë e gjashtë lokale,
- Bashkësinë e dymbëdhjetë lokale,
- Bashkësinë e dymbëdhjetë një lokale,
- Bashkësinë e pesëmbëdhjetë lokale.

Në zonen rurale: Keqekollë, Marevc, Barilevë, Llukar, Shkabaj, Mramuer, Besi, dhe Hajvali
Në Planin për formimin e shtabeve të mbrojtjes civile dhe emergjencës në bashkësi lokale është paraparë që edhe gjatë vitit 2004 të vazhdohet me konstituimin e shtabeve në të gjitha bashkësitë lokale të komunës.

Vlen të theksohet se në formimin e shtabeve të mbrojtjes civile dhe emergjencës në bashkësi lokale kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Drejtoratit tanë, ku kanë dhënë kontribut profesional. Puna inspektuese nga lëmi i mbrojtjes civile dhe emergjencës bazohet në dokumentet themelore orientuese dhe prioritare të organizimit të mbrojtjes civile dhe emergjencës për komunën e Prishtinës si dhe në objektivat prioritare për periudhën shtator - dhjetor 2003. Në pajtim me këtë janë harmonizuar edhe dokumentet e miratuara për punë të inspektimit të mbrojtjes civile. Inspektimi i përgatitjeve për mbrojtje civile dhe sigurimin e objekteve të Kuvendit Komunal ka pasur për objektive të përcaktojë dhe definojë kornizat normative të këtyre çqeve, për periudhën e përmendur. Kështu, me qëllim që të kemi mbështetje normative, nga organi përkatës janë hartuar dhe miratuar.

-Rregullorja mbi planifikimin, organizimin dhe zbatimin e inspektimit të mbrojtjes civile dhe emergjencës në komunën e Prishtinës.

-përkujtuesi për punën e inspektorëve të mbrojtjes civile gjatë inspektimit në terren.

-Programi i planifikimit, organizimit dhe zbatimit të mbrojtjes civile në subjektet komunale për periudhën Shtator - Dhjetor 2003 i shkoqitur me bartësit e përgatitjeve, realizatorët dhe afatet. Në të janë paraparë edhe mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tijë.

-Propozimprojekti mbi organizimin e ri të sistemit të sigurimit në ndërtesat e Komunës.

-Urëdhëresa mbi angazhimin shtesë të punëtorëve të Drejtoratit për MC dhe E për nevojat e sigurimit të ndërtesave të Kuvendit Komunal.

-Njoftimin lidhur përgjegjësitë e punëtorëve të sigurisë dhe kompetencat e inspektorëve të mbrojtjes civile në lidhje me njoftimin.

Kështu janë vizituar UR "Batllava", NP "Higjieno Teknika", QUK e Kosovës, Termokosi, Biblioteka Kombëtare Universitare, RT e Kosovës, Qendra e Rinisë, Sportit dhe Kulturës, Qendra e studentëve, NH "Grandi". Gjithashtu janë vizituar edhe një numër i bashkësive lokale të qytetit dhe atyre rurale, të përcaktuara me Kornizën Prioritare. Programi në fjalë është realizuar tërësisht me përjashtim të B XII₁ në të cilën, për shkaqe të panjohura për ne, nuk kemi mundur ta zbatojmë inspektimin.

Qëllimi themelor i vizitave nëpër subjektet në fjalë ka qenë përcaktimi i nivelit të organizimit të mbrojtjes civile dhe emergjencës dhe dhënia e udhëzimeve profesionale në organizimin e mëtejshëm të mbrojtjes civile dhe emergjencës, në baza vullnetare. Me atë rast janë dhënë konstatime dhe vlerësime mbi gjendjen faktike të organizimit dhe janë hartuar procesverbalet me të cilat janë njoftuar përgjegjësit e subjekteve të vizituara.

Shtabi i mbrojtjes civile dhe emergjencës në esencë dhe në parim është kompletuar me kuadro profesionale në bazë vullnetare, edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha mbetet brengë e madhe në të ardhmen vitin 2004 hartimi i normativës ligjore mbi detyrat dhe obligimet e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës. Në fund mund të konkludojmë se në tërësi janë realizuar objektivat e parashtruara të Shtabit.

Rregullisht në nivel të Drejtoratit hartohet Raporti njëjavor i punës, me të cilin njoftohet kryeshefi ekzekutiv e, sipas nevojës edhe Bordi i drejtorëve.

Deri më datën pesë të çdo muaji, hartohet Programi mujor i punës si dhe analizat e realizimit të detyrave, hartohen planet e punës të sektorëve dhe të çdo bashkëpunëtori që mban planin ditore të punës, të cilët inkorporohen në Programin e Drejtoratit.

Pas mbledhjes së kolegjumit, praktikohet, dhe rregullisht mbahet edhe mbledhja e sektorëve ku tema e debatimit është e njëjtë, por këto çdo punëtor, veç e veç, i merr detyrat individuale.

Një kohë të gjatë, për qëllimet e Drejtoratit kemi hartuar, një Elaborat për nevojat tona dhe Brigadës së zjarrfikësve. Elaborati është bërë me propozimin tone, gjatë qëndrimit të një përfaqësuesit tonë të Shtabit Komunal të mbrojtjes civile në ministrinë e mbrojtjes civile të Suedisë. Elaborati është përkthyer dhe i është dërguar Ministrisë në fjalë. Gjithëashtu, me qëllim të bashkëpunimit, me kërkesë të Ministrisë Suedeze të Mbrojtjes Civile eprori, i këtij organi (drejtori) dhe anëtarja e Shtabit të mbrojtjes civile dhe emergjencës kanë qëndruar dy javë në Suedi, në një trajnim nga ky lëmë. Presim rezultate dhe kontakte të mëtejme të bashkëpunimit me këtë shtet përkatësisht me Ministrinë e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës.

Në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara UNDP-në, në fund të gjashtë mujorit është mbajtur një trajnim katër ditor me temën: Menaxhimi me katastrofat në Kosovë. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë aktive edhe përfaqësuesit e Drejtoratit tanë të cilët dolën me dy kumtesa me rëndësi lidhur me menaxhimin e katastrofave. Ishte kjo një temë e cila kërkon trajtim shumë serioz dhe aktivitet në kontinuitet të të gjithë bartësve në nivel lokal dhe Qendror. Me që Prishtina ballafaqohet me një mori problemesh tejet të ndieshme në shpërthimin e fatjkeqësive dhe katastrofave eventuale (zjarret e mëdha, të reshurat atmosferike, shembja e dheut, dëbora, shiu, tërmeti etj). Shtrohet domosdoja e një rishqyrtimi i sistematizimit të vendeve të punës në Drejtorat dhe plotësimi me kuadro nga kjo lëmi e cila gjithënjë e më shumë po merr kahje dhe prioritetin e organizimit nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Mendojmë se ngecja e organizimit të mirëfilltë të kësaj lëmie në nivel qendror dukshëm po reflektohet edhe në Drejtoratin tonë dhe kuptohet edhe nëpër Komunat e tjera.

Punët e mbikqyrjes dhe organizimit të sigurimit të objektit të Kuvendit Komunal bisedat dhe trajnimet me punëtorët e sigurimit kanë qenë detyra të rregullta dhe në këtë plan nuk kemi pasë probleme të shprehura që do të ndikonin në sigurin e objekteve të Kuvendit Komunal.

Mbikqyrja e strehimoreve kolektive-publike ka pasë një tretman të posaçëm. Është formuar komisioni tre anëtarësh në kuadër të Drejtoratit ka dalë në terren i ka vizituar ato dhe ka konstatuar se për momentin nuk janë të përdorshme për destinimin që e kanë. Në disa prej tyre zhvillohet biznes privat edhe përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve tona të dhëna me shkrim në Bordin e Drejtorëve. Strehimoret publike (gjashtë) sipas vlerësimit tonë mundësojnë strehimin e mbi 1600 personave.

Janë kryer edhe shumë detyra të tjera nga fushëveprimi i këtij sektori të cilat nuk do të përmendim në këtë Raport vjetor. Konstatojmë se ky Sektor ka pasë një bashkëpunim të mirë në mes bashkëpunëtorëve dhe detyrat i ka realizuar në nivelin e duhur.

SEKTORI I EMERGJENCËS

Realizimi i detyrave - aktiviteve njëvjeçare nga Sektori i emergjencës janë kryer përmes organeve të tij, siç janë: bashkëpuntori për logjistikë, koordinatori i Qendrës komunale për informim, alarmim dhe koordinim me operatorët e tij, koordinatori me KFOR-in, UNMIK-un, ShPK-ën, bashkëpuntori për zjarrfikës, kompjuteristi, inspektorët e preventivës dhe Brigada e zjarrfikësve, aktivitetet i cili është realizuar në mbështetje të Planit vjetor të punës të Drejtoratit tonë.

Mendojmë se, edhe përkundër mungesës së disa kuadrove në këtë Sektor, me sukses është duke e arsyetuar ekzistimin e vet dhe në të ardhmen do të kontribojë edhe më shumë në marrjen e masave preventive, që do të ndikojnë në zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë eventuale-katastrofat.

Sektori i emergjencës, përveç punëve të planifikuara në Sektor, është angazhuar paralelisht dhe në bashkëpunim me Sektorin e mbrotjes civile dhe drejtoratet tjera, që veprojnë në kuadër të Kuvendit Komunal për kryerjen me sukses të të gjitha aktiviteteve, paraparë me Planin vjetor të punës, si dhe punët tjera nga fushë veprimi i Sektorit, që janë paraqit për realizim gjatë këtij viti.

Gjatë vitit që shkoi një rëndësi e veçantë në Sektorin e Emergjencës i është kushtuar shpalljes së Tenderve të ndryshëm me të vetmin qëllim që të rritet gadishmëria emergjente për një veprim sa ma të sukseshëm dhe konkret.

Gjatë vitit 2003 për Drejtoratin tonë është paraparë që t'i ndahen 326.275 euro. Prej tyre janë shpenzuar 170.275, euro kurse shuma prej 156.283 euro ,që është paraparë të realizohet gjatë muajit dhjetor për shërbime kapitale (sistemi i alarmimit, blerja e tri automjeteve komanduese dhe dy automjeteve sulmuese dhe pajisja e Brigadës me MMT) është alokuar për qëllime të njejta për vitin 2004.

Gjatë vitit shuma prej 170.275 euro është shpenzuar për këto projekte:

- a) furnizimi i Qendrës komunale për informim, alarmim dhe koordinim me radio-lidhje 32.346 euro.
- b) furnizimi i Qendrës komunale për informim, alarmim dhe koordinim dhe ndërtesës së Komunës me kamera 24.000 euro.
- c) adaptimi i Qendrës komunale për informim, alarmim dhe koordinim 23.985 €
- d) riparimi i objektit të bazës së zjarrëfikësve 13.179 euro.
- e) furnizimi - pajisja e Brigadës së zjarrëfikësve me MMT dhe veshmbathja - 24.730 €
- f) blerja e një automjeti (xhip i hapur) për Brigadën e zjarrëfikësve 12.000 €.
- g) ndërtimi i punktimit të zjarrëfikësve dhe Qendrës nacionale për informim, alarmim dhe koordinim në Kodrën e Trimave, e cila ka kushtuar 107.500 €, prej tyre IOM-i i ka investuar 70.000 € kurse Kuvendi Komunal i Prishtinës ka participuar me 37.500 €.
- h) Shpenzimet materiale për inspektorët e preventivës dhe hulumtimi nga zjarret kanë shpenzuar 2.535 €.

Sektori i emergjencës, në fillim të këtij viti, ka planifikuar për realizimin e aktiviteteve të cilat dalin nga fushëveprimi i Sektorit, e njëherit ka realizuar edhe detyra të jashtëzakonshme siç janë: angazhimet konkrete në aksionet gjatë vërshimeve të cilat kanë ndodhë gjatë vitit, zjarreve, rrëshqitjes së dheut etj.

Një nga detyrat themelore të Sektorit të emergjencës gjatë këtij viti ka qenë hartimi i Planit për gatishmëri emergjente në komunë si dhe në dokumentin për vlerësimin e rrezikut, në bashkëpunim me Drejtoratet tjera në komunë si dhe me subjektet tjera që kanë të bëjnë me këtë lëmi.

Vlen të theksohet se Plani për GE si dhe Vlerësimin e rrezikut e kemi punuar në pajtim me të dhënat që i kemi marr nga subjektet përkatëse dhe mund të konstatojmë se mbi 90% vlerësimi është adekuat dhe i saktë por nuk do të thotë që dokumentet në fjalë nuk mund të azhurohen kohë pas kohe me marrjen e shënimeve nga subjektet përkatëse gjë që do të mbetet si obligim i përhershëm i këtij Sektorit në veçanti dhe i Drejtoratit në përgjithësi.

Duke parë rëndësinë e Sektorit të Emergjencës si dhe marrjen e masave adekuate - preventive për pengimin - zvogëlimin e pasojave eventuale në rast të ndonjë fatkeqësie elementare kemi qenë të organizuar në atë mënyrë që të reagojmë me kohë në bashkëpunim me subjektet tjera Komunale si dhe SHPK-në, TMK-në e subjekteve tjera që kanë të bëjnë me këtë lëmë, me qëllim të zvogëlimit - pengimit të dëmeve materiale, të cilat do të shkakttoheshin në rast të ndonjë fatkeqësi elementare apo katastrofe.

Bashkëpunimi me këto subjekte është bërë përmes kontakteve të përhershme me të cilat i kemi informuar, identifikuar, evidentuar dhe përpunuar problemet emergjente si dhe intervenuar në shumë raste me qëllim të evitimit të pasojave dhe dëmeve që do të shkakttonin, siç është shembja e dheut në disa lagje të qytetit, zjarret e shumta që kanë ndodhë në territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Kastriotit (Obiliqit) si dhe pastrimi i rrugëve nga orteqet e borës gjatë sezonit dimëror.

Sektori i ynë me qëllim të realizimit të detyrave - aktiviteteve nga fushëveprimi i vetë në bashkëpunim me Sektorin e Mbrojtjes Civile ka bërë planifikimin e detyrave për realizim gjatë javëve e muajve të vitit.

Koordinimi i punëve me TMK-në, SHPK-në, UNMIK-un e sipas nevojës me KFOR-in kanë qenë njëra nga angazhimet tona me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve për përcjelljen e gjendjes Emergjente në territorin e Komunës sonë.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në Brigadën e zjarrëfikësve e cila që nga Janari i këtij ka kaluar në kompetencat tona kemi bërë pranimin e 37 zjarrëfikësve dhe një koordinatori të cilët në bazë të Rregullorës mbi sistematizimin e vendeve të punës i kemi caktuar të punojnë në Punktin e zjarrëfikësve në Kodrën e Trimave.

Pranimi i tyre është bërë në bazë të akteve normative në fuqi.

Është përfunduar plani për furnizim i popullatës me artikuj të domosdoshëm ushqimor dhe mjete materiale teknike në rastet emergjente, si dhe janë caktuar depot për furnizim.

Gjatë sezonit të korrje shirjeve Sektori i ynë në bashkëpunim me Drejtoratin e Bujqësisë kanë bërë kontrollimin e autokombajnave dhe pjesëve rezervë të domosdoshme për punë normale dhe ka përcjell pandërprer korrje shirjet në teren.

Është bërë kontrollimi dhe mbushja në kohën e paraparë me ligj të aparateve për fikjen e zjarrit në Ndërtesën e Kuvendit Komunal dhe në objektet e tjera përcjellëse Komunale njëherit janë kontrolluar dhe riparuar hidrantët në objektet e Komunës.

Për vitin 2004 për nevojat e Drejtoratit me mjete materilo-teknike janë propozuar projekte konkrete, si dhe për afërsisht, mjetet financiare të domosdoshme për realizimin e projekteve, të cilat janë më se të domosdoshme, në mënyrë që të ndërmerren masat preventive për zvogëlimin dhe pengimin e dëmeve të cilat do të shkaktoheshin në rast të ndonjë fatkeqësie elementare - katastrofe natyrore. Vlen të theksohet se gjatë tërë vitit ka funksionuar Qendra për informim - alarmim dhe koordinim, duke punuar 24 orë pandërprerë, e cila ka kontribuar mjaft në informimin me kohë të subjekteve përgjegjëse për reagim emergjent, në rastet kur shfaqen zjarre, ndodhin vërshime, shembje të dheut si dhe dhënien e ndihmës së parë pacientëve të sëmurë në zonat rurale, ngase, në pjesën dërmuese të BL kemi kontakte të drejtpërdrejta përmes radiolidhjeve.

Në bazë të Ligjit mbi mbrojtjen kundër zjarrit, një angazhim të posaçëm, gjatë vitit 2003, e kanë bërë inspektorët e preventivës dhe hulumtimit të zjarrit. Tre inspektor aktivitetet, punët dhe detyrat i kanë realizuar në bazë të Programit të punës për vitin 2003.

Përpos në komunën e Prishtinës inspektorët e preventivës janë angazhuar edhe në komunën e Fushë Kosovës dhe të Kastriotit. Punën dhe aktivitetin e vet, inspekcioni në fjalë e ka kryer duke bërë kontrollimin e subjekteve juridike, hulumtimin e zjarreve, dërgimin e procesverbaleve me propozim të masave dhe afateve të dhëna, Nëpërmjet marrjes (dërgimit) së aktvendimeve me urdhëresa e afate për eliminimin e të metave të konstatuara gjatë kontrollit të rregullt.

Përqëndrimi kryesor i punës së inspektorëve ka qenë i bazuar dhe i motivuar nga shkalla e rrezikshmërisë së zjarrit në objektet e ndryshme dhe për aktivitetet e tyre rregullisht e kanë njoftuar Drejtoratin e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencës. Për punën e tyre të realizuar, përveç Drejtoratit tone, rregullisht e kanë njoftuar dhe Departamentin e Menaxhimit Emergjent të Ministrisë së Shërbimeve Publike - Sektorin e preventivës dhe hulumtimit të zjarrit, që më parë edhe ishin punëtorë të tyre.

Inspektorët e preventivës dhe hulumtimit të zjarrit, gjatë periudhës janar - dhjetor 2003 kanë realizuar detyrat, si në vijim:

a) inspektime të rregullta (procesverbaleve) 99 subjekteve juridike, me

-nr. të objekteve	164 objekte
-kategoria I	66 objekte
-kategoria II	77 objekte
-kategoria III	21 objekte
-numri i masave me afate	755

b) Numri i aktvendimeve të pruara dhe të dërguara 152 subjekteve	
-nr. i objekteve	164
-kategorisë së I	66
-kategoria e II	77
-kategoria e III	21
-numër të masave për mënjanimin e të metave	841 urdhëresa

Për realizimin e këtyre aktiviteteve, ky inspektion ka hargjuar 2535 €, duke mos i llogarit shpenzimet e telefonit dhe servisimit të automjeteve, të cilat i ka mbuluar niveli Qendror.

Gjatë këtij viti, Drejtoratit tanë, në bazë të Vendimit të organeve kompetente, i është bashkëngjitur Brigada e zjarrëfikësve me seli në Prishtinë si dhe njësisia e zjarrëfikësve e Llapna sellës, ku nga ne është kërkuar një angazhim i posaçëm.

Shkurtimisht, Brigada e zjarrëfikësve këtë vit është përtrinë me 37 zjarrëfikës të rinj dhe një udhëheqës, që dukshëm kanë ndikuar në efikasitetin e punës së suksesshme. Janë pajisur me rroba adekuate për punë dhe janë organizuar trajnime të ndryshme profesionale. Vlen të cekët ai që është organizuar në Vushtrri, me kohëzgjatje dyjavore, me zjarrëfikësit e rinj.

Sipas vlerësimit të udhëheqësve të Brigadës së zjarrëfikësve dhe vlerësimit tone, zjarrëfikësit janë të aftë dhe të përgatitur që me sukses t'i kryejnë detyrat e tyre në çdo rast dhe në çdo moment, por duhet potencuar se mjetet motorike dhe ato teknike janë të stërvjetëruara dhe kërkojmë medeomos që të zëvendësohen me mjete të reja dhe bashkëkohore, në mënyrë që efikasiteti të jetë më i madh dhe konform standardeve bashkëkohore.

Shpresojmë se me hapjen e Punktit të zjarrëfikësve në Kodrën e Trimave, që është i gatshëm për punë, dukshëm do të përmirësohet efikasiteti në punë, e sidomos me përkrahjen nga Kuvendi i Komunës materiale dhe profesionale.

Gjatë vitit kalendarik 2003, Brigada e zjarrëfikësve ka intervenuar gjithësej 735 herë, në territorin e komunës së Prishtinës 384 herë, në komunën e Kastriotit 42 herë, atë të Fushë Kosovës 63 herë, të Drenasit 24 herë dhe në komunat e tjera, si ndihmë 22 herë. Këtë vit intervenimet kanë qenë më të shumta, për dëmet materiale ishin dukshëm më të vogla.

Në fund, mund të konkludojmë se, për një punë më të suksesshme, kjo Brigadë duhet të plotësohet me MMT, dhe rregullisht të organizojë trajnime të ndryshme profesionale, që intervenimi i tyre të jetë sa më efikas në raste emergjente. Në bazë të raporteve që disponojmë dhe kontakteve - kontrollave të shumta, mendojmë se angazhimi i tyre nuk ka munguar, por ka qenë i nivelit të dëshiruar.

Sektori, në vazhdimësi ka analizuar punën e vet dhe ka marrë masa për evitimin e dobësive eventuale.

Me kohë kemi bërë planifikimin e detyrave për realizim, gjatë vitit 2004.

Në fund mund të konkludojmë se ky Drejtorat i ka realizuar me sukses të plotë detyrat dhe objektivat e programuara gjatë vitit 2003.

DREJTORATI PËR ZHVILLIM RURAL

Drejtorati për Zhvillimit Rural ka realizuar këto objektiva: përcjellja dhe mbikëqyrja e punëve të realizuara dhe atyre në realizim e sipër, prezentim[dhe referimi në mbledhje të komitetit dhe të B.L.-ve, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave nga zonat rurale; pjesëmarrje dhe vlerësim në projektin e perimtarisë , këshillime fushore dhe teorike, takime të rregullta me shoqata bujqësore, që veprojnë në territorin e Prishtinës, takime të rregullta me kooperativat bujqësore dhe stacionet e veterinerës, përcjellja e punëve për projektin emergjent të farës së misrit dhe të plehrave, përcjellja e fushave eksperimentale me grurë dhe misër.

SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL

	Komuna	Donatori
I. Projektet e kontraktuara nga viti paraprak, të punuara në vitin 2003 kryera në vitin e kaluar		
-rruga Koliq- Podaj	58 200 €	170 240 KFOR-i
-rruga Dheu i Kuq-Murrizaj (Gllogovicë)-Krilevë	111 600 €	
-rruga Fanaj- Hajkobillë	35.000 €	52.520 € CDF-i
II. Punët e realizuara në periudhën janar-dhjetor		
-rruga Besi-Prugovc-Barilevë	10 000 €	75 000 € UFORK-u
-meremetimi i rrugës në Shkabaj		
-Meremetimi i rrugës Lagjja e Rexhajve	34 484 €	
1. Mirëmbajtja e rrugëve rurale - Pozicioni I		
-Thanishtë-Vidime-Bullaj		
-Hajvali-Veternik		
-Kishnicë-Shashkovc	34 040 €	
-Llajshevc-Thanishtë		
2. Mirëmbajtja e rrugëve rurale - Pozicioni II		
-Nishevc-Keqekollë		
-Grashticë-Mramor		
-Llukar-Siqevë-Bërnice	49 575 €	
-Keqekollë-Ballaban		
-Koliq-Stallovë		
IV. Asfaltimi i rrugëve:		
-Rruga Suteskë-Mramor		151 665 + 25 000 €
V. Hapja e kanalit anësor përgjat rrugës Besi-Rimanishtë		13 042 €
VI. Kanalizimi në fshatin Rrezanë		39 319 €
VII. Meremetimi i rrugës Lagja e Llumnicëve		20 000 €

VIII. Rregullimi i trotuarit në fshatin Llukar (TMK- Varrezat e Dëshmorëve)
75 312 €

IX. Në procedurë janë:

- renovimi i rrugës Vidime - Mudri Potok 160 000 €
- asfaltimi i rrugës Suteskë-Mramor 65 000 €
- meremetimi i rrugës Ballaban-Orllan 23 700 € KFOR-i Suedez dhe Çek

Gjithsej :701 137 € + 332 932 €

Projektet e realizuara në Sektorin e bujqësisë:

- fushat eksperimentale në perimtari 18 359,29 €,
- këshillime profesionale dhe fushore 1 180,00 €,
- projekti emergjent social - serrat dhe trajnimet (Donator CDF-ja, implementues shoqata "Biofruti") 14 230,00 €,
- ndihma emergjente për farëra të misrit dhe plehra 4 320,00 €,
- projekti emergjent për farëra të grurit dhe plehra minerale 14 260,00 €,
- meremetimi i Stacionit të veterinarit në qendër 24 963,00 €,

Gjithsej:63 082,29 € nga K.K. + 14 230,00 € nga CDF-ja

Total: 77 312,29 €

Sektorin e bujqësisë, përpos këtyre projekteve, sipas planprogramit të vet ka përfunduar edhe këto punë:

- realizimi i planprogramit për mbjelljet pranverore në vitin 2003,
- raporti për korrje-shirjet në vitin 2003,
- raporti përfundimtar për dëmet e shkaktuara nga breshri,
- planprogrami i mbjelljeve vjeshtore në vitin 2003,
- raporti përfundimtar për mbjelljet vjeshtore në vitin 2003,
- rrjedhat e punës në parkun regjional " Gërmia",
- trajnimet në bletari,
- trajnimet në dhenari,
- trajnimet në perimtari,

Sektori i bujqësisë në vitin 2003 ka marrë pjesë në të gjitha takimet me kryetarët e B.L, të organizuara në nivel komunal dhe janë informuar me punën e S. të bujqësisë. Kemi organizuar 33 vizita në B.L, 12 vizita në fshatra, 7 vizita në lagje të fshatrave. Gjatë këtyre vizitave kemi mbajtur këshillime profesionale në lëmin e mbrojtjes së bimëve, ujitjen e bimëve, si dhe në lëmin e blegtorisë: përcjellja e vaksinimit, regjistrimi i shtallave në bashkëpunim me stacionin dhe punktet e veterinars.

Sektori i bujqësisë, në vitin 2003, ka pasur një bashkëpunim të mirë me KZHR-ën, kooperativat bujqësore, sektorët e bujqësisë në nivele komunale si dhe në nivelin qendror.

Sektori i bujqësisë, ka organizuar takime të rregullta edhe me këto shoqata bujqësore:

- Shoqata e perimtarëve - Besi,
- Shoqata e blegtorëve - Marevc,
- Shoqata e blegtorëve - Keqekollë,
- Shoqata e bletarëve - Hajvali,
- Shoqata e bletarëve - Dabishevc,
- Shoqata e grave për agrobiznes - Keqekollë,
- Shoqata e grave për agrobiznes - Dabishevc.

Të gjitha këto shoqata janë të regjistruara në Zyrën ligjore të UNMIK-ut dhe janë të pajisura me certifikatën e regjistrimit, statutin, si dhe kanë anëtarësim të gjerë të bujqëve. Këto shoqata kanë fituar donacione në lëmin e bujqësisë nga organizatat e ndryshme: CDF-ja, IRC-ja, KWI-ja etj.

Gjendja e bujqësisë në zonat rurale të K.Komunal të Prishtinës është ekstenzive, për shkak të humbjeve të mëdha që u bënë gjatë luftës, në të gjithë lëmenjt e bujqësisë, si dhe për shkak të migrimit të popullatës fshat - qytet.Pa një investim nga niveli qendror dhe K.K.i Prishtinës, gjendja do të vie duke u vështirësuar, gjegjësisht, do të kemi rënie të prodhimtarisë bimore dhe shtazore, që si pasojë do të vazhdojë migrimi.

Qëllimi i investimeve në bujqësi duhet të orientohet në rritjen dhe ruajtjen e prodhimtarisë bimore dhe shtazore, zvogëlimin e migrimit të popullatës dhe rikthimin në zonat rurale.

Ndryshimi i politikave fiskale do të ndikojë pozitivisht në rritjen e prodhimtarisë bimore dhe shtazore.

Drejtorati për Zhvillim Rural në periudhën janar-dhjetor ka realizuar projektet në vlerë prej:

Sektori i zhv.rural	701 137 € nga KK
Sektori bujqësisë	63 082,29 € nga KK
	Gjithsej:764 219,29 €

Sektori i zhv.rural	332 932 € nga donatorët
Sektori i bujqësisë	14 230 € nga donatorët
	Gjithsej: 347 162 €

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE NDËRTIMTARI

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, punët dhe detyrat e punës, nga përgjegjësia e vet e caktuar me Statut dhe Rregullorën për organizimin e brendëshëm të organeve të Komunës, i ka kryer përmes njësisë organizative-Sektorit të planifikimit, Sektorit për urbanizëm dhe Sektorit të ndërtimit dhe rindërtimit.

Fushëveprimtaria dhe punët e këtij Drejtorati janë bazuar kryesisht në zbatimin e rregullativës ligjore nga lëmi i planifikimit dhe rregullimit të hapësirës, nga lëmi i ndërtimit të objekteve investive, si dhe rregullativës dhe vendimeve të tjera të nxjerra nga Kuvendi komunal në bazë të ligjeve aplikative dhe rregulloreve tjera të UNMIK-ut.

II. PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Gjatë periudhës raportuese, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës punët dhe detyrat, nga përgjegjësjia e caktuar në aspektin e planifikimit, i ka përqëndruar si më poshtë:

1. Në Pilotprojektin për rregullimin e rrugës "Nëna Terezë",

-Iniciativa për një Pilotprojekt të këtillë erdhi në janar të vitit 2003, në mes të përfaqësuesëve të UNDP-së, Kuvendit Komunal të Prishtinës, Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Fak. të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës dhe UN-HABITAT-it, ndërsa memorandum, gjegjësisht marrëveshja u nënshkrua në prill të këtij viti.

Më par u organizua një vizitë pune në Shqipëri dhe Maqedoni, ku për së afërmi u shkëmbuen mendime dhe përvoja për projekte të ngjajshme, të realizuara në këto dy vende.

Grupet punuese, të formuara nga planerë të këtij Drejtorati dhe studentë të Fak. të Arkitekturës punuan në grumbullimin dhe përpunimin e informative të marrura nga pyetësorët e zhvilluar me banorët, afaristët, institucionet dhe pjesëmarrësit tjerë të kësaj hapësire.

Sipas metodologjisë së Habitat-it për këtë detyrë janë kryer:

analiza e pjesëmarrësve, listat gjithpërfshirëse, vlerësimi dhe ndikimi i tyre,

profili i situatës urbane - analiza në fusha tematike urbane,

vlerësimi i situatës urbane përmes SWOT analizës, gjegjësisht analizat e zotimeve, përparësive, mangësive dhe kërcënimeve,

diagnoza e konsoliduar urbane, nga e cila kanë dalë çështjet për konsultime urbane,

konsultimet urbane, të mbajtura për herë të parë në këtë formë, nga të cilat janë nxjerrë vizioni dhe prioritetet,

Në bazë të prioritetëve janë formuar grupet punuese, me pjesëmarrës të një spektri të gjerë me ekspertë të profileve përkatëse, të cilët kanë sjellë planet e veprimit për secilin prioritet,

-Planerët e këtij Drejtorati dhe disa studentë në qershor të këtij viti, kanë përgaditur vorkshop - punëtorin dhe kanë organizuar ekspozitën me rezultatet e arritura.

-Më pas, përfaqësues të UNDP-së dhe Drejtoratit për Planifikim kanë përgaditur dokumentacionin teknik dhe materialin e nevojshëm për tenderim, procedurë e cila është në vazhdim e sipër, e pas kësaj faza e implementimit.

Plani Strategjik Zhvillimor Urban i Prishtinës,

Punët dhe detyrat programore dhe dokumentacioni tjetër teknik, i filluar në gjysmën e parë të vitit raportues, në bazë të vendimeve të Kuvendit Komunal për revidimin e Planit të Përgjithëshëm Urbanistik ekzistues dhe hartimit të ri të këtijë Plani, ky Drejtorat, me qëllim të harmonizimit dhe zbatimit të Ligjit mbi planifikimin hapësinor, nr. 2003/30, ka vazhduar në hartimin e Projektplanit zhvillimor urban. Në kuadër të përgatitjeve për hartimin e PSZHU është arritur marrëveshja e bashkëpunimit të Komunës së Prishtinës me komunat tjera fqinje: Kastriot (ish Obiliq), F.Kosovë, Lypjan, me qëllim të arritjes së bashkëpunimit në sferat, të cilat janë me interes për Komunën e Prishtinës dhe për komunat nënshkruese, lidhur me Planin e ardhëshëm zhvillimor urban të Prishtinës.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe raportuese, e me qëllim të hartimit të këtij Projektplani janë kryer edhe këto punë:

-është nënshkruar marrëveshja për mbështetje profesionale, në bazë të tenderit, me tri institute gjermane dhe një vendor:

- IWU - Instituti për Banim dhe Mjedis,
- FWH - Instituti për Punë Shkencore dhe Zhvillimore - Hessen,
- Grupi Planifikues 4,
- INTECH - Instituti Teknologjik.

Kjo marrëveshje u nënshkrua më 15 nëntor 2003 në mes Komunës së Prishtinës dhe udhëheqsit të projektit dr. Rainer Greiff.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në mbledhjen e shënimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për nevoja të hartimit të këtij Plani, siç janë:

- bartja e shënimeve nga operati kadastral në bazat gjeodezike, duke i klasifikuar pronat sipas karakterit të objekteve,
- skenimi i planeve detale ekzistuese dhe përpunimi i planeve urbanistike të fshatrave,
- skenimi i hartave topografike të Komunës së Prishtinës, dhe vektorizimi i tyre.

Në fazën përgatitore janë zhvilluar takime pune me drejtorët dhe përfaqësuesit e drejtorateve përbrenda Komunës, si me Drejtoratin për Ekonomi, Drejtorin për Shërbime Publike, Drejtoratin për Shëndetësi, Drejtoratin për Arsim, Drejtoratin për Zhvillim Rural dhe drejtorate të tjera, me qëllim të kyçjes së tyre në hartimin e këtij Plani.

-Gjithashtu, janë zhvilluar takime pune dhe janë mbledhë informata të nevojshme edhe me Entin e Statistikës të Kosovës, si dhe me Ndërmarrjen Publike të Banesave.

Në mbështetje të hartimit të këtij Plani, prej datës 11.12.2003 deri më 17.12.2003 kanë prezentuar edhe përfaqësuesit e instituteve gjermane, me të cilët është punuar së bashku me Sektorin e planifikimit, ku janë shkëmbyer informata dhe mendime, janë organizuar takime me përfaqësues të drejtorateve përbrenda Komunës, me ndërmarrje publike "Higjienoteknika", "Termokosi" si dhe me institucione të ndryshme si: Institutin për Mbrojtje të Monumenteve të Kosovës, Ndërmarrjen regjionale të ujësjellsit dhe kanalizimit "Batllava", e takime të tjera.

Gjithashtu janë organizuar vizita në pjesë të qytetit, për t'u njoftuar për së afërmi me hapësirat e qytetit.

Përgatitja e materialeve-vendimeve mbi qasjen e hartimeve të planeve rregullative,

Vendim mbi qasjen e hartimit të planit rregullativ të kompleksit të qendrës në lagjen "**Kodra e Trimave**" në Prishtinë. Në kuadër të këtij kompleksi, do të përfshihen këto përmbajtje: shkolla fillore, çerdhja e fëmijëve, qendra e mjekësisë familjare, shërbimet postare, bankare, shërbimet e bashkësisë lokale, terene sportive, amfiteatër etj.

Vendim mbi qasjen e hartimit të planit rregullativ të kompleksit të qendrës "**Fusha e Pajtimit**" në lagjen "Gallapi" në Prishtinë me përmbajtje si: qendra me objekte për administratë, bibliotekë, salla për aktivitete të ndryshme, salla sportive me terrene të hapura, objekte të banimit të përkohshëm social, çerdhe, qendra e mjekësisë familjare, shërbime bankare, postare, institucione arsimore (shkollë fillore dhe të mesme), objekti fetar xhamia, sipërfaqe për parking, rregullimi i shtratit të lumit etj.

Është filluar me përgatitjen e materialit dhe analizave të para për qasjen e hartimit të planit rregullativ të hapësirës së lagjes "**Tophane**",

Është punuar në mbledhjen e materialit për publikimin e konkursit për planin rregullativ të lagjes "**Dodona**",

- Është bërë ndryshimi dhe plotësimi i planit detal urbanistik të qendrës universitare për ndërtimin e objektit të Institutit të Historisë dhe ai

- I planit detal urbanistik të Fakultetit Teknik për ndërtimin-vendosjen e objektit të nënstacionit shkëmbyes të ngrohjes qendrore të qytetit,

Janë në vazhdim bisedat dhe kontaktet me banorët e lagjes "**Aktashi II**", që përmes pyetësorëve të deklarohen për vizionin e ardhshëm të kësaj hapësire,

Janë bërë biseda me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe vendore rreth formimit të standardizimit të rrethojave të objekteve të kësaj natyre,

-Është filluar me shqyrtimin e mundësive të shëndërrimit të hapësirave përdhese në lokalet afariste.

Përgatitja e dokumentacionit dhe materialeve për hapjen e tenderëve

-Publikimi i tenderit për zgjidhjen ideore urbo-arkitektonike për objektet e banimit në lagjen "Kodra e Diellit". Komisioni profesional është duke punuar në vlerësimin e punimeve të ofertuara.

-përgatitja e materialit dhe publikimi i tenderit për projektin ideor të **shkollave fillore**:

-në fshatin Hajkobillë,

-në lagjen Mat, në Prishtinë

III. VEPRIMET PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR NDËRTIMET E OBJEKTEVE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM SHOQËROR

Këtij Drejtorati gjatë periudhës raportuese i kanë arritur një numër i konsiderueshëm i kërkesave nga personat juridikë për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve të interesit të përgjithshëm shoqëror.

Këto hapësira, sipas procedurës dhe varësisht nga arsyeshmëria e tyre, i janë prezentuar Bordit të drejtorëve me propozimet konkrete të këtij Drejtorati, kështu që për të gjitha kërkesat e trajtuara si të arsyeshme nga kryeshefi ekzekutiv dhe Bordi i drejtorëve, janë përgatitur propozimvendimet dhe bashkë me situacionin e gjerë dhe atë të ngushtë të lokacionit të propozuar u janë prezentuar trupave të Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim, pasi që të gjitha lokacionet e caktuara kanë qenë në pronësinë e Komunës, andaj me të njëjtat vendime është dhënë në shfrytëzim edhe toka.

Gjatë periudhës raportuese, ky Drejtorat ka përgatitur këto propozimvendime me arsyetimet përkatëse për caktimin e lokacioneve dhe dhënien e tokës në shfrytëzim:

- caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë. Në kuadër të këtij kompleksi do të inkorporohet edhe ndërtimi i objektit shkollor-qendrës rajonale për aftësim profesional.

- caktimi i lokacionit për ndërtimin e objekteve:

- të Ministrisë së Arsimit dhe të

- Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

- caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës në lokacionin e objektit ekzistues të shkollës "Xhevdet Doda" në Prishtinë,

- caktimi i lokacionit për ndërtimin e Qendrës kardiokirurgjike në Prishtinë, gjegjësisht në lokacionin përbri kufirit në anën jugore të Qendrës Klinike Univerzitare në Prishtinë,

- caktimi i lokacionit në kompleksin e QKU-së për ndërtimin-vendosjen e Qendrës referuese emergjente të Batalionit 40 të Mjekësisë të TMK-së në Prishtinë,

- caktimi i lokacionit dhe dhënia e tokës në shfrytëzim të përkohshëm PTK-së për vendosjen e objektit - kontejnerit me karakter të përkohshëm në fshatin Mat në Prishtinë,

- caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit-Qendrës memoriale të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

-caktimi i lokacionit për ndërtimin e lapidarit të Sokol Sopit në Prishtinë,

-caktimi për ndërtimin-vendosjen e pllakës përkujtimore të dëshmorëve të kombit në lokacionin afër varrezave në Prishtinë,

-caktimi i lokacionit për Tregun e gjelbër me shumicë, në komunën kadastrale Bërrnicë e Ulët në Prishtinë,

- zgjerimi i kompleksit të qerdhës së fëmijëve "Gëzimi Ynë" në lagjen "Ulpiana",
- caktimi i lokacionit në Graçanicë për ndërtimin e objektit "Shtëpia për fëmijët e braktisur",
- Është përgatitur caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit fetar-xhamisë në fshatin Bardhosh, i cili pritet të miratohet në seancën e ardhme të Kuvendit.

IV. ZGJIDHJA E KËRKESAVE TË PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË

Gjatë periudhës raportuese, këtij Drejtorati i kanë arritur 1267 kërkesa ndërsa të bartura nga viti paraprak kanë qenë 237 kërkesa, nga rezulton se gjatë këtij viti raportues kanë qenë për punë 1504 kërkesa, zgjidhja e të cilave bie në përgjegjësinë e këtij Drejtorati. Kërkesat kanë qenë persona fizikë dhe juridikë.

Përmbajtja e kërkesave ka qenë kryesisht: caktimi i lokacioneve, caktimi i kushteve urbanistiko-teknike, leje ndërtimore, vendosje e objekteve të përkohshme, informacione për destinimet e sipërfaqeve në planet përkatëse urbanistike, caktimi i dispozitave sipas planeve detale, për rrënimin e objekteve ekzistuese, lëshimin e vërtetimeve për dëme të shkaktuara nga lufta, ndërrimin e destinimit të përdorimit të objekteve ekzistuese, legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe kërkesa për informacione të tjera mbi kushtet për rregullimin e hapësirës, si dhe kërkesa kundërshtime me përmbajtje të ngjashme.

Vendosja e kërkesave në shumicën e rasteve është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtar ndërsa, për një pjesë të tyre nuk ka qenë e nevojshme të nxirret konkluzion përfundimtar, por të njëjtat janë vendosur në bazë të informacioneve, përgjegjëse dhe lëshimit të vërtetimeve dhe provave tjera të kërkuara.

Gjendja e kërkesave të arritura, mënyra e zgjidhjes së tyre dhe të atyre në procedure, në mënyrë tabelare duket si më poshtë:

1	2	3	4	5	6
Të arritura gjatë periudhës raportuese	Të bartura nga periudha paraprake (2002)	Gjithsej për punë gjatë vitit raportues	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë
1267	273	1504	741	651	112

Mënyra e vendosjes sipas kërkesave

Zgjidhja e kërkesave është bërë në bazë të konkluzioneve përfundimtare-aktvendimeve, konkluzave, përgjigjeve dhe vërtetimeve, si dhe në bazë të përgatitjes së propozim vendimeve për Kuvendin Komunal.

Vendosja sipas kërkesave për caktimin e kushteve urbanistike-teknike dhe lejimi i ndërtimeve, është bërë kryesisht në formë të rikonstruimit të objekteve ekzistuese me zgjerime minimale, nga shkak se në shumicën e rasteve hapësirat ku është kërkuar lejimi i ndërtimit, në bazë të planit të përgjithshëm urbanistik, kanë pasur destinim të banimit, por, për këto hapësira kanë munguar planet e hollësishme urbanistike.

Po ashtu, lejimi i ndërrimit të destinimit të sipërfaqëve është bërë vetëm në rastet kur ky ndërrim ka mundur të bëhet pa ndërhyrje nga aspekti i konstruksionit-stabilitetit të objektit dhe pamjes vizuele të objekteve.

Arsyet kryesore për refuzimin e kërkesave

Gjatë shqyrtimit të kërkesave, arsye kryesore për nxjerrjen e konkluzionit për refuzimin e tyre ka qenë:

- ç'ështëja pronësore-juridike e pazgjidhur në tokën apo hapësirën ku është kërkuar lejimi i ndërtimit,
- sipërfaqet në të cilat është kërkuar lejimi i ndërtimit, sipas PPU dhe PDU, kanë pasur destinim tjetër nga ai i kërkuari,
- kërkesat për lejimin e ndërtimeve jashtë kufijëve të fshatrave, përkatësisht në tokën bujqësore ose në afërsi të rrugëve magjistrale, hekurudhore dhe rrugëve të tjera,
- kërkesat për lejimin e ndërrimit të destinimit të hapësirave në objektet banesore (kolektive), për të cilat nuk është argumentuar e drejta pronësore e kërkesave në ato hapësira, si dhe ato të cilave nuk ka mundur t'u ndërrohet destinimi pa ndërhyrje me punë ndërtimore dhe pamundësi të shfrytëzimit të qasjeve ekzistuese,
- kërkesa për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike, pa provën mbi të drejtën e shfrytëzimit të asaj sipërfaqeje.

-Me miratimin e Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor 2003/30 të datës 10.09.2003, mundësia e ndërrimit të destinimit të përdorimit është kufizuar me nxjerrjen paraprake të planeve përkatëse urbanistike për komplekset përkatëse të zonave urbane, kështu që pas kësaj date të gjitha kërkesat për ndërrimin e destinimit të përdorimit janë refuzuar me arsyetimin e përmendur.

Dukuri tjetër, e shpeshtë, e cila ka ndikuar në marrjen e konkluzionit për refuzimin e kërkesave ka qenë se, kërkesat për caktimin e kushteve urbanistike-teknike dhe për lejimin e ndërtimit janë paraqitur pas përfundimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore me qëllim ndërtimi, ndërrimit të destinimit apo pas kryerjes së punëve të konsiderueshme, gjë që është konstatuar gjatë shqyrtimit të kërkesave, e në procedurën e daljes në vendshiqim, kështu që ky Drejtorat, konform me rregullativën ligjore në fuqi, këto kërkesa i ka refuzuar me arsyetim se, janë zhvilluar punimet ndërtimore, pa u caktuar kushtet urbanistike-teknike dhe pa u lejuar ndërtimi.

Kundërshtimet dhe vendosja sipas tyre

Në numrin e lëndëve të paraqitura për punë, dhe në ato të zgjidhura, 102 prej tyre janë kundërshtime ndaj akteve mbi refuzimin e caktimit të kushteve urbanistike-teknike dhe në atë për caktimin e kushteve për hartimin e dokumentacionit teknik.

Në aktet për caktimin e kushteve urbanistike-teknike, kryesisht atakohet gabariti i objektit, përkatësisht duke kërkuar shfrytëzimin e tërë sipërfaqës së truallit, pra, në kundërshtim me një ndër kriteret themelore urbanistike të ndërtimit.

Pasi që, konform me rregullativën ligjore në fuqi, ky Drejtorat vet ka vendosur sipas këtyre kundërshtimeve, duke rishqyrtuar sërish lëndën, planet urbanistike dhe destinimet e tyre, si dhe kriteret tjera urbanistike, të caktuara me vendimet komunale, të cilat zëvendësojnë planet, kështu që, nga i gjithë numri i kundërshtimeve të vendosura, vetë 2 prej tyre janë miratuar, ndërsa 76 me aktvendime të veçanta janë refuzuar, me udhëzim juridik për të drejtën e ankesës, konform nenit 35 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45.

Me miratimin e Ligjit mbi planifikimin hapësinor, kompetenca e këtij organi për rishqyrtimin e kësaj kategori të aktvendimeve nuk është paraparë kështu që, tani udhëzimi juridik për të drejtën e kundërshtimit nuk jepet as në aktet mbi caktimin e kushteve urbanistike-teknike.

Kërkesat e aprovuara dhe ato në procedurë

Në numrin e kërkesave, të paraqitura si të aprovuara, është paraqitur numri i akteve mbi caktimin e kushteve urbanistike-teknike, lejet ndërtimore, konkluzionet me të cilat është lejuar zhvillimi i punimeve ndërtimore, të cilat nuk kanë ndryshuar projektin e objektit ekzistues, përkatësisht punët, të cilat, komform me rregullativën ligjore, nuk janë trajtuar

si ndërtim dhe as si rikonstruim, si dhe konkluzionet tjera me të cilat është zgjidhur çështja pa qenë e domosdoshme të nxirret vendim i veçantë, e të cilat janë zgjidhur në favor të kërkuësve. Propozimvendimet e miratuara nga Kuvendi për caktimin e lokacionit, lëshimi i vërtetimeve mbi shkallën e dëmtimit nga pasojat e luftës, si dhe kërkesat tjera, të ngjashme, në favor të palëve.

Në numrin e lëndëve të paraqitura në procedurë, pos lëndëve, për të cilat është kërkuar plotësimi i tyre, janë edhe ato të cilat kanë arritur në gjysmën e dytë të muajit dhjetor të vitit raportues.

Veprimet sipas kërkesave për legalizimin e ndërtimeve pa leje-arbitrare

Kjo kategori e kërkesave janë shqyrtuar duke kryer veprime nga përgjegjësia e këtij Drejtorati (përpos kërkesave për legalizimin e mbindërtimeve dhe shndrrimeve në objekte kolektive), përkatësisht janë kompletuar lëndët dhe është konstatuar gjendja faktike në terren si dhe është kërkuar nga kërkuësit që kjo gjendje-vija rregullative dhe ajo ndërtimore, të caktohen nga Drejtorati i Kadastrit dhe në shumicën e rasteve këto kërkesa janë plotësuar edhe me këto të dhëna.

Mirëpo, përgjegjësia e këtij Drejtorati për nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare ishte e kufizuar, sepse, me rregullativën ligjore në fuqi (Vendimi mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje Nr. 01-351-711 dt. 16.05.2001 Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve nr. 01-010-3 dt. 03.01.2002 si dhe Udhëzimi mbi rregullat lidhur me lejet ndërtimore për ndërtimin e ndërtesave dhe objekteve në komunën e Prishtinës nr.2000/7), përgjegjësia për vendosje sipas këtyre kërkesave i është dhënë një organi kolegjial, e që ky organ asnjëherë nuk ka vepruar për zgjidhjen e këtyre kërkesave.

Pasi është duke u punuar në hartimin e Planit Zhvillimor urban të Prishtinës, është pushuar procedura për vendosje sipas këtyre kërkesave e që për një veprim të këtillë të gjithë kërkuësit janë informuar për pushimin e procedurës për vendosje sipas tyre deri në miratimin e këtij plani, ndërsa siç u tha më lartë, kërkesat për legalizimin e ndërrimit të destinimit të përdorimit janë refuzuar me aktvendim në mungesë të planit urbanistik për ndërrim të destinimit në kompleksin më të gjerë ku ndodhet objekti.

Vendosja sipas kërkesave për pranim teknik të objekteve dhe lejimi i tyre për përdorim dhe shfrytëzim

Pasi që konform me rregullativën ligjore në fuqi, pas përfundimit të ndërtimit, investitori është i obliguar që të pajiset me leje përdorimi dhe shfrytëzimi, e cila leje mund të lëshohet vetëm pas kontrollimit teknik nga Komisioni profesional i formuar nga organi që ka lëshuar lejen për ndërtim, këtij Drejtorati gjatë kësaj periudhe i janë paraqitur 5 kërkesa për caktimin e Komisionit profesional për kontrollim teknik të objekteve të përfunduara s`ndërtuari dhe 4 kërkesa për leje përdorimi dhe shfrytëzimi.

Ky Drejtorat duke shqyrtuar këto kërkesa ka caktuar Komisionin përkatës për 5 raste, ndërsa sipas kërkesave për leje përdorimi dhe shfrytëzimi është lëshuar vetëm 1 leje e këtillë.

Dhënija e informacioneve dhe vlerësimi i dëmeve nga pasojat e luftës të objekteve të dëmtuara nga lufta

Gjatë vitit raportues, ky Drejtorat i ka caktuar komisionet përkatëse për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet nga pasojat e luftës për 5 raste, sipas kërkesave të palëve. Pasi i tërë dokumentacioni mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara udhëhiqet në këtë

Drejtorat, gjatë këtij viti janë dhënë shumë informacione dhe shënime sipas kërkesave të bashkësive locale, si dhe organizatave të tjera joqeveritare ndërkombëtare dhe organizatave të tjera.

Po ashtu, gjatë vitit raportues janë lëshuar 299 vërtetime mbi shkallën e dëmtimit të pësuar nga lufta sipas kërkesave të personave civilë dhe juridikë.

Punët tjera nga përgjegjësia e Drejtoratit

Gjatë vitit raportues nga ky Drejtorat është kërkuar që të bëhen vlerësimet profesionale mbi paramasat dhe paralogaritë për shpalljen e tenderëve për ndërtimin dhe rikonstruimin e objekteve, për të cilat Komuna ka qenë investitor përkatësisht për objektet me të cilat qeverisë Komuna.

Po ashtu, për këtë kategori të objekteve është kërkuar nga ky Drejtorat që të caktojë persona profesionale për mbikëqyrjen e zhvillimit të punimeve ndërtimore si dhe caktimin e komisionit profesional për kontrollimin teknik të këtyre objekteve pas përfundimit të ndërtimit, përkatësisht rikonstruimit, si dhe analiza tjera për investime.

Paramasat e paralogaritë dhe dokumentacioni tjetër teknik

Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur paramasa dhe paralogari me dokumentacion tjetër teknik, për ndërtimin dhe rikonstruimin e këtyre objekteve:

Përpilimi i paramasave dhe përgatitja e tenderit:

- për gëlqerosjen (ngjyrosjen) e 11 shkollave të KK Prishtinës,
- për shkollën e mesme "Gjin Gazuli" në Prishtinë,
- për shkollën filllore "Meto Bajraktari" në Prishtinë,
- për regullimin e kanalizimit dhe ujërave sanitare në 7 shkolla të KK të Prishtinës,
- për nyjet sanitare në shkollën "Eqrem Qabej" në Prishtinë,
- për vendosjen e gypave të ujës-jellësit në shkollën filllore "Ismail Qemali" në Prishtinë,
- për rrethoja të bashkësive lokale në KK të Prishtinës
- për rrethoja të shkollave në fshat dhe qytet të Komunës së Prishtinës,
- për punët ndërtimore të rrugës në fshatin Shkabaj, KK Prishtinë,
- për sigurimin e të gjitha dyerve dhe dritareve (vendosja e grilave) në të gjitha objektet e bashkësive lokale në Komunën e Prishtinës,
- për riparimin e rrugës për një lagje të fshatit Rimanishtë në KK të Prishtinës,
- për renovimin e sallës së kulturës në fshatrat Bardhosh dhe Keqekollë,
- për renovimin e Qendrës Familjare të Mjekësisë nr. 3,
- për renovimin e bashkësive lokale nr. VII/1, VII/2, XIII, XIV,

Pjesëmarrja në Komisionin për hapjen dhe vlerësimin e tendereve:

- për SHMT "28 Nëntori" Prishtinë,
- ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimit "Muharrem Fejza" dhe "Gjon Sereçi",
- renovimin e objektit të stomatologjisë,
- ndërtimin e Qendrës për Alarmim dhe Koordinim të zjarrëfikësve në Prishtinë,
- ndërtimin e Bashkësisë Lokale në Keqekollë,
- punimin e kanalizimit në fshatin Graçanicë,
- zgjedhjen ideore të projektit të shkollës në Hajkobillë,
- asfaltimin dhe punimin e asfaltimit në rrugën "Shefqet Shkupi",
- parcelizimin e varrezave dhe punimin e drenazhës në fshatin Graçanicë,
- punimin e skelës metalike dhe rrjetin e internetit të mjekësisë urgjente,
- në punimin e hidrantit për pajisje të ujit dhe gropës septike për nevojat e zjarrfikësve në fshatin Llapna Sellë,

- për rrjetin sekondar të kanalizimit në Graçanicë,
- në ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Mat,
- ndërtimin e ambulancës në fshatin Mat,
- renovimin e objektit të Stomatologjisë në Prishtinë,
- në renovimin e objekteve të kulturës në bardhosh dhe Keqekollë,

Mbikqyrja profesionale për zhvillimin e punëve ndërtimore për objektet investive, për të cilat është investitor KK Prishtinës,

- Shkolla e mesme "Gjin Gazuli",
- Shkolla fillore "Meto Bajraktari",
- Grilat siguroese për objektet e bashkësive lokale të Kuvendit Komunal në Prishtinë,
- Punimeve në rrugën Busi-Mramor,
- në renovimin e klinikës veterinare,
- në ndërtimin e rrethojave të shkollave në qytet dhe fshat,
- në ndërtimin e shkollës për edukim profesional "Don Bosko",
- në punimet e zhvilluara në shkollat "Emin Duraku", "Hoxhë Kadri Prishtina", "Pjetër Bogdani", "Elena Gjika", "Gjergj Fishta", "Ismail Qemali", "Hasan Prishtina" dhe "Dardania".
- renovimin e objektit të stomatologjisë,
- ndërtimin e bashkësive lokale në Keqekollë,
- renovimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Bardhosh,

Marrja pjesë në kontrollime teknike të objekteve:

- të shkollës fillore "Dituria" në fshatin Shkabaj, KK Prishtinë ,
- të shkollës fillore në komunën e Prizrenit,
- të shkollës fillore në lagjen "Kalabria",
- të kanalizimit fekal në fshatin Rezallë,
- të klinikës veterinare në Prishtinë,
- të gëlqerosjes së shkollave "Sami Frashëri", "Emin Duraku", "Gjergj Fishta", "28 Nëntori" dhe "Dardania",
- meremetimi i nyjeve sanitare për shkollat "Sami Frashëri", "Hasan Prishtina", "Hoxhë Kadri Prishtina" dhe "Ismail Qemali",
- të renovimit të shkollave të mesme "Gjin Gazuli" dhe "28 Nëntori",
- të renovimit të shkollës fillore "Meto Bajraktari",
- të kanalit të rrugës Besi-Rimanishtë,
- të Qendrës për Alarmim dhe Kordinim të Zjarrfikësve në Prishtinë,
- kontrolli i rrugës Busi-Mramor,
- të bashkësisë lokale në Keqekollë,
- shtëpinë e kulturës në fshatin Bardhosh,
- të shkollës "8 Marsi" në lagjen "Kalabri",
- QMU në Prishtinë,

V. REALIZIMI I TË HYRAVE BUXHETORE NGA BURIMET E INKASUARA NGA PËRGJEGJËSIA E KËTIJ DREJTORATI

Gjatë vititit raportues, ky Drejtorat, ka inkasuar të hyra buxhetore nga këto burime:

- Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore dhe
- Taksa për paraqitjen e kërkesave për caktimin e kushteve urbanistike-teknike, lejeve ndërtimore, leje përdorimi e shfrytëzimi, si dhe kërkesa për lëshimin e vërtetimeve nga përgjegjësia e këtij Drejtorati.

Të hyrat buxhetore nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore gjatë periudhës raportuese janë inkasuar 405.114,53€, ndërsa nga taksat administrative për paraqitjen e kërkesave, zgjidhja e të cilave bie në përgjegjësinë e këtij Drejtorati, nuk kemi mundur t' i sigurojmë pasi që të njëjtat në organin kompetent komunal nuk janë evidentuar këto të hyra si të ndara për drejtoratet përkatëse.

Kur bëhet fjalë për këtë, është e rëndësishë së veçantë të përmendet se inkasimi i kompensimit për shfrytëzimin e sipërfaqes publike-tokës ndërtimore, konform me Rregulloren komunale për taksat dhe ngarkesat nr. 01-413-523 të datës 02.04.2002, nuk bie në përgjegjësinë e këtij Drejtorati, sepse me këtë Rregullore pagesa e këtij lloj kompensimi është paraparë sipas tarifës mujore dhe se këto obligime rrjedhin nga dita e shfrytëzimit të sipërfaqes publike-tokës ndërtimore. Nga kjo arsye, ky Drejtorat me rastin e lejimit të vendosjes së objekteve të përkohshme-kiosqeve, nuk ka mundur të llogaris dhe të inkasoj e këtë lloj kompensimi, pos nga arsyën e përmendur (inkompetenca dhe pagesa mujore), edhe nga fakti se në asnjë moment nuk ka mundur të konstatohet fillimi i rrjedhes së obligimit të pagesës së këtij kompensimi për shkak se konform me rregullativën ligjore në fuqi, shfrytëzuesit kanë qenë të obliguar që brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e marrjes në dorëzim të lejes, të vendosin këtë kategori objektsh.

VI. VËSHTRËSITË DHE PENGESAT E PARAQITURA NË REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA

Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës nga përgjegjësia e këtij Drejtorati, janë vërejtur pengesa të ndryshme, të cilat kanë ndikuar dukshëm në efikasitetin, azhuritetin dhe realizimin e punëve dhe detyrave të punës nga përgjegjësjja e këtij Drejtorati.

Një ndër pengesat me ndikim vendimtar ka qenë mungesa e infrastrukturës ligjore, sepse rregullativa ligjore e aplikueshme në bazë të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 1999/24, është shumë e vështirë të aplikohet nga shkak i ndërrimit të sistemit si tërësi, tjetërsimit të pronës nga ajo shoqërore në pronësi private, si dhe pamundësisë së ekspropriimit të pronës private për qëllime të realizimit të planeve urbanistike, si dhe nxjerrjes së planeve të reja urbanistike.

Rregullorja për ndërtimet në Kosovë nr. 2000/53, ka shumë e mangësi dhe vështirë e aplikueshme në rrethanat tona, si dhe Udhëzimet tjera plotësuese të parapara për nxjerrje në bazë të saj, nga administratori ndërkombëtar për Kosovë, asnjëherë deri më tani nuk janë nxjerrë.

Pengesë serioze në aspektin e planifikimit hapësinor ka qenë atakimi enorm i hapësirave të lira me ndërtime ilegale si brenda kufijëve të planit të përgjithëshëm urbanistik, ashtu edhe jashtë tij.

Po ashtu, ndikim vendimtar dhe pengesë serioze në realizimin e shumë vendimeve komunale nga përgjegjësia e këtij Drejtorati, ka qenë kufizimi i të drejtës së administrimit të Komunës në tokën në pronësi të saj me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 si dhe mos definimi adekuat i pronësisë shoqërore, publike apo komunale.

PROPOZIMI I MASAVE

- Që me një akt të veçantë të bëhet ndarja e kompetencave në mes të drejtorateve në mënyrë decitive, sepse me Statut dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm të organeve ekzekutive të Komunës, këto kompetenca janë dukshëm të ngatërruara.

- Të intensifikohet bashkëpunimi ndërdrejtoral i Komunës për çdo iniciativë të projekteve urbaniste në kuadër të përgjegjësisë së secilit drejtorat, deri në realizimin e projekteve.
- Që me rebalanc të buxhetit të Komunës për vitin 2004, të shqyrtohet mundësia e rritjes së mjeteve financiare për nevojat e këtij drejtorati me qëllim të realizimit të planprogramit të punës për vitin 2004,
- Të rritet (shtohet) numri i personelit civil profesional në Drejtorat, e veçanarisht ai nga lëmi e arkitekturës.
- Të propozohet që Kuvendi i Kosovës të nxjerr rregullativë ligjore mbi definimin e të drejtës pronësore dhe administrimin në hapësira të përbashkëta në objektet banesore të tërësisë së përbashkët (kolektive).
- Që mjetet e llogaritura dhe të inkasuara në emër të kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore dhe ato në emër të shfrytëzimit të tokës ndërtimore, të orientohen në llogari të veçantë të Komunës dhe të njëjtat të përdoren eskuzivisht sipas destinimit për të cilin llogariten dhe paguhen.

DREJTORATI PER EKONOMI

-Në peridhën e parë të vitit raportues janë rexhistruar 459 biznese të reja, ndersa janë çregjistruar 95,

-Janë lëshuar 450 konfirmime për bizneset e rexhistruara.

-Janë lëshuar 253 çertifikata për bizneset e rexhistruara.

-Janë përpunuar 357 lëndë leje pune për kombi -bus.

-Janë lëshuar 318 gjegjisht në pjesën e dytë të viti 369 leje pune për auto-taxi

-Janë lëshuar 85 leje pune për kompani që merren me taxi, si dhe punë tjera informative me palët e interesuara.

-Janë lëshuar leje pune dhe zgjatje të orarit të punës.

-Janë lëshuar 52 vërtetime të natyrës së ndryshme.

Periudha e dytë e këtij viti është karakterizuar me një qasje të re dhe organizim i cili ka rezultuar me sukses.

Takimet e shpeshta lidhur me avancimin e punës me drejtorit tjera, bashkëpunimi me ta lidhur me fillimin e zbatimit të Rregullores mbi Tarifa dhe taxa, formimi i grupeve për të informuar komunitetin e biznesit, si dhe një fushat promovuese e suksesshme mediale e këtyre rregulloreve lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së lejeve të punës nga subjektet afariste.

Është punuar njëkohsisht në vënien e kontakteve edhe me ministritë relevante, me të cilat ky Drejtorat përkon me punët e veta si me :

- Ministrinë për Tregti dhe Industri
- Ministrinë për Ekonomi dhe Financa
- Ministrinë për Transport

Vetëm në këtë segment deri më tani janë lëshuar 420 leje pune për subjekte afariste, punë e cila është duke vazhduar.

Është punuar dhe është bërë ndryshimi i rregulloreve lidhur me fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, rregullorën mbi tarifatat inspektuese të subjekteve afariste, si dhe disa ndryshimeve minore lidhur me Rregulloren për dhënien e lejeve të punës.

Në aspektin e zhvillimit strategjik të Komunës, kjo Drejtori ka vënë kontaktet me organizatat relevante të vendit dhe atyre ndërkombëtare për kyçjen e stafit në proceset e kualifikimit të tyre në trendet e reja zhvillimore.

Janë mbajtur takime të rëndësishme me agjencionet që merren me përkrahjen e zhvillimit ekonomik.

Ngritja permanente e kuadrit ekzistues nëpërmjet trajnimeve ka rezultuar me marrjen pjesë në projektin e organizuar nga Seed-a Kanadeze në bashkëpunim me Agjencionin Regjional të Ndërrmarrjeve, me qëllim që të përpilohet plani zhvillimor strategjik i Komunës në përkrahjen e NVM-ve

Një seminar është mbajtur edhe me IFESIN, i cili mundohet të futë filozofinë e decentralizimit në Komuna, lidhur me zhvillimin ekonomik lokal.

Projekti Delta I dhe Delta II i organizuar nga Riinvesti si dhe Sorosi, do të mundësojnë qasjen e zhvillimit ekonomik lokal gjegjësisht strategjinë zhvillimore lokale. Drejtorati ynë është duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtoratin për Urbanizëm dhe Planifikim në përpilimin e Planit Strategjik të Komunës së Prishtinës.

Projekti i Komunës në këtë qasje në vitin e shkuar ka qenë mjaft i suksesshëm duke krijuar hapësirë të volitshme atyre që ndihmojnë në zhvillimin lokal si me: dhënien e objektit AGEF dhe Goredit gjerman që merren me pregaditjen profesionale për të kthyerit nga bota e jashtme.

Dhënien në shfrytëzim hapësirë për punë Agjencionit Regjional të Ndërrmarrjeve e (themeluar nga AER-i), i cili merret me përkrahjen e NVM-ve

Dhënien e hapësirës për ndërtimin e Qendrës për ngritje profesionale, "Don Boskio", e cila merret me përgatitjen profesionale të të papunëve dhe atyre që duhet të rikualifikohen.

Objektivat e këtij Drejtorati për vitin vijues janë:

- Shtrirja horizontale dhe gjithëpërfshirëse e subjekteve afariste në marrjen e lejeve të punës.
- Lëshimi i lejeve të punës për subjektet dhe individët që ofrojnë shërbime të udhëtarëve, që të njëjtat të jenë shumë më të avancuara dhe më moderne, aplikimi i tillë ka filluar.
- Krijimi i Asociacionit të Biznesit me anë të të cilit Komuna do fitonë një partner strategjik, me të cilin mund ti bashkërenditë veprimet në të ardhmen për përmirësimin e hapësirës së nevojshme për një zhvillim të hovshëm ekonomik,
- Krijimi i një "inkubatori të biznesit", i cili mundëson të rinjët, studentët dhe fillestarët tjerë që të vetëpunësohen dhe të zbatojnë idetë në biznese, duke u ofruar hapësirë të nevojshme dhe më të lirë për zhvillimin e afarizmit.

Drejtorati do të punojë edhe në projekte të tjera strategjike në nivel të Kosovës, siç është edhe përpilimi i planit strategjik të zhvillimit afatmesëm në nivel të Kosovës.

Përfaqësuesi i Drejtorarit tonë në mënyrë profesionale merr pjesë në grupin konsultativ qeveritar (në kuadër të MTI) lidhur me shumë projekte zhvillimore. Bashkëpunimi i tillë do të thellohet në vitin vijues edhe me minsitritë tjera, Odën Ekonomike, Agjencionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, që merren me projeksione dhe strategji zhvillimore, në mënyrë që kryeqendra e Kosovës, Prishtina të bëhet një qendër e respektuar në aspektin zhvillimor me një perspektivë të qartë për të ardhmen.

DREJTORATI PËR ARSIM DHE SHKENCË

Gjatë vitit 2003, objektivat kryesore të punës së Drejtoratit për Arsim dhe Shkencë ishin:

1. Angazhimi për realizimin e projekteve të ndërtimit, rindërtimit dhe meremetimit të objekteve të ndryshme shkollore të Komunës së Prishtinës.
2. Mbikëqyrja e sistemit arsimor komunal, që përbëhet nga institucionet parashkollore, shkollat fillore, shkollat e mesme dhe speciale.
3. Sigurimi dhe plotësimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës për vitin shkollor 2002/2003 dhe 2003/2004, në bazë të nevojave dhe kërkesave nga drejtoritë e institucioneve arsimore

4. Mbështetja për trajnimin e kuadrit udhëheqës dhe arsimor të institucioneve arsimore nga MASHT-i.
5. Realizimi i aksionit tradicional "Garat e diturisë" në nivel komunal.
6. Mbështetja dhe realizimi i "Garave të recitatorëve" në nivel komunal.
7. Organizimi dhe mbajtja e manifestimit "Maturiada Prishtina 2003".
8. Mbështetja dhe bashkëpunimi me të gjitha OQ-të dhe OJQ-të, në realizimin e projekteve të tyre trajnuese nëpër shkolla.
9. Sigurimi i transportit të nxënësve të kl. IX dhe arsimtarëve.
10. Punë të tjera të zakonshme të këtij Drejtorati.

Realizimi i këtyre objektivave është bërë nga tri shërbimet e veçanta, që veprojnë në kuadër të dy sektorëve të Drejtoratit për Arsim dhe Shkencë dhe stafi udhëheqës i Drejtoratit:

1. Shërbimi i punëve të përgjithshme administrative, në të cilin janë angazhuar katër punëtorë: një jurist, udhëheqës i shërbimit, një ekonomist, një bashkëpunëtor arsimor dhe një kompjuterist.
2. Shërbimi i inspektorëve arsimorë prej tre vetash, që e kanë bërë mbikëqyrjen e realizimit të ligjshmërisë dhe të akteve ligjore e nënligjore në institucionet shkollore të komunës së Prishtinës.
3. Shërbimi i inspektorëve lëndorë prej tetë vetash, që e kanë bërë mbikëqyrjen profesionale të procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e arsimit të Komunës së Prishtinës.

I Ndërtimet dhe meremetimet e ndryshme të shkollave

Gjatë vitit 2003, Drejtorati për Arsim dhe Shkencë është angazhuar që t'i përmbushë objektivat, të cilat i ka përcaktuar me prioritet, në planin e riparimeve të ndryshme të objekteve shkollore.

Nga mjetet e alokuara dhe të zotuar nga MASHT-i janë realizuar këto projekte:

1. Ndërtimi i aneksit dhe rehabilitimi i objektit të shkollës fillore "Meto Bajraktari" në shumën prej 400.000 eurosh.
2. Rehabilitimi i objektit të shkollës së mesme elektroteknike "Gjin Gazulli", në shumën prej 250.000 eurosh.
3. Ndërrimi i të gjitha dritareve të shkollës së mesme teknike "28 Nëntori", në shumën prej 120.000 eurosh.

Ndërkaq shuma prej 250.000 eurosh, të destinuar për ndërtimin e aneksit të objektit të shkollës fillore "Naim Frashëri", për shkak të kontesteve pronëso-ro-juridike, nuk është realizuar, prandaj kjo shumë është shfrytëzuar për fillimin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore "Mitrush Kuteli" në Mat.

Projektet e realizuara nga buxheti i Komunës janë:

1. Gëlqerosja e objekteve të shkollave fillore dhe të mesme:.....	107.559 €
2. Ndërrimi i dritareve të disa objekteve shkollore.....	153.616 €
3. Rregullimi i nyjeve sanitare dhe të kanalizimit.....	83.541 €
4. Rrethojat e oborreve të shkollave	201.618 €
5. Riparime të vogla nëpër disa objekte shkollore ("E.Gjika", "N.Frashëri", "Gj. Gazulli", salla e Baletit dhe inventar shkollor):	41.639 €
6. Participimi për ndërtimin e objektit të shkollës fillore në Shkabaj:	30.000 €
7. Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve.....	68.170 €
8. Pajisja e kuzhinës qendrore të institucioneve parashkollore me elemente të kuzhinës:	135.630 €

Janë bërë kërkesat për Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim për kushtet urbanistike, si dhe për përgatitjet e projekteve për ndërtimin e objekteve të reja shkollore në këto lokacione: në lagjen "Kodra e trimave", në lagjen "Vreshtat", në paralagjen e Prishtinës "Mati" dhe në fshatin Gjellbërishtë (Hajkobillë). Në Konferencën e donatorëve, që është mbajtur më maj 2003, e organizuar nga MASHT-i, propozimi i ndërtimit të tri objekteve për shkollat fillore, ka hyrë si prioritet për Komunën e Prishtinës. Ndërkaq, projekti për ndërtimin e Shkollës Fillore në Hajkobillë nuk është realizuar për shkak të zvarritjes së krijimit të kushteve urbanistike dhe të projektit nga organet kompetente.

Është bërë kërkesa për gjetjen e lokacioneve për ndërtimin e objekteve të reja shkollore në këto lagje të Prishtinës: të Spitalit, Arbërisë, Hajvalisë së Re dhe të Sofalisë

Pas ushtrimit të shumë trysnive në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim për kooperativitet me MLIF-in, është në përfundim projekti për ndërtimin e objektit të ri shkollor në fshatin Ballaban, që pritet të realizohet gjatë këtij viti. Të gjitha nevojat si: për rregullimin e kulmeve të disa objekteve shkollore, për inventar shkollor, për pajisjen e shkollave me kompjuterë dhe me mjete tjera mësimore, i kemi sistemuar në bazë të kategorive të punëve dhe shërbimëve, nuk kemi mundur t'i realizojmë me që, buxheti komunal ishte i pamjaftueshem për përmbushjen e atyre nevojave përkatësisht kërkesave të shkollave të ndryshme të Komunës së Prishtinës. Prandaj, kërkesat për realizimin e atyre projekteve ua kemi dërguar MASHT-it dhe shumica prej tyre janë miratuar, si dhe janë duke u realizuar në këtë fillimvit.

Edhe për këtë periudhë kohore, është siguruar transporti i nxënësve të klasës IX dhe i arsimtarëve në të gjitha fshatrat e Komunës së Prishtinës.

Janë përfunduar dhe janë në përfundim e sipër ndërtimi i këtyre objekteve shkollore:

-objekti i ri i shkollës fillore në lagjen "Kalabria" (ish-Emshiri) është përfunduar në fillim të vitit të ri shkollor 2003/2004, kurse edhe në lagjen "Dardania" është në përfundim. Në këto projekte ka investuar Banka Islamike për Zhvillim, shuma prej 600.000 eurosh, përkatësisht 1.100.000 eurosh.

-objekti i ri i shkollës fillore në Shkabaj, për të cilin ka investuar UFORK-u në shumën prej 150.000 Eurosh, ndërsa Komuna ka participuar me rreth 30.000 Euro. Në këtë objekt shkollor puna ka filluar në fillim të këtij viti shkollor.

Shfrytëzimi i mjeteve nga Buxheti sektorial është bërë sipas planit të përcaktuar nga Drejtorati, duke i përfillur nevojat e kryerjes së shërbimeve emergjente dhe furnizimit me mallëra të domosdoshme për shkollat, por gjithnjë duke përcaktuar prioritetin kohor për realizimin e kërkesave të shkollave të caktuara. Me këtë rast, duhet të theksojmë një problem, i cili është shfaqur si rrjedhim i zvogëlimit të shumës së mjeteve të alokuara nga Ministria e Financave për Shërbime dhe Mallëra në shumën rreth 400.000 eurosh, në emër të mbulimit të pagesave të punëtorëve arsimorë. Prandaj kemi patur vështirësi për sigurimin e mjeteve për lëndët djegëse, për sezonën dimërore, megjithatë me angazhimin e strukturave udhëheqëse financiare të Komunës, është tejkaluar dhe shpresojmë se në vitin 2004, nuk do të paraqitet ky problem.

II. Mbikëqyrja e tërë sistemit arsimor komunal

Gjatë vitit 2003, është bërë mbikëqyrja e zhvillimit të tërë sistemit arsimor komunal, në të gjitha nivelet, nga drejtori dhe personeli i tij, nga Shërbimi për punë të përgjithshme administrative, nga Shërbimi i inspektorëve arsimorë dhe nga Shërbimi i inspektorëve lëndorë:

Sistemin arsimor të Komunës së Prishtinës e përbëjnë:

- pesë institucione parashkollore me dymbëdhjetë objekte, duke përfshirë kuzhinën qendrore me 2026 fëmijë, me 269 punëtorë administrativë dhe edukativë, 41 shkolla fillore, prej të cilave gjashtëmbëdhjetë në Prishtinë, me gjithësej 33746 nxënës, niveli 1 dhe 2 i arsimit, me 23 paralele të ndara fizike dhe me 2067 punëtorë arsimorë dhe administrativë, -20 shkolla të mesme, prej të cilave një është private, me 11712 nxënës, 1000 punëtorë administrativë dhe arsimorë, dhe -shkolla speciale me 78 nxënës, me 13 punëtorë arsimorë dhe administrativë.

Në kuadër të këtij sistemi arsimor është siguruar shkollimi fillor dhe i mesëm për minoritetin turk dhe boshnjak.

Pas shumë përpjekjesh, me të gjitha organet tona qeveritare dhe me ndërkombëtarët, kemi arritur që pjesërisht të kemi qasje edhe në organizimin e shkollimit për minoritetin serb, edhe pse kemi shumë pengesa dhe vështirësi. Në të ardhmen mendojmë që ta bëjmë integrimin e plotë të këtij shkollimi në sistemin e arsimit kosovar, njëherësh me redukimin e personelit arsimor dhe mbështetës, e më vonë edhe me aprovimin dhe zbatimin e planprogrameve mësimore të Kosovës, ndërsa po theksojmë se në paga, në shërbime dhe mallra participojnë në buxhetin komunal për arsim.

Gjatë vitit 2003 janë mbajtur 19 mbledhje me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, në të cilat janë trajtuar çështje të ndryshme për mbarëvajtjen menaxhuese të punës edukativo-arsimore, në të gjitha nivelet e punës edukativo-arsimore dhe janë dhënë udhëzime të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe obligimeve konkrete, në harmoni me trendin zhvillimor të arsimit të Komunës së Prishtinës.

Gjatë kësaj periudhe, nga drejtori i Drejtoratit për Arsim e Shkencë dhe shefat e sektorëve janë bërë rreth 175 vizita me karakter pune në të gjitha institucionet shkollore të Komunës së Prishtinës.

III. Shërbimi i inspektorëve arsimorë

Inspektorët e arsimit të Komunës së Prishtinës gjatë vitit 2003, bënë inspektime të rregullta, speciale e kontrolluese në entet parashkollore (në tri ente sa funksionojnë në Prishtinë), në 36 shkolla fillore dhe një shkollë speciale, me 23 paralele të ndara dhe në 13 shkolla të mesme.

Inspektimet kanë qenë të fokusuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke e kontrolluar mënyrën e regjistrimit të nxënësve, vlerësimin e tyre, vijimin e mësimit, masat edukative, procedurën e pranimit të kuadrit mësimor, disiplina në punë, realizimi i planit dhe programit mësimor e të tjera. Nga inspektorët arsimorë janë bërë edhe 101 inspektime speciale, 97 inspektime kontrolluese dhe 74 kontrollime në bazë të ankesave të nxënësve, arsimtarëve, punëtorëve dhe të tjerëve. Përveç tjerash, inspektorët janë angazhuar në punën me palë duke dhënë udhëzime për realizimin e kërkesave të tyre

IV Shërbimi i inspektorëve lëndorë

Inspektorët lëndorë gjatë vitit 2003, kanë bërë mbikëqyrjen dhe kontrollin profesional në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës duke u angazhua në këto detyra:

-përsosjen profesionale të personelit arsimor në institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme për trajnimin, përparimin dhe avancimin e kuadrit arsimor në harmoni me reformat në arsimin e Kosovës,

-udhëzimet, këshillat për edukatorët dhe arsimtarët e të gjitha niveleve, posaçërisht ata të pakualifikuar, për hartimin e planeve dhe programeve mësimore vjetore dhe mujore, për

përgatitjet e orës mësimore, për aplikimin e metodologjisë bashkëkohore në procesin e mësimdhënies, për përpunimin e testeve për vlerësimin e nxënësve.

-bën 42 mbikëqyrje dhe kontrollime të përgjithshme profesionale në institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe janë bërë 37 vizita informative në shkollat fillore, 21 në shkollat e mesme dhe shtatë në institucionet parashkollore.

Nga ky shërbim janë përcjellë punëtoritë dhe seminarët e organizuara nga MASHT-i dhe organizatat tjera qeveritare e joqeveritare, për aftësimin e kuadrit dhe për realizimin e reformës shkollore dhe për hartimin e planprogrameve mësimore dhe të testeve sipas kërkesave, që shtrohen nga zbatimi i reformës në Arsimin e Kosovës.

-janë kryer edhe punë të tjera me kërkesë të drejtorit të Drejtoratit për Arsim dhe Shkencë, si dhe të institucioneve të tjera arsimore.

V Shërbimi i Përgjithshëm administrativ

Shërbimi i Përgjithshëm administrativ ka kryer këto detyra:

-lidhja e kontratave të punës për rreth 3400 punëtorë,

-ka bërë shpërndarjen e listave të pagave për të gjitha institucionet edukativo-arsimore: parashkollore, fillore dhe të mesme,

-pranimin, plotësimin dhe shpërndarjen e formularëve të ndryshëm për pagat e arsimtarëve dhe të punëtorëve arsimorë,

-pranimin e faturave të ndryshme për shpenzime materiale dhe pagesat e tyre,

-takime pune me zyrtarët e UNMIK-ut lidhur me nevojat e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse për sezonin dimëror,

-përpilimin e planit financiar afatmesëm për vitin shkollor 2003/2005, për të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës,

-shpërndarjen dhe pranimin e aplikacioneve për vendet e lira të punës,

-përpilimin e shkresave, shtypjen e materialeve dhe puna me palë, etj.

-procedimin e pagesave për shërbime dhe mallra për vitin 2003,

-shpërndarjen e formularëve për regjistrimin e pasurisë dhe të inventarit në të gjitha institucionet shkollore të Komunës së Prishtinës,

-takime pune me zyrtarët e minoriteteve lidhur me ndryshimet në listat e pagave, sipas Udhëzimit Administrativ 04/2003, të datës 23 janar 2003,

-takime pune me përfaqësuesit e UNMIK-ut,

-shpërndarja e materialeve të ndryshme dhe rregulloreve për institucionet shkollore të Komunës së Prishtinës.

VI. Bashkëpunimi i Drejtoratit me MASHT-in, me drejtoratet komunale të preokupuara me çështjen e arsimit, me zyrtarët e UNMIK-ut, etj.

-Në bashkëpunim me MASHT-in, është përcjellë puna edukativo-arsimore në shkollën speciale, "Përparimi" për fëmijë me aftësi të kufizuara, trajnimi i arsimtarëve sipas kërkesave dhe nevojave që i parashtron reforma e arsimore, konferencat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për çështje të arsimit dhe të reformës, hartimin e planprogrameve mësimore në frymën e reformave arsimore që po bëhen në Kosovë, intervistimin e kandidatëve, që kanë konkuruar për drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Prishtinës, zgjedhjen e kuadrit mësimor, si dhe plotësimin e tij sipas kërkesave të institucioneve edukativo-arsimore gjatë vitit shkollor 2003/2004, në bazë të konkurseve të shpallura nga Drejtorati për Arsim dhe Shkencë.

-Është bërë organizimi dhe mbajtja e testeve për nxënësit e klasës të IX.

Bashkëpunimi me Zyrën e minoritetit rom, ashkalinj dhe egjiptas.

-Drejtorati i Arsimit ka bashkëpunuar me të gjitha organet e Kuvendit Komunal, e sidomos me Komitetin për Arsim e Shkencë, duke iu ofruar atyre material për procedim të mëtejshëm, si dhe shërbime të nevojshme informative.

-Ka bashkëpunuar me të gjitha drejtoratet komunale, në mënyrë të veçantë me Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim, Drejtoratin për Inspekcion, Drejtoratin për Kulturë dhe Gjinë, Drejtoratin për Sport dhe Rini, Zyrën Legale, Zyrën e Prokurimit etj.

Vështirësi në kooperativitet dhe bashkëpunim janë paraqitur sidomos me Zyrën e Prokurimit, për shkak të prolongimit të tenderëve dhe mosrealizimit të tyre sipas planit të përcaktuar nga Drejtorati ynë.

VII. Sigurimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës

Në bashkëpunim me MASHT-in dhe drejtoritë e shkollave kohë pas kohe kemi siguruar kuadrin edukativo-mësimor dhe mbështetës për të gjitha nivelet e arsimit të Komunës së Prishtinës.

Problemet me të cilat jemi ballafaquar e që vlen të përmenden kanë qenë:

- shpërndarja e kuadrit mësimor të klasave të IX nëpër shkolla fillore, ku janë vendosur klasët e IX në këtë vit shkollor. Me këtë rast situatën e ka rënduar edhe më, fillimi i zbatimit të reformave në klasën VI dhe X, me ç'rast është zvogëluar fondi i orëve për lëndët: si gjuha shqipe, biologjia, fizika, etj.

-mungesa e kuadrit të kualifikuar për lëndët mësimore: gjuhë angleze, matematikë dhe për lëndë profesionale për shkollat e mesme profesionale, si inxhinierë të profileve të ndryshme, etj.

Gjendja më e vështirë me mungesën e kuadrit të kualifikuar është në shkollat e fshatrave, sidomos të atyre të largëta në Malësinë e Gollakut, ku është dashur të angazhojmë personel arsimor të pakualifikuar të vendit.

-Tani kur e kemi siguruar transportimin e nxënësve nga pothuaj të gjitha vendbanimet rurale, është krijuar mundësia për transportimin e arsimtarëve nga Prishtina në shkollat rurale, me çka është përmirësuar struktura kualifikuese e kuadrit arsimor.

Probleme të veçanta na paraqiten edhe me rastin e zëvendësimit të punëtorëve në pushime mjekësore të shkurtëra, madje edhe një javë, qoftë në mosinteresimin për t'u angazhuar për një kohë të shkurtër, qoftë për vështirësitë e futjes në sistemin e pagesave. Këto janë reflektuar drejtpërdrejtë në çrregullimin e procesit normal edukativo-arsimor.

VIII. Mbështetja e trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor

Gjatë vitit 2003 kujdes të veçantë i kemi kushtuar edhe trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor, i cili është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në frymën e reformave arsimore që po bëhen në Kosovë.

Gjatë muajve prill-maj-qershor-nëntor dhe dhjetor të vitit 2003, janë mbajtur seminare për trajnimin e arsimtarëve dhe stafit udhëheqës të shkollave, të udhëhequra nga MASHT-i e të mbështetura nga Drejtorati, të realizuara nga KEDP-ia dhe KEC-i.

Seminare për trajnimin e arsimtarëve ka organizuar edhe Shoqata finlandeze për punë me fëmijë me nevoja të veçanta.

IX. Realizimi i aksionit: garat e diturisë, garat e recitatorëve, në nivel komunal, dhe "Maturiada e Prishtinës 2003"

Në kuadër të planit të punës, që ka bërë Drejtorati, janë realizuar edhe këto aktivitete:

Garat e recitatorëve, garat e diturisë (në tetë lëndë mësimore) të 34 shkollave fillore, zgjedhja e nxënësit, paraleles, mësuesit, arsimtarit, profesorit dhe edukatores më të mirë të të gjitha niveleve edukativo-arsimor komonale. Garat e diturisë janë mbajtur më 24. 5.

2003, kurse garat e recitatorëve janë mbajtur më 07 Mars - Ditën e Mësuesit. Më 24 maj 2003, është mbajtur edhe manifestimi: "Maturia e Prishtinës 2003". Shpallja e rezultateve, ndarja e diplomave, e mirënjohjeve dhe e dhuratave modeste është bërë me rastin e 11 Qershorit, Ditës së Prishtinës.

X. Bashkëpunimi me OQ-të dhe OJQ-të më realizimin e projekteve të tyre nëpër shkolla:

Drejtorati ka bashkëpunuar me organizatat qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e projekteve të ndryshme: për parandalimin e dukurive negative të nxënësit, si me Departamentin e të Drejtave të Njeriut, Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës, Sektorin për të Drejtat e Fëmijëve, Klubin për të Drejtat e Njeriut, Fëmijët për të Drejtat e Tyre, Teatrin e të Rinjëve të Prishtinës, Qendrën e Pionierëve etj.

Organizimi, përvoja, vështirësitë dhe perspektiva

Sa i përket organizimit të brendshëm profesional dhe kadrovik të Drejtoratit për Arsim dhe Shkencë, më duhet të them se nuk jemi të kënaqur, sepse nuk kemi mundur ta realizojmë skemën e re organizative. Tani pas miratimit të Ligjit mbi Shkollimin Fillor dhe të Mesëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë më të qartësuara, ndonëse ka vend për koment lidhur me atë se çka është ekskluzivisht kompetencë dhe përgjegjësi e Komunës e çka e MASHT-it. Kompetencat dhe përgjegjësitë lidhur me menaxhimin financiar dhe kadrovik të personelit administrativ, ndihmës dhe arsimor janë transferuar nga MASHT- i në Komunë nga janari i vitit 2002, përkatësisht nga shtatori i vitit 2003. Me këtë rast duhet të theksoj veçanërisht shumë parregullësi të trashëguara nga ish-DASH-i në sistemin e pagesave të punëtorëve administrativë dhe arsimorë, në gati të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës, si psh. në fshehjen e fondit të orëve nga drejtorët e shkollave të caktuara, në paqartësitë lidhur me normën e arsimtarëve, përgjegjësitë në punë, profesionalizimin e kuadrit arsimor, etj.

Problem në vete ka qenë edhe mungesa e rregulloreve të ndryshme për të drejtat, detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe të nxënësve në institucionet arsimore, e sidomos rregullorja mbi disiplinën dhe masat disiplinore ndaj punëtorëve arsimorë, administrativë, si dhe rregullorja për masat disiplinore ndaj nxënësve. Për këtë qëllim i kemi ngritur dy komisione, një në nivel të Sektorit të Shkollave të Mesme dhe një në nivel të Sektorit Parashkollor dhe Fillor, për hartimin e propozim-rregulloreve, që janë aprovuar nga këshillat e shkollave gjegjëse. Këto rregullore janë nxjerrë dhe aprovuar konform LAFM dhe u janë dhënë në zbatim të gjitha shkollave të Komunës së Prishtinës.

Kërkohej në të ardhmen që të shtohet angazhimi dhe efikasiteti në procesin e prokurimit për çështje të ngutshme të intervenimeve në sanimin e avarive të ndryshme të sistemit të ngrohjes, sanitarisë, kanalizimit, në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të institucioneve shkollore për shpenzimet materiale, për lëndë djegëse, për pajisjen me inventar dhe mjete mësimore, e të tjera.

Tani pas krijimit të rrethanave të reja ligjore, Drejtorati duhet të përpunojë një skemë të re organizative, ndryshe nga e mëparshmeja, konform kompetencave dhe përgjegjësiwe përkatëse ligjore, ndaj është e domosdoshme që Statuti i Komunës dhe Rregullorja mbi sistematizimin e punëtorëve në Drejtoratin e Arsimit dhe Shkencës të harmonizohet me Ligjin mbi Shkollimin Fillor dhe të Mesëm.

Drejtoratit për Arsim e Shkencë i duhet një personel kompetent dhe i përgatitur profesionalisht për menaxhimin financiar dhe kadrovik. Gjithashtu, nëse synohet të përmbushen të gjitha objektivat e Drejtoratit të përcaktuara me Rregulloren për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësiwe të tij në fushëveprimtarinë e arsimit, duhet të sigurohet hapësirë e mjaftueshme për punë.